Tabela DQ.24: Raportimi i moshës së vdekjes në ditë.....	212
Tabela DQ.25: Raportimi i moshës së vdekjes në muaj.....	212
Tabela ED.G1: Vijueshmëria e shkollës së mesme dhe fëmijët jashtë shkollës.....	295
Tabela ED.G2: Barazia gjinore në arsim	296
Tabela ED.G3: Barazia gjinore jashtë shkollës.....	297

LISTA E FIGURAVE

Figura HH.1: Shpërndarja e popullatës së ekonomive familjare sipas moshës dhe gjinisë	11
Figura CM.1: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme	22
Figura CM.2: Shkallët e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç sipas vendbanimit	23
Figura CM.3: Trendet e shkallëve të vdekshmërisë së foshnjeve	23
Figura NU.1: Fëmijët e moshës nën 5 vjeç me nën peshë, ngecje në rritje, peshë të vogël për gjatësinë dhe mbi peshë (mesatarisht apo rëndë)	29
Figura NU.2: Mënyrat e të ushqyerit të foshnjeve sipas moshës	33
Figura CH.1: Vaksinimi deri në moshën 12 muajsh (fruthit deri 24 muaj)	41
Figura CH.2: Fëmijët nën moshën 5 vjeçare me diarre që kanë marrë ORS	48
Figura CH.3: Fëmijët e moshës nën 5 vjeçare me diarre që kanë marrë terapi rehidratuese përmes gojës (ORT) dhe kanë vazhduar ushqimin	49
Figura WS.1: Shpërndarja në përqindje e anëtarëve të ekonomive familjare sipas burimit të ujit të pijshëm	61
Figura WS.2: Shpërndarja në përqindje e anëtarëve të ekonomive familjare sipas përdorimit dhe tualeteve të përbashkëta	67
Figura WS.3: Përdorimi i burimeve të përmirësuar të ujit të pijshëm dhe kanalizimi i përmirësuar sipas anëtarëve të ekonomive familjare	68
Figura RH.1: Shkalla e fertilitetit specifike për moshën	74
Figura RH.2: Dallimet në përdorimin e kontraktivëve	80
Figura RH.3: Personi që ka asistuar në lindje	88
Figura ED.1: Treguesit e arsimit sipas gjinisë	118
Figura CP.1: Fëmijët nën moshën 5 vjeçare, lindjet e të cilëve janë regjistruar	123
Figura CP.2: Metodot e disiplinimit të fëmijëve, fëmijët e moshës 1-14 vjeçare	128
Figura CP.3: Martesat e hershme në mesin e femrave	133
Figura HA.1: Femrat dhe meshkujt me njohuri të përgjithshme rreth bartjes së HIV-it	144
Figura HA.2: Qëndrimet pranuese ndaj njerëzve që jetojnë me HIV/AIDS	149
Figura HA.3: Sjelljet seksuale që rrisin rrezikun e infeksionit me HIV tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeçare ..	159
Figura TA.1: Konsumuesit e duhanit aktual dhe ndonjëherë	180
Figura DQ.1: Popullata e ekonomive familjare sipas viteve të vetme	203
Figura DQ.2: Matjet e peshës dhe gjatësisë/lartësisë sipas shifrave të raportuar për decimale	208

LISTA E AKRONIMEVE

AFH	Arsimimi në fëmijëri të hershme
AIDS	Sindromi i imunodeficiencës së fituar
BCG	Bacillus Calmette-Guérin (Tuberkulozi)
BE	Bashkimi Evropian
CEE/CIS	Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura
CHERG	Grupi Referues Epidemiologjik i Shëndetit të Fëmijës
CSPro	Sistemi i procesimit të anketave dhe regjistrimeve të popullsisë
deff	Efekti i dizajnit
DHS	Anketa Demografike dhe e Shëndetit
DIU	Spirale
DPR	Aftësia e kufizuar, Parandalimi dhe Rehabilitimi lëndimit
DPR	Përgatitja për Fatkeqësi dhe për Përgjigje
DPT	Diphtheria Pertussis Tetanus
EPI	Program i Zgjeruar i Imunizimit
HepB	Hepatitis B
Hib	Haemophilus influenzae tipi B
HIV	Human Immunodeficiency Virus
IAR	Simptomat e Infeksionit Akut të Sistemit Respirator
IBGJ	Indeksi i Barazisë Gjinore
IMR	Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve
IZHFH	Indeksi i zhvillimit në fëmijëri të hershme
KDF	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
KPL	Kontrollet Shëndetësore pas Lindjes
MAL	Metoda e Amenoresë së Laktacionit
MICS	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
MICS5	Raundi i pestë i programit të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
MMR	Fruthi, shytat, dhe rubella
MNCH	Shëndeti i nënës, fëmijës dhe të porsalindurit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OPV	Vaksina orale për polio (Oral Polio Vaccine)
ORT	Trajtimi rihidratues përmes gojës
OZHM	Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit
PAHO	Organizata PanAmerikane e Shëndetësisë
PPM	OBSh /UNICEF Programi i Përbashkët i Monitorimit
QR	Qark Regjistruar
RNV	Raporti neto i vijueshmërisë
SBL	Shkalla Bruto e Lindjeve
SHFSM	Shkalla e Fertilitetit Specifike për Moshën
SPF	Shkalla e përgjithshme e fertilitetit
SPSS	Pako Statistikore për Shkenca Sociale
STI	Sëmundje seksualisht të transmetueshme
UNFPA	Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara
UNGASS	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Sesioni i Veçantë për HIV/AIDS
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
WASH	Uji, Kanalizimi dhe Higjiena
WFFC	Botë e Përshtatshme për Fëmijë
ZHFH	Zhvillimi në fëmijëri të hershme
ZPK	Zyrtar i Programeve Kombëtare

FALËNDERIMET

Agjencia e Statistikave të Kosovës dëshiron të shfrytëzojë rastin të falënderojë të gjithë pjesëmarrësit në MICS-in e Kosovës që kanë dhënë kontributin e tyre në implementimin e kësaj ankete dhe në përgatitjen e këtij raporti. Përkushtimi dhe puna e palodhur e stafit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka kontribuar në implementimin e suksesshëm të kësaj ankete.

Implementimi i anketës është mundësuar përmes mbështetjes financiare të Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara (UNICEF-it), Ministrisë Federale për Punë Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Dukës së Madh të Luksemburgut, Fondit të Popullatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA), dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). UNICEF-i, UNFPA-ja, dhe MPMS-ja si dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Zyra për Planifikim Strategjik të Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës e Zyrës së Kryeministrit, janë përfaqësuar nga Komitetet Teknike dhe Komitetet Drejtuese ndërministrorë.

Falënderime të veçanta për stafin dhe konsulentët e UNICEF-it, Zyra në Kosovë, Zyra Rajonale në Gjenevë e UNICEF-it CEE/CIS dhe ekipit global të MICS-it të UNICEF-it në Nju Jork për kontributin e tyre profesional dhe asistencës në implementimin e kësaj ankete. Është dhënë mbështetje teknike përgjatë tërë procesit përmes rekrutimit të stafit dhe konsulentëve të UNICEF-it për të punuar përkrah Agjencisë së Statistikave të Kosovës përgjatë të gjitha fazave të implementimit të anketës. Pa mbështetjen dhe shoqërimin e UNICEF-it në Kosovë, kjo anketë nuk do ishte e mundur. Agjencia e Statistikave të Kosovës është mirënjohëse ndaj Zyrës së UNICEF-it në Kosovë për bashkëpunimin.

Falënderime të veçanta për Siraj Mahmudlu, Koordinator Rajonal i UNICEF-it për MICS, dhe pjesëtarët e ekipit rajonal të UNICEF-it, veçanërisht Ahmet Sinan Türkyılmaz, Ana Abdelbasit dhe Ikhtier Kholmatov, mbështetja e vazhduar teknike dhe logjistike e të cilëve ishte e një rëndësie vitale. Ne shprehim mirënjohje të sinqertë për Ekipin global të MICS-it, në veçanti Attila Hancioğlu, Bo Pedersen, David Megill, Ivana Bjelic, Turgay Ünal, dhe Yadigar Coşkun, që kanë mbështetur procesimin dhe analizën e të dhënave.

Falënderojmë pjesëtarët e Komitetit Drejtues dhe Komitetit Teknik të MICS-it të cilët ofruan këshilla të rëndësishme dhe komente përgjatë përgatitjes së anketës dhe zhvillimit të pyetësorëve.

Ne shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë individët e ekonomive familjare në Kosovë të cilat me zemërgjerësi hapën dyert e shtëpive të tyre dhe ndanë kohën e tyre për realizimin e kësaj ankete. Pa bashkëpunimin dhe kontributin e tyre, implementimi i kësaj ankete nuk do ishte i mundur, prandaj vlerësimi më i lartë ju takon atyre.

Ne shpresojmë se ky raport do ndihmojë në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë fëmijët dhe femrat në Kosovë.



PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

MICS-i në Kosovë 2013-2014 është anketë me mostër gjithëpërfshirëse kombëtare në të cilin janë intervistuar 4,127 ekonomi familjare, 5,251 femra, 2,165 meshkuj dhe 1,648 nëna (apo kujdestarë) të cilat janë përgjigjur për fëmijët nën moshën pesë vjeçare. Ky MICS është kryer paralelisht me anketën tjetër të MICS-it me komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë 2013-2014 e cila është bazuar në një mostër të veçantë. Të dy anketat e MICS-it janë kryer në 2013-2014 në Kosovë në dy mostra të pavarura – MICS-i në Kosovë në një mostër gjithëpërfshirëse kombëtare dhe MICS-i me komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë në mostrën e popullatës që jeton në këto komunitetet të veçanta.

Anketa ofron të dhëna statistike të besueshme dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme për zhvillimin e programeve dhe politikave të bazuara në dëshmi. Anketa prezanton informatat e fundit për vlerësimin e gjendjes së fëmijëve, femrave dhe meshkujve si dhe ofron të dhëna për monitorim të strategjive dhe planeve ekzistuese të veprimit. Gjetjet i përkasin periudhës, përveç nëse shprehet ndryshe, nëntor 2013 – mars 2014 të implementimit të punës në terren nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me mbështetje financiare dhe teknike të Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara (UNICEF).

VDEKSHMËRIA E FËMIJËVE

Gjatë 15 viteve para anketës vdekshmëria ka ndjekur një trend vazhdimisht në ulje me shkallë të vdekshmërisë së foshnjeve gjatë pesë vjetëve para anketës në 12 për një mijë lindje të gjalla, përdërisa shkalla e vdekshmërisë nën moshën pesë vjeçare është 15 për një mijë lindje të gjalla. Proporcioni më i madh i vdekjeve të foshnjeve ndodh gjatë periudhës neonatale (9 për një mijë lindje të gjalla) dhe 80 përqind të vdekjeve nën moshën 5 vjeçare janë vdekje të foshnjeve. Edhe pse më i lartë, trendi i vlerësuar i vdekshmërisë së foshnjeve sipas anketës ndjek atë të të dhënave administrative të 15 viteve të fundit.

LINDJE NËN PESHË

Pothuaj të gjitha foshnjat (99 përqind) janë peshuar në lindje dhe përafërsisht një në njëzet (5 përqind) llogaritet të jenë lindur me peshë më të ulët se 2,500 gram në lindje (d.m.th. kanë peshë të ulët në lindje).

GJENDJA E TË USHQYERIT

Një në njëzet e pesë fëmijë (katër përqind) nën moshën 5 vjeçare kanë ngecje mesatare apo të rëndë në rritje apo janë shumë të shkurtër për moshën e tyre, që reflekton kequshqyerje kronike si rezultat i mos marrjes së ushqyerjes adekuate për një periudhë të gjatë dhe sëmundjeve të shpeshta apo kronike. Kjo përqindje e ulët tregon se nuk ka probleme të dukshme sa i përket ngecjes në rritje apo nën-peshës. Edhe pse pothuajse asnjë fëmijë nën moshën 5 vjeçare në Kosovë nuk është klasifikuar me nënpeshë të formës së rëndë, përafërsisht dy përqind janë mesatarisht apo rëndë nënpeshë dhe katër përqind mbipeshë apo shumë të rëndë për gjatësinë e tyre.

GJIDHËNJA DHE TË USHQYERIT E FOSHNJEVE

Më pak se gjysma e të porsalindurve (45 përqind) ushqehen me gji brenda orës së parë pas lindjes dhe derisa më shumë se katër të pestat (86 përqind) ushqehen me gji brenda ditës së parë pas lindjes, të ushqyerit vetëm (ekskluzivisht) me gji është prevalent për vetëm 40 përqind të fëmijëve nën moshën 6 muajsh që kontribuon në shkallën e të ushqyerit me gji adekuat për moshën për më pak se gjysmën e fëmijëve të moshës 0-23 muajsh (46 përqind). Mesatarja e çfarëdo forme të të ushqyerit me gji është 14.1 muaj për fëmijët nën moshën 3 vjeçare, dhe 2.0 muajsh për të ushqyerit vetëm me gji.

Derisa shumica (90 përqind) e fëmijëve janë ushqyer me së paku numrin minimal të shujtave, vetëm dy të tretat (63 përqind) janë ushqyer me numrin minimal të ushqimeve apo llojllojshmërinë minimale të ushqimit, prandaj më pak se gjysma (49 përqind) e fëmijëve të moshës 6-23 muajsh dhe vetëm një e treta (35 përqind) nga ekonomitë më të varfëra familjare ushqehen me sasinë minimale të pranueshme të ushqimit.

VAKSINIMET

Më pak se katër të pestat (79 përqind) e fëmijëve të moshës 24-35 muaj janë plotësisht të imunizuar në përputhje me kalendarin e imunizimit të Kosovës. Për fat të mirë ka vetëm reduktime të vogla pas secilës dozë të vaksinës, p.sh. doza e parë e Polios merret nga 98 përqind, derisa doza e tretë nga vetëm 91 përqind, që tregon se nga numri tashmë i reduktuar i atyre që fillojnë imunizimin, shumica e kompletojnë serinë e kërkuar të vaksinave, duke e reduktuar mundësinë e marrjes së këtyre sëmundjeve të parandalueshme të fëmijëve. Përderisa mbulueshmëria me vaksinën BCG është shumë e lartë 99 përqind, mezi gjysma e fëmijëve kanë marrur dozën e parë të vaksinës HepB në lindje brenda 24 orëve pas lindjes.

KUJDESI NDAJ SËMUNDJEVE

Më pak se një në dhjetë (nëntë përqind) të fëmijëve nën moshën pesë vjeçare janë raportuar të kenë pasur një episod të diarresë dhe tetë përqind simptoma të infeksioneve akute respiratore (IAR) në dy javët para anketës, përderisa një në pesë fëmijë (21 përqind) kanë pasur temperaturë në dy javët e fundit. Për më shumë se gjysmën e fëmijëve (53 përqind) me diarre nuk është kërkuar këshillim apo trajtim, me 23 përqind të tyre që u është dhënë shumë më pak apo pothuaj asgjë për të ngrënë, duke rezultuar me vetëm një të tretën (35 përqind) e fëmijëve që kanë marrë trajtim rehidratues përmes gojës (ORT) dhe në të njëjtën kohë kanë vazhduar të ushqyerit që është edhe veprim i rekomanduar. Derisa kërkimi i kujdesit shëndetësor për diarre është i ulët, 73 përqind të fëmijëve të moshës 0-59 muaj me simptoma të IAR-së janë dërguar tek ofruesit e kualifikuar, prapë, vetëm 11 përqind të femrave dinë së paku një nga dy shenjat e rrezikut të pneumonisë (frymëmarrja e shpejtuar dhe vështirësi në frymëmarrje).

PËRDORIMI I LËNDËVE TË NGURTA DJEGËSE

Në përgjithësi, gati tri të katërtat (71 përqind) e popullatës së ekonomive familjare përdorin lëndë të ngurta djegëse për gatim, kryesisht të përbëra nga druri (70 përqind) dhe vetëm tetë përqind përdorin këto lëndë djegëse në një dhomë të ndarë që përdoret si kuzhinë, që nënkupton se ka një potencial të lartë për ekspozim ndaj ndotjes së ajrit brenda shtëpisë.

PËRDORIMI I BURIMEVE TË PËRMIRËSUARA TË UJIT

Derisa qasja në burime të përmirësuara të ujit të pijshëm është shumë e lartë në mesatare (99 përqind), vetëm gjysma e ekonomive familjare nga kuintili i më të varfërve kanë ujësjellësin në shtëpi/banesë (55 përqind). Për shtatë përqind të popullatës së ekonomive familjare të cilët nuk kanë burime të ujit të pijshëm në ndërtesë, bartja e ujit deri në ndërtesë bëhet më së shpeshti nga një mashkull i rritur (77 përqind) ose një femër e rritur (19 përqind).

PËRDORIMI I SHËRBIMEVE TË PËRMIRËSUARA TË KANALIZIMIT

Derisa shumica absolute e popullatës në vendbanimet urbane ka qasje në kanalizim të përmirësuar (98 përqind), vetëm 68 përqind të popullatës së ekonomive familjare në vendbanimet rurale kanë të njëjtën qasje, me praktikimin e ambientit të hapur që është i lokalizuar në mesin e popullatës më të varfër. Derisa vetëm një përqind e popullatës në përgjithësi përdorin tualet të përmirësuar që është publik apo i përbashkët me ekonomitë tjera familjare, vlera është pesë përqind për popullatën më të varfër. Pak më shumë se gjysma e popullatës më të varfër (57 përqind) kanë qasje në burime të përmirësuara të ujit të pijshëm dhe kanalizim të përmirësuar derisa proporcioni më i madh është gjetur në mesin e popullatës në vendbanimet urbane (96 përqind). Është për t'u brengosur se vetëm 13 përqind e jashtëqitjes së fëmijëve është mënjanuar në mënyrë të sigurt, me shumicën absolute (85 përqind) që është hedhur në mbeturina.

LARJA E DUARVE

Më pak se dy përqind të ekonomive familjare nuk ishin në gjendje të tregojnë një vend specifik ku anëtarët e ekonomisë familjare zakonisht lajnë duart e tyre dhe vetëm nëntë nga dhjetë (88 përqind) ekonomi familjare kishin sapun apo preparat tjetër pastrimi diku në shtëpi/banesë në krahasim me 93 përqind e më shumë për kuintilët e tjerë të pasurisë.

FERTILITETI

Është me rëndësi të theksohet se lindja e fëmijëve në moshë të hershme ka rënë gradualisht përgjatë 10 viteve të fundit, më së shumti në vendbanimet urbane.

KONTRACEPCIONI

Dy të tretat (66 përqind) e femrave aktualisht të martuara apo në bashkëjetesë kanë raportuar përdorimin aktual të kontracepcionit. Metoda më e popullarizuar, e cila në të vërtetë nuk konsiderohet metodë moderne, është tërheqja, e cila përdoret nga gjysma e femrave të martuara (51 përqind). Metodatat moderne përdoren nga vetëm një në shtatë femra të martuara (14 përqind) dhe nga më pak se dy përqind në mesin e atyre që nuk kanë fëmijë të gjallë. Vendimi për përdorimin e kontraceptivëve duket të jetë në mënyrë tipike vendim i përbashkët i gruas dhe burrit (94 përqind të rasteve).

NEVOJAT E PAPLOTËSUARA

Një në dhjetë femra të martuara (nëntë përqind) kanë shprehur nevoja të paplotësuara për kontracepcion, me vlerën më të lartë në mesin e atyre të moshës 20-24 vjeçare dhe 25-29 vjeçare (14 përkatësisht 16 përqind). Në përgjithësi, shtatë në tetë femra (88 përqind) kanë kërkesa të plotësuara për kontracepcion, me vlera që rriten me moshën nga 78 përqind (të moshës 20-24 vjeçare) në 94 përqind (40-44 vjeçare).

KUJDESI SHËNDETËSOR PARA LINDJES (ANTENATAL)

Pjesa më e madhe e kujdesit antenatal ofrohet nga mjekët (98 përqind) dhe një përqindje relativisht e vogël e femrave (dy përqind) nuk kanë pranuar asnjë formë të kujdesit antenatal. Pothuajse të gjitha nënat (97 përqind) kanë pranuar kujdes antenatal më shumë se një herë dhe 92 përqind kanë pranuar kujdes antenatal minimumin e rekomanduar që është katër herë. Rreth katër të pestat (82 përqind) të femrave që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare kanë pranuar katër ose më shumë vizita antenatale përderisa është pothuajse universale në mesin e atyre që jetojnë në ekonomitë më të pasura familjare. Derisa qasja në kujdesin antenatal në përgjithësi është mjaft e madhe poashtu 95 përqind e femrave kanë pasur vizitën e parë antenatale pas tre-mujorit të parë dhe pesë përqind të femrave më të varfëra nuk kanë pasur kujdes antenatal. Përmbytja më e shpeshtë e kujdesit antenatal ishte ultrazëri (98 përqind të femrave) derisa gjysma (57 përqind e femrave) kanë pasur librin e shëndetit të përditësuar që nënkupton se edhe pse kujdesi antenatal pranohet në masë të madhe, mungon ofrimi i përmbytjes së plotë të mundshme.

ASISTENCA NË LINDJE

Pothuaj të gjitha lindjet (99 përqind) që janë kryer në dy vitet para anketës së MICS-it janë asistuar nga personeli i kualifikuar (90 përqind nga mjekët, dhe nëntë përqind të kryera me asistencë të mamisë/infermieres). Në përgjithësi, një e katërta (27 përqind) e femrave që kanë pasur lindje në dy vitet e fundit kanë kryer lindjen me prerje cezariene me vendimin që është marrur para fillimit të dhimbjeve të lindjes në 18 përqind të rasteve. Përqindja e femrave që kanë lindur në dy vitet e fundit me prerje cezariene është i lartë (33 përqind) në vendbanimet urbane krahasuar me vendbanimet rurale (24 përqind) si dhe në mesin e ekonomive familjare më të pasura (35 përqind). Mjeku ka pasur ndikimin kryesor në marrjen e vendimit që lindja të kryhet me prerje cezariene në 75 përqind të rasteve ndërsa në 16 përqind të rasteve kanë qenë të ndikuara nga femra.

VENDI I LINDJES

Më pak se një përqind të lindjeve kryhen në shtëpi derisa 96 përqind kryhen në institucione shëndetësore publike dhe tre përqind në sektorin privat.

KONTROLLET SHËNDETËSORE PAS LINDJES (POST-NATALE)

Derisa 97 përqind të femrave që kanë kryer lindjet në institucione shëndetësore qëndrojnë në institucione 12 apo më shumë orë pas lindjes, gjysma qëndrojnë dy apo më shumë ditë dhe nëntë përqind kanë qëndruar shtatë ditë apo më shumë. Ajo që është e rëndësishme, pothuajse një në dhjetë (tetë përqind) e të porsalindurve nuk kanë pranuar asnjë vizitë pas lindjes (post-natale) pas lëshimit nga institucionet shëndetësore, kjo vlerë është e lartë 15 përqind për të porsalindurit nga nënat më të vjetra në moshë. Të gjitha (100 përqind) vizitat e kujdesit shëndetësor pas lindjes për të porsalindurit brenda javës së parë pas lëshimit nga institucionet shëndetësore janë ofruar nga mjeku / infermierja / mamia dhe 60 përqind kryhen në sektorin publik. Derisa shumica (92 përqind) e të porsalindurve janë vizituar pas lëshimit nga institucioni shëndetësor, me pak se gjysma e nënave janë vizituar për të kontrolluar shëndetin e tyre (43 përqind). 38 përqind e femrat që kanë pasur lindje me prerje cezariene nuk janë vizituar pas lëshimit nga institucioni shëndetësor dhe 68 përqind e tyre nga ekonomitë më të varfëra familjare nuk kanë pranuar asnjë formë të kujdesit shëndetësor të pas lindjes pas lëshimit nga institucioni shëndetësor.

ABORTET

Në përgjithësi, tetë përqind të femrave të moshës 15-49 vjeçare kanë pasur një abort të qëllimshëm, dhe kjo rritet në 17 përqind në mesin e femrave të moshës 45-49 vjeçare. Në mesin e femrave që kanë pasur aborte, prej tyre 25 përqind kanë pasur dy ose tre aborte, derisa katër përqind kanë pasur katër apo më shumë aborte.

KUJDESI DHE ARSIMIMI NË FËMIJËRI TË HERSHME

Vetëm një në shtatë (14 përqind) të fëmijëve të moshës 36-59 muajsh ka vijuar një program të organizuar të arsimit të hershëm dhe vetëm nëntë përqind në vendbanimet rurale dhe shtatë përqind në mesin e fëmijëve të ekonomive më të varfëra familjare.

CILËSIA E KUJDESIT

Për vetëm dy të tretat (66 përqind) e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh, është angazhuar një anëtar i rritur i ekonomisë familjare në katër apo më shumë aktivitete që promovojnë të mësuarit dhe gatishmërinë për shkollë gjatë tri ditëve para anketës. Përfshirja e babait në aktivitete të tilla ishte kufizuar në ekstrem me vetëm gjashtë përqind derisa 43 përqind të nënave janë angazhuar me fëmijët e tyre në aktivitete të tilla. Për më tepër, vetëm një e treta (31 përqind) e fëmijëve nën pesë vjeç jetojnë në ekonomi familjare ku ka së paku tre libra për fëmijë derisa proporcioni i fëmijëve me 10 e më shumë libra zbret në vetëm 10 përqind.

INDEKSI I ZHVILLIMIT NË FËMIJËRI TË HERSHME (IZHFH)

Katër të pestat (83 përqind) e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh janë në hap të duhur të zhvillimit, me një shkallë më të lartë të IZHFH-së tek fëmijët që vijnë në një program të arsimit të hershëm (90 përqind). Përderisa 97 përqind e fëmijëve janë në hap me zhvillimin nga aspekti fizik dhe 96 në fushën e të mësuarit, vetëm 83 përqind janë në hap me zhvillimin social-emocional dhe më pak se një në pesë (18 përqind) janë në hap me zhvillimin në fushën e shkrim-leximit dhe numërimit.

SHKRIM-LEXIMI TE FEMRAT E REJA DHE MESHKUJT E RINJ

Pothuajse të gjitha (98 përqind) femrat e reja të moshës 15-24 vjeçare dinë shkrim-lexim dhe 93 përqind e atyre që kanë deklaruar se shkolla e mesme e ulët ishte niveli më i lartë i arsimit të tyre ishin në gjendje të lexojnë. Shkalla e shkrim-leximit në mesin e meshkujve të rinj të moshës 15-24 vjeçare ka qenë e ngjashme me 98 përqind, me vetëm 82 përqind të meshkujve që kanë deklaruar se shkolla e mesme e ulët ishte niveli më i lartë i arsimit të tyre kanë qenë në gjendje të lexojnë.

GATISHMËRIA PËR SHKOLLË

Tri të katërtat (76 përqind) e fëmijëve që aktualisht vijnë klasën e parë të shkollës fillore kanë vijuar nivelin parashkollor në vitin paraprak dhe 64 përqind të fëmijëve të ekonomive më të varfëra familjare.

PJESËMARRJA NË SHKOLLË FILLORE DHE TË MESME

Shumica e fëmijëve të moshës së shkollës fillore janë duke vijuar shkollën (98 përqind), prapë vetëm 92 përqind të fëmijëve të moshës së fillimit të shkollës fillore (mosha 6 vjeçare) vijnë në klasën e parë të shkollës fillore. Dy përqind e fëmijëve të moshës së shkollës fillore janë jashtë shkollës dhe një e dhjeta (10 përqind) e fëmijëve meshkuj të moshës 6 vjeçare janë jashtë shkollës. Ngjashëm si me shkollën fillore, 96 përqind e fëmijëve janë duke vijuar shkollën e mesme të ulët apo më të lartë. Është vërejtur një korrelacion pozitiv me arritjen në nivelin e arsimit të nënës; në mesin e nënave që nuk kanë arsim, proporcioni i fëmijëve që ndjekin shkollën e mesme të ulët është 86 përqind, derisa është 98 përqind tek fëmijët nëna e të cilëve ka nivelin e arsimit të shkollës së mesme të ulët. Vetëm katër të pestat (82 përqind) e fëmijëve janë duke vijuar shkollën e mesme të ulët. Nga një e pesta e mbetur shumica (14 përqind) janë komplet jashtë shkollës. Një e pesta (21 përqind) e fëmijëve vajza nga vendbanimet rurale janë jashtë shkollës krahasuar me 13 përqind të djemve. Derisa një në shtatë fëmijë (14 përqind) vijnë në arsimimin në fëmijëri të hershme, të gjithë fëmijët që fillojnë klasën e parë eventualisht do të arrijnë klasën e pestë dhe shkalla e përfundimit të shkollës fillore është 97 përqind. Fatmirësisht, të gjithë fëmijët kalojnë nga shkolla fillore në të mesme të ulët me shkallët e vijueshmërisë në 98 përqind. Tranzicioni në shkollën e mesme të lartë është 92 përqind dhe shkallët e vijueshmërisë janë rreth 90 përqind.

Barazia gjinore për shkollën fillore është afër 1.00, që tregon se nuk ka dallime gjinore në vijueshmërinë e shkollës fillore nga vajzat dhe djemtë, treguesi bie në 0.99 për arsimin e mesëm të ulët, dhe edhe më ulët në 0.96 për arsimin e mesëm të lartë. Disavantazhi i vajzave është veçanërisht i theksueshëm në vendbanimet rurale në nivelin e mesëm të lartë (0.92) si dhe në mesin e fëmijëve që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare (0.90).

REGJISTRIMI I LINDJEVE

Mëse 74 përqind të fëmijëve posedojnë certifikatë të lindjes, lindjet e 88 përqind të fëmijëve nën pesë vjeç janë raportuar si të regjistruara, ku regjistrimi bëhet më i mundshëm me rritjen e fëmijëve. Fatkeqësisht, një e katërta (23 përqind) e nënave të fëmijëve të pa regjistruar nuk e dinë se si duhet regjistruar fëmijën.

FËMIJËT NË PUNË

Tetë përqind e fëmijëve të moshës 15-11 vjeçare, 14 përqind të moshës 12-14 vjeçare, dhe 26 përqind të moshës 15-17 vjeçare janë të angazhuar në aktivitete ekonomike. Fëmijët e gjinisë mashkullore të moshës 5-11 vjeçare kanë më shumë të ngjarë të përfshihen në aktivitete ekonomike. Puna e bazuar në aktivitetet ekonomike në mesin e fëmijëve të moshës 12-14 vjeçare është më e shprehur në vendbanimet rurale (tetë përqind) sesa në vendbanimet urbane (një përqind). Në përgjithësi 16 përqind e fëmijëve meshkuj dhe pesë përqind e fëmijëve femra janë të angazhuar në punë. Shtatë përqind e fëmijëve të moshës 5-17 janë duke punuar nën kushte të rrezikshme dhe 12 përqind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare që nuk janë duke vijuar shkollën janë të përfshirë në punë.

DISIPLINIMI I FËMIJËVE

Tri të pestat (61 përqind) e fëmijëve të moshës 1-14 vjeçare kanë qenë subjekt i së paku një forme të ndëshkimit psikologjik apo fizik nga anëtarët e ekonomive familjare, gjatë muajit të kaluar, dhe 24 përqind kanë përjetuar ndëshkim fizik. Derisa vetëm një e treta (31 përqind) e fëmijëve janë disiplinuar në mënyrë jo të dhunshme, gjashtë përqind kanë qenë subjekt i ndëshkimeve të rënda (goditja e fëmijës në kokë, vesh ose fytyrë apo goditja e fëmijës në forma të rënda dhe të përsëritura). Një e dhjeta (10 përqind) e respondentëve të pyetësorit të ekonomisë familjare besojnë se ndëshkimi fizik është pjesë e domosdoshme e rritjes-edukimit të fëmijëve.

MARTESA E HERSHME DHE POLIGAMIA

Proporcioni i femrave të martuara apo në bashkëjetesë deri në moshën 15 dhe 18 vjeçare ka rënë gradualisht me kohën. Një përqind e femrave të moshës 15-49 vjeçare janë martuar para moshës 15 vjeçare, një e dhjeta (10 përqind) e femrave të moshës 20-49 vjeçare janë martuar para moshës 18 vjeçare. Rreth tre përqind e femrave të reja 15-19 vjeçare janë aktualisht të martuara.

QËNDRIMET NDAJ DHUNËS NË FAMILJE

Në përgjithësi, një e treta (33 përqind) e femrave ndjejnë se burri arsyetohet të rrahë apo godet gruan e tij në së paku një nga pesë situatat. Femrat në shumicën e rasteve pajtohen dhe e arsyetojnë dhunën në rastet kur gruaja neglizhon fëmijët (28 përqind) apo demonstroi autonominë e saj, për shembull duke dalë jashtë shtëpisë pa i treguar burrit të saj (17 përqind) apo fjalosja me të (14 përqind). Rreth një e dhjeta e femrave besojnë se rrahja e gruas arsyetohet nëse gruaja refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me burrin dhe pesë përqind nëse ajo e djeg ushqimin. Arsytimi në secilën nga pesë situatat është më pak prezent në mesin e atyre që jetojnë në ekonomitë familjare më të pasura, më të arsimuara, dhe te femrat asnjëherë të martuara. Me rritjen e nivelit të arsimimit, femrat kanë më pak të ngjarë të arsyetojnë rrahjen apo goditjen e gruas nga burri i tyre, me 68 përqind që pajtohen prej atyre që nuk kanë arsimim, në krahasim me nëntë përqind të atyre që pajtohen që kanë arsimim të lartë. Në përgjithësi, meshkujt kanë më pak të ngjarë të arsyetojnë dhunën se sa femrat me 15 përqind të meshkujve që arsyetojnë rrahjen e gruas për cilëndo nga pesë situatat.

MODALITETET E JETESËS SË FËMIJËVE

Një proporcion shumë i vogël i fëmijëve kanë humbur njërin apo të dy prindërit me 92 përqind të fëmijëve të moshës 0-17 vjeçare që jetojnë me të dy prindërit dhe më pak se një përqind që nuk jetojnë më asnjërin nga prindërit biologjik derisa të dy prindërit janë gjallë.

NJOHURITË RRETH BARTJES SË HIV-IT DHE KEQKUPTIMET RRETH HIV-IT

Shumica (91 përqind) e femrave të moshës 15-49 vjeçare dhe meshkujve të moshës 15-49 vjeçare kanë dëgjuar për AIDS-in. Prapë, përqindja e atyre që dinë për të dyja mënyrat e parandalimit të bartjes së HIV-it – duke pasur vetëm një partner seksual besnik të pa infektuar dhe duke përdorur çdo herë kondom – është vetëm 60 përqind për femrat dhe 81 përqind për meshkujt. Personat që kanë njohuri të përgjithshme për parandalimin e

HIV-it përfshinë ata që dinë dy mënyrat kryesore të parandalimit të HIV-it (të pasurit e vetëm një partneri seksual besnik të pa infektuar dhe duke përdorur çdo herë kondomin), të cilët dinë se një person në dukje i shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv, dhe që refuzojnë keqkuptimet më të shpeshta. Njohuritë e përgjithshme për metodat e parandalimit dhe bartjes së HIV-it janë të vogla me 15 përqind te femrat dhe 20 përqind te meshkujt.

Përgjithësisht, tri të katërtat (73 përqind të femrave dhe 72 përqind të meshkujve) dinë se HIV-i mund të bartet nga nëna tek fëmija. Përqindja e femrave dhe meshkujve që dinë të tri mënyrat e bartjes nga nëna te fëmija është rreth (45 përqind) dhe një e katërta (38 përqind) përkatësisht, me 18 përqind të femrave dhe 21 përqind të meshkujve që nuk kanë ditur asnjë mënyrë specifike.

QËNDRIMET PRANUESE NDAJ NJERËZVE QË JETOJNË ME HIV

Derisa pajtueshmëria me së paku një nga qëndrimet pranuese është përgjithësisht universale (kryesisht për arsye të nivelit të lartë të gatishmërisë për tu kujdesur për një anëtarë të familjes me AIDS në shtëpinë e tyre), shprehja e qëndrimeve pranuese për të gjithë të katër treguesit është pothuaj jo ekzistente me gjashtë përqind për femrat dhe tetë përqind për meshkujt.

NJOHURITË RRETH VENDIT PËR TESTIM PËR HIV, KËSHILLIMI DHE TESTIMI GJATË KUJDESIT ANTENATAL

Derisa vetëm 16 përqind të femrave dhe 31 përqind të meshkujve e dinë se ku duhet testuar, vetëm tre përqind përkatësisht shtatë përqind janë testuar me më pak se një përqind të femrave dhe shtatë përqind të meshkujve që dinë rezultatet e testeve më të fundit. Derisa mbulimi me kujdes antenatal nga profesionistët shëndetësor për shtatzënësinë e fundit është pothuaj universal (98 përqind), vetëm katër përqind rasteve janë këshilluar për HIV dhe dy përqind të rasteve u është ofruar testimi për HIV-in gjatë kujdesit antenatal dhe janë testuar për HIV.

SJELLJA SEKSUALE E LIDHUR ME BARTJEN E HIV-IT

Asnjë femër dhe shtatë përqind të meshkujve të moshave 15-49 vjeçare kanë raportuar të kenë pasur marrëdhënie seksuale me më shumë se një partner në 12 muajt e fundit, me një të tretën e meshkujve që kanë raportuar të kenë përdorur kondomin gjatë marrëdhënies seksuale të fundit.

TREGUESIT E HIV-IT PËR FEMRAT E REJA DHE MESHKUJT E RINJ

Njohuritë për bartjen e HIV-it nga nëna te fëmija dhe njohuritë për vendin se ku mund të bëhet testimi për HIV janë kryesisht më të ulëta tek grup moshë 15-24 vjeçare sesa te popullata e grup moshave më të vjetra. Në përgjithësi, një e katërta (25 përqind) e femrave të reja dhe më shumë se gjysma (48 përqind) e meshkujve të rinj kanë raportuar të kenë pasur ndonjëherë marrëdhënie seksuale dhe më pak se një përqind përkatësisht katër përqind para moshës 15 vjeçare. Për më tepër, më pak se një përqind e femrave të reja kanë pasur marrëdhënie seksuale me më shumë se një partner në 12 muajt e fundit derisa shifra për meshkujt e rinj ishte nëntë përqind. Shtatë përqind e femrave të reja dhe 37 përqind e meshkujve të rinj kanë pasur marrëdhënie seksuale në 12 muajt e fundit me një partner jashtë-martesor që nuk janë në bashkëjetesë, ku vetëm një e treta (37 përqind) e këtyre femrave dhe dy të tretat (67 përqind) e këtyre meshkujve kanë përdorur kondom gjatë marrëdhënies së tyre të fundit seksuale.

SYNETIA E MESHKUJVE

Synetia e meshkujve është pothuaj universale (92 përqind) ku shumica i nënshtrohen procedurës në moshën 5-9 vjeçare (49 përqind), moshën 10-14 vjeçare (37 përqind), pasuar nga moshë 1-4 vjeçare (nëntë përqind). Punëtori shëndetësor/profesionalisti, është personi më i shpeshtë që kryen procedurën e synetisë (57 përqind në mesatare) për 17 përqindëshin e grup moshës më të vjetër në krahasim me 86 përqind për grup moshën më të re që tregon një dallim në zgjedhjen e ofruesit gjatë kohës. Një e katërta (24 përqind) e synetive të meshkujve të moshës 15-24 vjeçare ndodhin në shtëpi, derisa dy në tre (64 përqind) në institucione private shëndetësore.

QASJA NË MAS-MEDIA

Meshkujt e moshës 15-49 vjeçare raportojnë nivel më të lartë të ekspozimit ndaj të gjitha tri llojeve të mediave sesa femrat. Vetëm 44 përqind e femrave në Kosovë lexojnë gazetë apo revistë, 48 përqind dëgjojnë radion, dhe 99 përqind shikojnë televizor së paku një herë në javë. Përgjithësisht, një përqind nuk kanë ekspozim të rregullt ndaj cilësdos nga të tri mediat, derisa 99 përqind janë ekspozuar ndaj së paku njëres dhe 23 përqind ndaj të

gjithave, të tri llojeve të mediave në baza javore. Së paku një herë në javë 66 përqind të meshkujve lexojnë gazeta apo revista, 63 përqind dëgjojnë radion, dhe 98 përqind shikojnë televizorin. Një përqind nuk kanë ekspozim të rregullt ndaj ndonjëres nga tri mediat. Të gjithë meshkujt (100 përqind) u ekspozohen së paku njëherë dhe 42 përqind ndaj të gjitha, të tri llojeve të mediave në baza javore.

SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE/KOMUNIKIMIT

Në përgjithësi, pothuajse të gjitha (97 përqind) femrat e moshës 15-24 vjeçare kanë përdorur ndonjëherë internetin dhe rreth katër të pestat (82 përqind) e femrave me arsimim të mesëm të ulët raportojnë të kenë përdorur kompjuterin gjatë vitit të fundit në krahasim me pothuaj të gjitha femrat (99 përqind) me arsimim të lartë. Përdorimi i internetit gjatë vitit të fundit është më i larti në mesin e femrave të reja në ekonomitë familjare më të pasura (100 përqind), kundrejt atyre që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare (84 përqind).

87 përqind e meshkujve të rinj në ekonomitë më të varfëra familjare kanë përdorur internetin gjatë vitit të fundit në krahasim me përdorimin universal në mesin e meshkujve të rinj në ekonomitë më të pasura familjare (100 përqind). 93 përqind të meshkujve 15-24 vjeçare kanë përdorur kompjuter gjatë vitit të fundit dhe 98 përqind kanë përdorur internetin së paku një herë gjatë jetës së tyre.

MIRËQENIA SUBJEKTIVE

92 përqind e femrave të moshës 15-24 vjeçare janë të kënaqura me jetën e tyre në përgjithësi me shifrat që ndryshojnë nga 86 përqind për femrat e reja që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare në 96 përqind të atyre që jetojnë në ekonomitë familjare më të pasura që tregojnë për një raport të ngushtë mes pasurisë dhe kënaqshmërisë me jetën. 90 përqind të femrave dhe 83 përqind të meshkujve të moshës 15-24 vjeçare janë shumë apo deri diku të lumtur me gjysmën (52 përqind) e femrave dhe gjysmën (57 përqind) e meshkujve që mendojnë se jeta e tyre është përmirësuar gjatë vitit të fundit dhe presin që jeta e tyre do përmirësohet pas një viti.

PËRDORIMI I DUHANIT

Derisa tri të katërtat (78 përqind) e meshkujve dhe gjysma e femrave (47 përqind) raportojnë të kenë përdorur ndonjëherë produkte duhani, 34 përqind të meshkujve dhe 19 përqind të femrave kanë tymosur cigare, apo kanë përdorur produkte duhani të tymosura apo të pa tymosura gjatë muajit të fundit. Një e pesta (18 përqind) e femrave dhe më shumë se një e treta e meshkujve (37 përqind) të moshës 15-49 vjeçare që aktualisht tymosin duhan, jetojnë në të njëjtat ekonomi familjare më së paku një fëmijë nën moshën pesë vjeçare. Pothuajse një e treta (29 përqind) e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare kanë pirë një cigare para moshës 15 vjeçare në krahasim me pesë përqind të femrave. Dy të tretat (63 përqind) të meshkujve dhe një e katërta (23 përqind) e femrave kanë tymosur më shumë se 20 cigare në 24 orët e fundit, ndërsa 87 përqind e meshkujve dhe 51 përqind e femrave kanë tymosur 10 apo më shumë cigare në 24 orët e fundit.

KONSUMIMI I ALKOOLIT

Proporcioni i meshkujve që konsumojnë alkool është dukshëm më i lartë se sa te femrat me 35 përqind të meshkujve të moshës 15-49 vjeçare që kanë pirë së paku një pije alkoolike në muajin e fundit në krahasim me 10 përqind të femrave të së njëjtës moshë. Konsumimi i alkoolit para moshës 15 vjeçare është më i lartë në mesin e meshkujve (11 përqind) sesa në mesin e femrave (një përqind). Derisa 77 përqind e femrave nuk kanë konsumuar asnjëherë pije alkoolike, e njëjta është e vërtetë vetëm për një të tretën (32 përqind) e meshkujve.



I. HYRJE

HISTORIKU

Ky raport është i bazuar në Anketën e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MISC) të kryer në vitin 2013-2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa ofron të dhëna statistike të besueshme dhe ndërkombëtare të krahasueshme për të fuqizuar zhvillimin e politikave dhe programeve të bazuara në dëshmi, dhe për monitorimin e progresit drejt qëllimeve dhe përkushtimeve globale. Në mesin e këtyre përkushtimeve globale, janë ato që burojnë nga Deklarata “Një Botë e Përshtatshme për Fëmijët” dhe Plan i Veprimit, qëllimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Sesionit të Veçantë mbi HIV/AIDS, Deklaratës Arsimim për të gjithë, dhe Objektive Zhvillimore të Mijëveçarit (OZHM).

Një përkushtim për veprim: Përgjegjësitë Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Raportimit

Qeveritë që kanë nënshkruar Deklaratën e Mijëveçarit dhe Deklaratën për Botë të Përshtatshme për Fëmijët si dhe Planin e Veprimit, janë angazhuar se do të monitorojnë progresin drejt qëllimeve dhe objektive që këto marrëveshje përmbajnë:

“Ne do monitorojmë rregullisht në nivelin kombëtar dhe sipas nevojës edhe në nivel rajonal dhe vlerësojmë progresin ndaj qëllimeve dhe objektive të Planit të tanishëm të Veprimit në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Prandaj, ne do të fuqizojmë kapacitetin tonë kombëtar në aspektin e statistikave për të grumbulluar, analizuar dhe klasifikuar të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe faktorëve tjerë relevant që mund të çojnë tek ndryshimet dhe mbështesin një varg veprimtarish hulumtuese të fokusuara tek fëmijët. Ne do rrisim bashkëpunimin ndërkombëtar për të mbështetur përpjekjet për krijimin dhe rritjen e kapaciteteve statistikore dhe për të ngritur kapacitetet e komunitetit për monitorim, vlerësim dhe planifikim.”

“(Një Botë të Përshtatshme për Fëmijët, paragrafi 60)

“...Ne do të bëjmë shqyrtime periodike në nivelet kombëtare dhe lokale për të adresuar pengesat në mënyrë më me efikasitet dhe të përshpejtojmë veprimet...”

Një Botë të Përshtatshme për Fëmijët, paragrafi 61

Plan i Veprimit i Botës së Përshtatshme për Fëmijët (paragrafi 61) po ashtu bën thirrje për angazhimin e veçantë të UNICEF-it në përgatitjen e raporteve periodike të progresit:

“... Si agjencia kryesore botërore për fëmijët, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në bashkëpunim të ngushtë me qeveritë, kërkohet të vazhdojë të përgatisë dhe të shpërndajë fonde të caktuara, si edhe të pajisë të gjitha agjencitë e specializuara të sistemit të Kombeve të Bashkuara, si edhe të gjithë aktorët e tjerë me informacionin e nevojshëm rreth progresit të shënuar drejt zbatimit të Deklaratës dhe Planit për Veprim.”

Në të njëjtën mënyrë edhe **Deklarata e Mijëveçarit** (paragrafi 31) kërkon raportime periodike rreth progresit:

“...Ne kërkojmë që Asambleja e Përgjithshme të rishikojë në mënyrë periodike progresin e shënuar në zbatimin e dispozitave të kësaj Deklarate, dhe i lutemi Sekretarit të Përgjithshëm të nxjerrë raporte periodike të cilat shqyrtohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe që do të shërbejnë si bazë për veprime të tjera në të ardhmen.”

Fokusi i programit të UNICEF-it në rajonin e Ballkanit funksionon në kontekst të Integritimit Evropian, duke i'u përgjigjur nevojës për të fuqizuar planifikim të bazuar në dëshmi dhe vendim-marrje të bazuar në informata. Bazuar në funksionimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit, përgjegjësia sociale është një parametër i rëndësishëm në këtë proces të pozicionuar në mënyrë unike në rajon, ku Kosova edhe sot është duke u ballafaquar me mungesa të mëdha në sektorin e informimit. Mungesa e sistemeve të menaxhimit të të dhënave dhe të dhënat ekzistuese jo të sakta të kombinuara me kapacitet të ulët teknik janë barriera të mëdha në përdorimin e të dhënave për planifikim dhe monitorim.

Duke mundësuar të kuptuarit e pasojave, monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të programeve dhe të arriturave e rezultateve do të ndihmojnë dhe përmirësojnë njohuritë kolektive mbi fëmijët dhe femrat në Kosovë, do të mbështesin partnerët zhvillimorë të ndihmojnë popullatat që ka gjasa të përjashtohen dhe t'i'u përgjigjen kërkesave që ngriten në atë fushë. Të dhënat efektive dhe menaxhimi i njohurive i shërbejnë kapaciteteve për veprime efektive dhe për arritjen e rezultateve të matshme për fëmijët dhe femrat.

MICS në Kosovë është i destinuar të mbështes të dhëna të cilësisë së lartë për fëmijët duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programeve dhe përgjegjësisë së autoriteteve respektive (p.sh. institucioneve të Kosovës) dhe personave në fokus (p.sh. femrave dhe fëmijëve si dhe përfituesve të tjerë kryesor). Gjetjet e anketës janë burim i rëndësishëm i informatave për monitorimin dhe implementimin e “Strategjisë dhe Planit të Veprimit mbi të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013” si dhe përkushtimeve tjera që vijnë nga proceset e integritimit evropian dhe parimeve të të drejtave të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Kosovës. Për më tepër, gjetjet do shërbejnë si plotësim i të dhënave administrative dhe statistikave zyrtare.

MICS-i në Kosovë është bërë paralelisht me MICS-in me komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovës 2013-2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës duke përdorur të njëjtën metodologji dhe vegla anketimi por të bazuar në mostër të ndarë. Rezultatet e asaj ankete janë të prezantuara në një raport tjetër anketimi.

MICS-i në Kosovë pritet të kontribuojë si dëshmi e bazuar në evidencë për iniciativa të ndryshme të rëndësishme, përfshirë Zotimin për Mbijetesë të Fëmijëve: Një Premtim i Përtërirë, një lëvizje globale për të parandaluar vdekjet e fëmijëve nga shkaqet e parandalueshme, dhe kornizës së përgjegjësisë të propozuar nga Komisioni për Informim dhe Përgjegjësi për Strategjinë Globale për Shëndetin e Femrës dhe Fëmijës.

OBJEKTIVAT E ANKETËS

MICS-i në Kosovë 2013-2014 ka si objektiva primare:

- Të ofrojë informata të fundit për vlerësimin e gjendjes së femrave në Kosovë;
- Të gjenerojë të dhënat për vlerësimin kritik mbi progresin e bërë në fushat e ndryshme dhe të bëjë përpjekje shtesë në ato fusha që kërkojnë vëmendje të shtuar;
- T’i grumbullojë të dhënat të zbërthyera për identifikimin e pabarazive për të mundësuar zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi për përfshirjen sociale e më të cënueshme;
- Të kontribuojë në gjenerimin e një baze për të dhënat për agjendën pas vitit 2015;
- Të vërtetojë të dhënat nga burime të tjera dhe rezultatet e intervenimeve të fokusuara.





II. MOSTRA DHE METODOLOGJIA E ANKETËS

DIZAJNI I MOSTRËS

Mostra për Anketën e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë u dizajnuar për të ofruar vlerësime për një numër të madh të treguesve mbi gjendjen e fëmijëve dhe femrave në nivel të Kosovës, urban dhe rural. Vendbanimet urbane dhe rurale brenda të shtatë rajoneve (Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj) janë identifikuar si strata të mostrës dhe mostra është përzgjedhur në dy faza. Brenda secilës stratë, një numër i specifikuar i qarkut regjistruar të regjistrimit të popullësisë është përzgjedhur në mënyrë sistematike me probabilitet proporcional të madhësisë. Pasi që është kryer listimi i ekonomive familjare në qarqet regjistruese të përzgjedhura, një mostër sistematike prej 16 ekonomive familjare është përcaktuar në secilin qark regjistruar. Madhësia e përcaktuar e mostrës ka qenë 4,800 ekonomi familjare me gjithsej 300 qarqe regjistruese të përzgjedhura. Pyetësi për meshkujt e moshës 15-49 vjeçare është administruar në gjysmën e ekonomive familjare të përzgjedhura në secilin qark regjistruar. Të gjitha qarqet regjistruese janë vizituar gjatë periudhës së punës në terren. Mostra është stratifikuar sipas rajoneve, vendbanimeve urbane dhe rurale, dhe nuk është e vet peshuar (ponderuar). Për raportimin e rezultateve në nivelin e Kosovës, janë përdorur mostrat e peshuara. Një përshkrim më i detajuar mund të gjendet në Shtojcën A, në dizajnin e mostrës.

PYETËSORËT

Katër sete të pyetësorëve janë përdorur në anketë: 1) një pyetësor për ekonomitë familjare i cili është përdorur për të mbledhur informata themelore demografike për të gjithë anëtarët e ekonomive familjare *de jure* (banorët e zakonshëm), ekonomitë familjare dhe banesat/shtëpitë; 2) një pyetësor individual për femra të administruar në secilën ekonomi familjare për të gjitha femrat e moshës 15-49 vjeçare; 3) një pyetësor individual për meshkujt të administruar në çdo të dytën ekonomi familjare për të gjithë meshkujt e moshës 15-49 vjeçare; 4) një pyetësor për fëmijët nën 5 vjeç, të administruar tek nënat (apo kujdestarët) për të gjithë fëmijët nën moshën 5 vjeçare që jetojnë në ekonomitë familjare; si dhe është administruar një pyetësor për regjistrimin e vaksinimit në institucionet shëndetësore për të gjithë fëmijët nën moshën 3 vjeçare.

Pyetësorët kanë përfshirë modulet në vijim:

Pyetësi i Ekonomive Familjare ka përfshirë modulet në vijim:

- Lista e anëtareve të ekonomisë familjare
- Arsimiti
- Fëmijët në punë
- Disiplinimi i fëmijëve
- Karakteristikat e Ekonomisë Familjare
- Uji dhe kanalizimi
- Larja e duarve

Pyetësi individual për Femra është administruar tek të gjitha femrat e moshës 15-49 vjeçare që jeton në ekonomitë familjare i cili ka përfshirë modulet në vijim:

- Historia e Femrës
- Çasja në Masmedia dhe Përdorimi i Teknologjisë Informative/Komunikimit
- Fertiliteti/Historia e lindjeve
- Dëshira për Lindjen e Fundit
- Shëndeti i Nënës dhe i të Porsalindurit⁶
- Kontrollat Shëndetësore Post-natale
- Simptomet e Sëmundjeve
- Kontracepcioni⁷
- Nevoja e Paplotësuar
- Qëndrimet ndaj Dhunës në Familje
- Martesa/Bashkëjetesa

⁶ Në këtë modul është përfshirë një pyetje specifike për anketën në lidhje me ndikimin kryesorë për të pasur prerje cezariene.

⁷ Në këtë modul është përfshirë një pyetje specifike për anketën në lidhje me burimin e metodave kontrceptive moderne dhe nga kush është marrur vendimi për përdorimin e kontracepcionit.

- Sjellja Seksuale
- HIV/AIDS
- Përdorimi i Duhanit dhe Alkoolit
- Kënaqshmëria me Jetën

Pyetësi individual për Meshkuj është administruar tek të gjithë meshkujt e moshës 15-49 vjeçare të nën-mostrës së përzgjedhur në të cilin janë përfshirë modulet në vijim:

- Historia e Mashkullit
- Çasja në Masmedia dhe Përdorimi i Teknologjisë Informative/Komunikimit
- Fertiliteti
- Qëndrimet ndaj Dhunës në Familje
- Martesa/Bashkëjetesa
- Sjellja Seksuale
- HIV/AIDS
- Synetia
- Përdorimi i Duhanit dhe Alkoolit
- Kënaqshmëria me Jetën

Pyetësi për Fëmijët nën moshën Pesë Vjeçare është administruar tek nënat (apo kujdestarët) e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare⁸ që jetojnë në ekonomi familjare. Normalisht, pyetësi është administruar tek nënat e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare; në rastet kur nëna nuk ishte në listën e ekonomisë familjare, atëherë është identifikuar kujdestari primar i fëmijës dhe është intervistuar. Pyetësi ka përfshirë modulet në vijim:

- Mosha
- Regjistrimi i lindjes
- Zhvillimi në Fëmijëri të Hershme
- Gjdhënia dhe Marrja e Ushqimeve
- Imunizimi
- Kujdesi ndaj Sëmundjeve
- Antropometria

Për të gjithë fëmijët e moshës 0-2 vjeçare për të cilët është plotësuar Pyetësi për Fëmijët nën 5 vjeç, është përdorur një formë tjetër e veçantë për përshkrimin e vaksinave të regjistruara në institucionet shëndetësore. Edhe pse ka qenë e pritshme që të gjitha kartelat e vaksinimit për fëmijët nën moshën 3 vjeçare të gjinden tek secili prind, ka qenë e nevojshme të vizitohen edhe institucionet shëndetësore duke konsideruar ndryshimet e bëra në kalendarin e vaksinimit të vitit 2010, në mënyrë që të sigurohet saktësia e mbledhjes së të dhënave dhe të evitohen komplikimet e mundshme. Stafi i terrenit të MICS-it është dashur të përshkruaj informatat e vaksinimit nga kartela e imunizimit të fëmijëve në institucionet shëndetësore.

Pyetësorët janë të bazuar në modelin e pyetësorëve MICS5⁹. Nga versioni anglisht i modelit MICS5, pyetësorët janë përshtatur dhe përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë para-testuar në komunat e Lipjanit, Mamushës, Prishtinës dhe Zveçanit gjatë gushtit 2013. Bazuar në rezultatet e para-testit, janë bërë modifikime në përkthimin dhe frazimin e pyetësorëve. Një kopje e pyetësorëve të MICS-it për Kosovë është prezantuar në Shtojcën F.

Përveç administrimit të pyetësorëve, ekipet e terrenit kanë vëzhguar vendet për pastrimin e duarve dhe po ashtu kanë bërë matjen e peshës dhe gjatësisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare. Detajet dhe të gjeturat e këtyre vëzhgimeve dhe matjeve janë ofruar në seksionet përkatëse në këtë raport.

TRAJNIMI DHE PUNA NË TERREN

Trajnimi për punën në terren është mbajtur për 17 ditë gjatë muajit shtator, mirëpo një numër i pamjaftueshëm i stafit kishte plotësuar kriteret e domosdoshme, si pasojë është hapur një thirrje publike për vende pune, e cila u pasua me një trajnim tjetër 20 ditor në tetor dhe nëntor të vitit 2013. Trajnimi ka përfshirë ligjërata mbi teknikat e intervistimit dhe përmbajtjen e pyetësorëve, dhe intervista testuese mes pjesëmarrëse për të fituar përvojë praktike në parashtrimin e pyetjeve. Rreth fundit të periudhës së trajnimit, të trajnuarit kanë kaluar tri ditë në praktikë duke bërë intervista testuese në komunën e Prishtinës.

⁸ Termet "fëmijët nën moshën 5 vjeç", "fëmijët e moshës 0-4 vjeç", dhe "fëmijët e moshës 0-59 muajsh" përdoren duke zëvendësuar njëri tjetrin në këtë raport.

⁹ Modeli i pyetësorëve të MICS5 mund të gjendet në: http://www.childinfo.org/mics5_questionnaire.html

Të dhënat janë mbledhur nga shtatë ekipe; secili ekip është përbërë nga katër intervistues, një vozitës, një redaktor, një matës dhe një mbikëqyrës. Ekipet e terrenit janë përbërë nga intervistues femra dhe meshkuj, ku intervistueset femra kanë administruar pyetësorët individual për femra, ndërsa intervistuesit meshkuj kanë administruar pyetësorët individual për meshkuj. Puna në terren filloi në nëntor 2013 dhe përfundoi në Prill 2014.

PROCESIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat janë futur duke përdorur programin CPro, Versioni 5.0. Të dhënat janë futur në 7 kompjuterë desktop dhe janë koduar nga shtatë operatorë të të dhënave dhe një mbikëqyrës i futjes së të dhënave. Për qëllime të sigurimit të cilësisë, kanë qenë edhe dy administratorë të pyetësorëve dhe dy kontrollorë dytësorë, po ashtu të gjithë pyetësorët janë futur dy herë dhe janë bërë kontrole të brendshme të përputhshmërisë së të dhënave. Përgjatë procesit janë përdorur procedura dhe programe standarde të zhvilluara nën programin global të MICS-it dhe janë adaptuar për pyetësorët për Kosovë. Procesimi i të dhënave filloi në të njëjtën kohë me mbledhjen e të dhënave në Nëntor 2013 dhe është përfunduar në Prill 2014. Të dhënat janë analizuar duke përdorur Pakon Statistikore të Shkencave Sociale (SPSS), versioni 20. Modeli i sintaksës dhe planet e tabelimit të zhvilluara nga UNICEF-i janë përshtatur dhe përdorur për këtë qëllim.

SI TË LEXOHEM TABELAT

Duhet të theksohet se në rastet kur në tabela është përdorur arsimimi si karakteristikë, nivelet e arsimit fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë janë definuar në përputhje me klasifikimet sipas sistemit të arsimit në Kosovë (pesë vite të shkollës fillore, katër vite të shkollës së mesme të ulët dhe katër vite të shkollës së mesme të lartë).

Grupmoshat e prezantuara në këtë raport përfshinë po ashtu personat që kanë arritur moshën/vitin e plotë të përfshirë në limitin e sipërm për një grupmoshë të caktuar, për shembull, respondentët e moshës 15-49 vjeçare përfshinë personat që i kanë mbushur 49 vjet, ndërsa grupmosha e fëmijëve të moshës 20-23 muajsh përfshinë ata që kanë mbushur 23 muaj të plotë.

Përveç të dhënave për shqiptarët dhe serbët, të dhënat për grupin etnik të kryefamiljarit të ekonomisë familjare janë në shumicën e rasteve të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara. Prandaj vetëm të dhënat për këto grupe etnike janë prezantuar në këtë raport.

Tabelat po ashtu përmbajnë shenja të veçanta të cilat përdoren vazhdimisht për të treguar si në vijim:

(*) – një yll në tabelë tregon se përqindja apo proporcioni është i bazuar në më pak se 25 raste të pa peshuara dhe si të tilla janë pak raste për të raportuar.

(numri) – një shifër në kllapa tregon se përqindja apo proporcioni është i bazuar në 25 deri në 49 raste të pa peshuara dhe si të tilla duhet të trajtohen me kujdes.

(M) – shkronja 'M' pas kodit të tabelës/figurës tregon se i referohet popullatës së meshkujve.

(-) – një vizë "-" në tabelë tregon se nuk ka raste të pa peshuara në atë katror apo në numërues. Ky rast është në shumicën e tabelave të fundit p.sh. numri i përgjithshëm i rasteve është zero për kategorinë specifike të variablit të përgjithshëm.



III. MBULIMI I MOSTRËS SI DHE KARAKTERISTIKAT E EKONOMIVE FAMILJARE DHE RESPONDENTËVE

MBULIMI I MOSTRËS

Nga 4,870 ekonomi familjare të përzgjedhura për mostër, 4,406 kanë qenë të banuara. Nga këto, 4,127 janë intervistuar me sukses duke prodhuar një shkallë të përgjigjes së ekonomive familjare prej 94 përqind.

Në ekonomitë familjare të intervistuar, janë identifikuar 5,915 femra (të moshës 15-49 vjeçare). Nga këto, 5,251 janë intervistuar me sukses duke prodhuar një shkallë të përgjigjes prej 89% brenda ekonomive familjare të intervistuar.

Anketa ka marrë për mostër po ashtu meshkujt (të moshës 15-49 vjeçare), por këtu është kërkuar një nën-popullatë. Janë identifikuar të gjithë meshkujt (të moshës 15-49 vjeçare) në çdo të dytën ekonomi familjare. Në pyetësorët e ekonomive familjare janë listuar gjithsej 2,921 meshkuj (të moshës 15-49 vjeçare). Janë kompletuar 2,165 pyetësorë individual me meshkuj të kualifikueshëm që korrespondon me një shkallë të përgjigjes prej 74 përqind brenda ekonomive familjare të kualifikueshme dhe të intervistuar.

Në pyetësorët e ekonomive familjare janë listuar gjithsej 1,786 fëmijë të moshës nën 5 vjeç. Pyetësorët janë kompletuar për 1,648 nga këta fëmijë, që korrespondon me një shkallë të përgjigjes prej 92 përqind brenda ekonomive familjare të intervistuar.

Shkallët e përgjithshme të përgjigjes si 83, 69 dhe 86 përqind janë kalkuluar për intervistat individuale të femrave, meshkujve përkatësisht fëmijëve nën 5 vjeç (Tabela HH.1).

Tabela HH.1: Rezultatet e intervistave të ekonomive familjare, meshkujve, femrave dhe fëmijëve nën 5 vjeç

Numri i ekonomive familjare, femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën 5 vjeç sipas rezultateve të intervistave dhe shkallëve të përgjigjes së ekonomive familjare, femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën 5 vjeç, Kosovë, 2013-2014

	Totali	Vendbanimi	
		Urban	Rural
Ekonomi familjare			
Të mostruara	4870	2124	2746
Të banuara	4406	1936	2470
Të intervistuar	4127	1755	2372
Shkalla e përgjigjes së ekonomive familjare	93.7	90.7	96.0
Femra			
Të kualifikueshme për t'u intervistuar	5915	2327	3588
Të intervistuar	5251	2004	3247
Shkalla e përgjigjes tek femrat	88.8	86.1	90.5
Shkalla e përgjithshme e përgjigjes tek femrat	83.2	78.1	86.9
Meshkuj			
Të kualifikueshëm për t'u intervistuar	2921	1059	1862
Të intervistuar	2165	740	1425
Shkalla e përgjigjes tek meshkujt	74.1	69.9	76.5
Shkalla e përgjithshme e përgjigjes tek meshkujt	69.4	63.3	73.5
Fëmijë nën 5 vjeç			
Të kualifikueshëm për t'u intervistuar	1786	661	1125
Nënat (apo kujdestarët) e intervistuar	1648	590	1058
Shkalla e përgjigjes tek fëmijët nën 5 vjeç	92.3	89.3	94.0
Shkalla e përgjithshme e përgjigjes tek fëmijët nën 5 vjeç	86.4	80.9	90.3

Shkallët e përgjigjes kanë qenë më të larta në vendbanimet rurale se sa në ato urbane. Në mënyrë që të përmirësohet shkalla e përgjigjes për pyetësorët për meshkuj, stafi i terrenit ka bërë përpjekje të shumta për të caktuar termine për t'i takuar disa nga anëtarët e ekonomive familjare meshkujt të kualifikuar; si do që të jetë, prap ka qenë e pa mundur të kryhen intervistat me disa nga meshkujt respondent të kualifikueshëm. Një përqindje e dukshme e meshkujve të kualifikuar për intervistim, anëtarë të ekonomive familjare kanë qenë jashtë vendit në punësim të përkohshëm, disa në institucione, të tjerët duke punuar në një komunë tjetër, prandaj nuk ishte e mundur të bëheshin/mbaheshin terminet. Shkallët e përgjigjes për femrat në vendbanimet urbane, fëmijët nën 5 vjeç si dhe për meshkujt në tërë Kosovën ishin nën 85 përqind prandaj, rezultatet për këto vendbanime duhet interpretuar me pak kujdes. Si do që të jetë, gjatë fazës së dizajnit të mostrës është marrur në konsideratë një shkallë relativisht e lartë e mos-përgjigjes.


KARAKTERISTIKAT E EKONOMIVE FAMILJARE

Shpërndarja e peshuar e popullatës së anketës sipas moshës dhe gjinisë është paraqitur në Tabelën HH.2. Shpërndarja është shfrytëzuar po ashtu për të prodhuar piramidën e popullsisë në Figurën HH.1. Në 4,127 ekonomi familjare të intervistuar me sukses në anketë, janë listuar 22,416 anëtarë të ekonomive familjare. Nga këta, 11,271 ishin meshkuj dhe 11,145 femra.

Tabela HH.2: Shpërndarja e moshës së popullatës së ekonomive familjare sipas gjinisë						
Shpërndarja e përqindjes dhe frekuencës së popullatës së ekonomive familjare sipas grup-moshave 5 vjeçare, grup-moshave të varësisë, dhe sipas fëmijëve (të moshës 0-17 vjeçare) dhe popullatës së rritur (mosha 18 vjeçare ose më shumë), sipas gjinisë, Kosovë, 2013-2014						
	Totali		Meshkuj		Femra	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Totali	22416	100.0	11271	100.0	11145	100.0
Mosha						
0-4	1780	7.9	939	8.3	841	7.5
5-9	1799	8.0	891	7.9	908	8.1
10-14	2217	9.9	1185	10.5	1032	9.3
15-19	2227	9.9	1166	10.3	1061	9.5
20-24	2113	9.4	1085	9.6	1028	9.2
25-29	1768	7.9	922	8.2	846	7.6
30-34	1472	6.6	733	6.5	739	6.6
35-39	1510	6.7	719	6.4	791	7.1
40-44	1499	6.7	700	6.2	799	7.2
45-49	1278	5.7	641	5.7	637	5.7
50-54	1155	5.2	573	5.1	582	5.2
55-59	988	4.4	509	4.5	479	4.3
60-64	823	3.7	388	3.4	436	3.9
65-69	624	2.8	281	2.5	342	3.1
70-74	479	2.1	225	2.0	254	2.3
75-79	388	1.7	181	1.6	207	1.9
80-84	198	0.9	90	0.8	109	1.0
85+	95	0.4	43	0.4	52	0.5
Mungojnë/ND	1	0.0	0	0.0	1	0.0
Grup-moshat e varura						
0-14	5796	25.9	3015	26.8	2781	24.9
15-64	14834	66.2	7435	66.0	7399	66.4
65+	1785	8.0	820	7.3	965	8.7
Mungojnë/ND	1	0.0	0	0.0	1	0.0
Popullata e fëmijëve dhe e të rriturve						
Fëmijë, mosha 0-17 vjeçare	7137	31.8	3737	33.2	3399	30.5
Të rritur, mosha 18+ vjeçare	15278	68.2	7533	66.8	7745	69.5
Mungojnë/ND	1	0.0	0	0.0	1	0.0

Shpërndarja e përqindjes së popullatës së ekonomive familjare në aspektin e shpërndarjes sipas moshës dhe gjinisë në Tabelën HH.2 përshtatet ngushtë me atë të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011. Derisa rritja pozitive e popullatës mund të vërehet si shumë më e madhe tek fëmijët e moshës 0-14 vjeçare në popullatën totale (26 përqind) në krahasim me pjesën e popullatës 65 vjeçare e më shumë (tetë përqind), është me rëndësi të theksohet një reduktim i vogël i lindjeve, siç vërehet në një ulje të vogël në shpërndarjen e përqindjes për ata të moshës nën 10 vjeç. Rritja pozitive e popullatës ka kontribuar që pothuajse gjysma (45 përqind) e popullatës të jenë të moshës 0-17 vjeçare dhe një e tretat (32 përqind) e popullatës të jenë të moshës 0-17 vjeçare dhe më shumë se gjysma (53 përqind) nën moshën 30 vjeçare. Shkalla e përgjithshme e varësisë, e emërtuar si shkalla e popullatës jo aktive (moshat 0-14 dhe 65+) ndaj popullatës aktive (mosha 15-64), e shprehur në përqindje është 51 përqind, do të thotë se për çdo 100 persona aktiv janë 51 persona jo aktiv. Ka një variacion shumë të vogël në shpërndarjen e përqindjes bazuar në gjininë. Mosha e 1 (një) femre anëtare e ekonomisë familjare nuk është ditur.

Figura HH.1: Shpërndarja e popullatës së ekonomive familjare sipas moshës dhe gjinisë, Kosovë, 2013-2014



Tabelat HH.3, HH.4 dhe HH.5 ofrojnë informata bazike mbi ekonomitë familjare, respondentet femra të moshës 15-49 vjeçare, respondentët meshkuj të moshës 15-49 vjeçare dhe fëmijët nën moshën 5 vjeçare. Janë prezantuar edhe numrat e peshuar edhe të pa peshuar. Këto informata janë esenciale për interpretimin e gjetjeve të prezantuara më vonë në këtë raport dhe ofrojnë informata të përgjithshme të përfaqësueshmërisë së mostrës së anketës. Tabelat tjera në këtë raport janë të prezantuara vetëm me numrat e peshuar¹⁰.

Tabela HH.3 ofron informata bazike mbi ekonomitë familjare, përfshirë gjininë e kryefamiljarit të ekonomisë familjare, vendbanimin, numrin e anëtarëve të ekonomisë familjare, si dhe arsimimin e kryefamiljarit të ekonomisë familjare dhe grupit etnik¹¹ të kryefamiljarit të ekonomisë familjare. Këto karakteristika të përgjithshme janë përdorur në tabelat pasuese në këtë raport; figurat në këto tabela kanë për qëllim të paraqesin po ashtu numrin e vëzhgimeve sipas kategorive kryesore të analizave në raport.

¹⁰ Shih shtojcën A: dizajnin e mostrës, për më shumë detaje rreth peshave të mostrës.

¹¹ Kjo është përcaktuar duke pyetur "Cilit grup etnik i përket kryefamiljari i ekonomisë familjare?"

Tabela HH.3: Përbërja e ekonomisë familjare

Shpërndarja në përqindje dhe frekuencë e ekonomive familjare sipas karakteristikave të përzgjedhura, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e peshuar	Numri i ekonomive familjare	
		I peshuar	I pa peshuar
Totali	100.0	4127	4127
Gjinia e kryefamiljarit të ekonomisë familjare			
Meshkuj	86.3	3562	3560
Femra	13.7	565	567
Vendbanimi			
Urban	41.5	1711	1755
Rural	58.5	2416	2372
Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare			
1	3.6	150	139
2	7.7	319	322
3	9.0	370	364
4	17.3	716	716
5	19.7	814	813
6	16.4	677	682
7	10.7	443	444
8	5.7	234	235
9	3.5	146	151
10+	6.3	258	261
Arsimimi i kryefamiljarit të ekonomisë familjare			
Nuk ka arsimim	4.8	197	203
Fillor	11.4	471	476
I mesëm i ulët	23.4	964	979
I mesëm i lartë	38.6	1594	1558
I lartë	21.8	898	908
Mungon/ND	0.1	3	3
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare			
Shqiptar	86.9	3587	3657
Serb	7.9	324	230
Grupe tjera etnike	5.2	216	240
Madhësia mesatare e ekonomisë familjare	5.4	4127	4127

Numri total i ekonomive familjare të peshuara dhe të pa peshuara është i barabartë, sepse pesha e mostrave është normalizuar. Tabela po ashtu paraqet mesataren e peshuar të madhësisë së ekonomive familjare të vlerësuar sipas anketës.

Në 87 përqind të ekonomive familjare kryefamiljari është mashkull dhe përafërsisht dy të pestat (42 përqind) të ekonomive familjare janë të lokalizuara në vendbanime urbane. Pothuajse një e gjashta (16 përqind) e ekonomive familjare kanë kryefamiljarin e tyre pa arsimim ose vetëm me arsimim fillor. Pothuajse dy të tretat e ekonomive familjare (62 përqind) kanë 5 apo më shumë anëtarë dhe mesatarja e vlerësuar e madhësisë së ekonomisë familjare është 5.4 anëtarë. Shumica (87 përqind) e kryefamiljarëve të ekonomive familjare janë të grupit etnik shqiptar.

KARAKTERISTIKAT E RESPONDENTËVE FEMRA DHE MESHKUJ TË MOSHËS 15-49 VJEÇARE DHE FËMIJËVE NËN MOSHËN 5 VJEÇARE

Tabelat HH.4, HH.4M dhe HH.5 ofrojnë informata të përgjithshme për karakteristikat e respondentëve femra dhe meshkuj të moshës 15-49 dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare. Në të tri tabelat, numri total i vëzhgimeve të peshuara dhe të pa peshuara është i barabartë, duke qenë se peshat e mostrave janë normalizuar (standardizuar). Përveç ofrimit të informatave të rëndësishme mbi karakteristikat e femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare, tabelat po ashtu kanë për qëllim të paraqesin numrin e vëzhgimeve për secilën kategori. Këto kategori janë të përdorura në tabelat pasuese në këtë raport.

Tabela HH.4: Karakteristikat e përgjithshme të femrave

Shpërndarja në përqindje dhe frekuencë e femrave të moshës 15-49 vjeçare sipas karakteristikave të përzgjedhura, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e peshuar	Numri i femrave	
		I peshuar	I pa peshuar
Totali	100.0	5251	5251
Vendbanimi			
Urban	38.6	2029	2004
Rural	61.4	3222	3247
Mosha			
15-19	18.0	945	949
20-24	16.8	884	886
25-29	13.4	701	691
30-34	12.9	679	676
35-39	13.8	726	728
40-44	13.8	724	728
45-49	11.3	591	593
E martuar/Bashkëjetesë			
Aktualisht e martuar/në bashkëjetesë	61.3	3221	3220
E ve	1.3	67	70
E shkukurëzuara	0.9	45	43
E ndarë	0.8	41	41
Asnjëherë e martuar/bashkëjetesë	35.7	1876	1877
Amësia dhe lindjet e fundit			
Nuk ka pasur lindje asnjëherë	41.7	2188	2182
Ka pasur lindje ndonjëherë	58.3	3063	3069
Ka pasur lindje në 2 vitet e fundit	12.1	636	637
Nuk ka pasur lindje në 2 vitet e fundit	46.2	2427	2432
Arsimimi			
Nuk ka arsimim	1.6	86	88
Fillor	3.9	204	203
I mesëm i ulët	38.0	1997	2047
I mesëm i lartë	34.3	1801	1768
I lartë	22.2	1163	1145
Kuintilët e indeksit të pasurisë			
Më të varfërit	18.8	989	1004
Të dytët	20.1	1056	1062
Mesatarët	19.6	1031	1028
Të katërtit	20.8	1090	1096
Më të pasurit	20.7	1086	1061
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare			
Shqiptar	90.9	4772	4829
Serb	5.1	270	191
Grupe tjera etnike	4.0	209	231

Tabela HH.4 ofron karakteristika të përgjithshme për respondentet femra të moshës 15-49 vjeçare. Tabela përfshin informata rreth shpërndarjes së femrave sipas vendbanimit, moshës, statusit martesor/bashkëjetesës, statusit të amësisë, lindjeve në 2 vitet e fundit, arsimit¹², kuintalëve të indeksit të pasurisë^{13,14}, dhe grupit etnik të kryefamiljarit të ekonomisë familjare.

Pothuajse gjysma (48 përqind) e femrave janë të moshës 15-29 vjeçare dhe pothuajse dy të tretat (61 përqind) e femrave të moshës 15-49 vjeçare janë aktualisht të martuara apo në bashkëjetesë derisa 36 përqind nuk kanë qenë asnjëherë të martuara apo në bashkëjetesë. Shpërndarja sipas statusit të amësisë është i ngjashëm me 58 përqind për femrat që kanë pasur lindje ndonjëherë dhe 12 përqind për femrat që kanë pasur lindje në dy vitet e fundit. Më shumë se gjysma (56 përqind) e femrave kanë arsimimin e mesëm të lartë apo të lartë dhe 19 përqind të femrave jetojnë në ekonomitë familjare jetojnë në kuintilin më të varfër të pasurisë.

Tabela HH.4M: Karakteristikat e përgjithshme të meshkujve			
Shpërndarja në përqindje dhe frekuencë e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare sipas karakteristikave të përzgjedhura, Kosovë, 2013-2014			
	Përqindja e peshuar	Numri i meshkujve	
		I peshuar	I pa peshuar
Totali	100.0	2165	2165
Vendbanimi			
Urban	36.2	783	740
Rural	63.8	1382	1425
Mosha			
15-19	21.6	468	463
20-24	17.3	375	377
25-29	14.2	308	310
30-34	12.1	261	269
35-39	11.2	243	241
40-44	11.9	258	256
45-49	11.7	253	249
Gjendja martesore/Bashkëjetesë			
Aktualisht i martuar/në bashkëjetesë	49.3	1067	1061
I ve	0.0	1	1
I shkurorëzuar	0.4	10	10
I ndarë	0.5	10	9
Asnjëherë i martuar/bashkëjetesë	49.7	1077	1083
Mungon	0.0	0	1

¹² Përgjatë këtij raporti, përveç rasteve ku janë dhënë sqarime ndryshe, "arsimi", kur përdoret si variabël e përgjithshme, i referohet nivelit më të lartë të arsimit që respondentit ka vijuar ndonjëherë.

¹³ Indeksi i pasurisë është një përbërje treguesish të pasurisë. Për të krijuar indeksin e pasurisë, është bërë një analizë e përbërësve kryesorë duke përdorur informatat mbi pronësinë e të mirave të përdoruesit, karakteristikat e banimit, ujin dhe kanalizimin, dhe karakteristikat tjera që janë të lidhura me pasurinë e ekonomisë familjare në mënyrë që të gjenerohen peshat (pikët e faktorëve) për secilin nga artikujt e përdorur. Në vend se të ndahen pikët e faktorëve urban dhe rural në një rezultat fillestar për mostrën totale në mënyrë që të përfitohet një mostër e kombinuar përfundimtare, pikët e faktorëve për MICS-in në Kosovë, 2013-2014 janë llogaritur menjëherë për të gjithë mostrën.

Secilës ekonomi familjare në mostrën totale i përshkruhen pastaj pikët e pasurisë bazuar në asetet që ka ekonomia familjare në pronësi dhe në pikët finale të faktorit të fituara siç është përshkruar më lartë. Popullata e ekonomive familjare të anketës pastaj rangohet sipas pikëve të pasurisë së ekonomive familjare në të cilat ata jetojnë, dhe përfundimisht ndahet në 5 pjesë të barabarta (kuintale) nga më e ulëta (më e varfëra) deri tek më e larta (më e pasura).

Në MICS-in për Kosovë, për llogaritje janë përdorur asetet në vijim: Numri i personave për dhomë fjetjeje; materiali kryesor i dyshemesë së banimit; çatia dhe muret e jashtme; lloji i lëndës djegëse të përdorur për gatim; vendi për gatim; nëse ekonomia familjare ka në pronësi një frigorifer, shtrat, tavolinë dhe karrige, internet, tharëse rrobash, thithëse elektrike, kondicioner (klime), xhakuzi, bojler, laptop, kompjuter, lavatriqe, televizor plazma/LCD; nëse ndonjë nga anëtarët ka në pronësi motoçikletë/skuter, veturë, kamion, traktor, telefon celular, telefon të "mençur" me ekran me prekje apo me taste; shtëpi/ banesë në pronësi, llogari bankare, tokë bujqësore dhe bagëti në pronësi të ndonjërit nga anëtarët e ekonomisë familjare; burimi i ujit të pijshëm; vendi i burimit të ujit; kanalizimit të përbashkët; lloji i kanalizimit dhe prania e sapunit.

Indeksi i pasurisë është supozuar se do marr informatat themelore afatgjate nëpërmjet asetëve të ekonomisë familjare, dhe ka për qëllim të prodhojë një rangim të ekonomive familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat deri tek më të pasurat. Indeksi i pasurisë nuk ofron informata për varfërinë absolute, të hyrat aktuale apo nivelet e shpenzimeve. Rezultatet e pasurisë të llogaritura janë të aplikueshme vetëm për të dhëna të caktuara mbi të cilat ato bazohen.

Informata shtesë mbi llogaritjen e indeksit të pasurisë mund të gjenden në: Filmer, D. and Pritchett, L., 2001. "Estimating wealth effects without expenditure data – or tears: An application to educational enrolments in states of India". Demography 38(1): 115-132. Rutstein, S.O. and Johnson, K., 2004. The DHS Wealth Index. DHS Comparative Reports No. 6. Calverton, Maryland: ORC Macro and Rutstein, S.O., 2008. The DHS wealth Index: Approaches for Rural and Urban Areas. DHS working Papers No. 60. Calverton, Maryland: Macro International Inc.

¹⁴ Gjatë përshkrimit të rezultateve të anketës sipas kuintalëve të pasurisë, përdoret terminologji e duhur kur u referohet anëtarëve të ekonomive familjare, si p.sh. "femrat në popullatën më të pasur të ekonomive familjare", që këmbetet me termin "femrat që jetojnë në popullatën më të pasur", dhe kështu me radhë.

Tabela HH.4M: Karakteristikat e përgjithshme të meshkujve (vazhdim)			
Statusi i atësisë			
Ka së paku një fëmijë të gjallë	45.2	978	977
Nuk ka fëmijë të gjallë	54.8	1186	1186
Mungon/ND	0.1	1	2
Arsimimi	54.8	1186	1186
Nuk ka arsimim	0.1	3	4
Fillor	0.7	15	17
I mesëm i ulët	15.3	332	343
I mesëm i lartë	57.6	1247	1236
I lartë	26.2	567	565
Kuintilët e indeksit të pasurisë	57.6	1247	1236
Më të varfërit	20.1	436	452
Të dytët	21.0	454	461
Mesatarët	20.0	432	425
Të katërtit	18.7	405	408
Më të pasurit	20.2	438	419
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare			
Shqiptar	90.7	1963	1980
Serb	5.2	112	80
Grupe tjera etnike	4.1	90	105

Ngjashëm, Tabela HH.4M ofron karakteristikat e përgjithshme të respondentëve meshkuj të moshës 15-49 vjeçare. Pyetësi për meshkujt e moshës 15-49 vjeçare është administruar në nën grupin e ekonomive familjare të përzgjedhura. Tabela paraqet informata mbi shpërndarjen e meshkujve sipas vendbanimit, moshës, statusit martesore, statusit të atësisë, arsimit, kuintalëve të indeksit të pasurisë, indeksit të pasurisë dhe grupit etnik të kryefamiljarit të ekonomisë familjare.

Më shumë se gjysma (53 përqind) e meshkujve janë të moshës 15-29 vjeçare dhe gjysma (49 përqind) e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare janë aktualisht të martuar apo në bashkëjetesë, përderisa gjysma tjetër (50 përqind) nuk kanë qenë asnjëherë të martuar apo në bashkëjetesë. Shpërndarja sipas statustit të atësisë tregon se 45 përqind të meshkujve kanë së paku një fëmijë të gjallë. Pesë të gjashtat (84 përqind) e meshkujve kanë arsimim të mesëm të lartë apo të lartë dhe më pak se një përqind nuk kanë arsimim apo kanë vetëm arsimin fillor.

Karakteristika e përgjithshme të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare janë të prezantuara në Tabelën HH.5. Këtu përfshihet shpërndarja e fëmijëve sipas disa veçorive: gjinisë, vendbanimit, moshës në muaj, respondentit (nëna apo kujdestari), arsimimit, pasurisë dhe grupit etnik.

Proporcioni i fëmijëve meshkuj dhe femra brenda popullatës së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare është 53 përkatësisht 47 përqind, me proporcion më të madh që jetojnë në vendbanime rurale me 64 përqind. Më shumë se dy të tretat (tetë përqind) të fëmijëve nën moshën pesë vjeçare kanë nënën pa arsimim apo vetëm me arsimim fillor. Më pak se një pikë përqindje të fëmijëve nën moshën pesë vjeçare jetojnë me nënën e tyre. Sa i përket kuintalëve të indeksit të pasurisë, 24 përqind e fëmijëve nën pesë vjeç jetojnë në ekonomitë familjare që bëjnë pjesë në kuintalin më të varfër të popullatës ndërsa 18 përqind e fëmijëve nën pesë vjeç jetojnë në ekonomitë familjare në kuintalin më të pasur të popullsisë.

Tabela HH.5: Karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve nën 5 vjeç

Shpërndarja në përqindje dhe frekuencë e fëmijëve nën 5 vjeç sipas karakteristikave të përzgjedhura, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e peshuar	Numri i fëmijëve nën 5 vjeçare	
		I peshuar	I pa peshuar
Totali	100.0	1648	1648
Gjinia			
Meshkuj	53.2	876	874
Femra	46.8	772	774
Vendbanimi			
Urban	36.4	599	590
Rural	63.6	1049	1058
Mosha			
0-5 muaj	8.6	142	145
6-11 muaj	11.0	181	185
12-23 muaj	18.9	311	305
24-35 muaj	20.6	339	341
36-47 muaj	19.7	324	321
48-59 muaj	21.3	350	351
Respondenti i pyetësorit për fëmijët nën 5			
Nëna	99.4	1638	1638
Kujdestarë tjetër	0.6	10	10
Arsimimi i nënës^a			
Nuk ka arsimim	1.7	27	29
Fillor	6.0	99	101
I mesëm i ulët	45.0	741	755
I mesëm i lartë	31.2	514	505
I lartë	16.1	265	257
Mungon/ND	0.1	1	1
Kuintilët e indeksit të pasurisë			
Më të varfërit	23.8	392	399
Të dytët	19.6	322	321
Mesatarët	19.4	320	320
Të katërtit	19.3	318	315
Më të pasurit	18.0	296	293
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare			
Shqiptar	91.9	1515	1516
Serb	2.7	44	31
Grupe tjera etnike	5.4	89	101

^a Në këtë tabelë dhe përgjatë këtij raporti, arsimimi i nënës i referohet nivelit më të lartë të vijuar të arsimimit të nënës dhe kujdestarit të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare, të cilët janë respondentë në pyetësorët e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare, nëse nëna ka vdekur apo jeton diku tjetër.

KARAKTERISTIKAT E BANIMIT, PRONËSIA E ASETEVE, DHE KUINTILËT E PASURISË

Tabelat HH.6, HH.7 dhe HH.8 ofrojnë detaje të tjera mbi karakteristikat e ekonomive familjare. Tabela HH.6 prezanton karakteristikat e banimit të zbrërthyer sipas vendbanimit, materialeve kryesore të dyshemesë, çatisë, dhe mureve të jashtme, si dhe numrit të dhomave që shfrytëzohen për fjetje.

Shumica e ekonomive familjare kanë dysheme të përfunduar (97 përqind), çati të përfunduar (98 përqind) dhe mure të jashtme të përfunduara (97 përqind) me shumë pak dallime mes vendbanimeve urbane dhe rurale, që janë të ngjashme me rezultatet e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011. Mesatarja e numrit të personave që flenë në një dhomë gjumi është 2.21 me një mesatare më të lartë në vendbanimet rurale (2.25) krahasuar me vendbanimet urbane (2.15). Ekonomitë familjare në vendbanimet rurale kanë më shumë të ngjarë të kenë 3 apo më shumë dhoma që përdoren për fjetje (54 përqind) sesa ato në vendbanimet urbane (41 përqind).

Tabela HH.6: Karakteristikat e banimit			
Përqindja e shpërndarjes së ekonomive familjare sipas karakteristikave të zgjedhura të banimit, sipas vendbanimit, Kosovë, 2013-2014			
	Vendbanimi		
	Totali	Urban	Rural
Dyshemeja			
Natyrle	0.1	0.0	0.2
Rudimentare	2.8	2.0	3.3
E përfunduar	96.7	97.9	96.0
Tjetër	0.1	0.0	0.2
Mungon/ND	0.2	0.1	0.2
Çatia			
Natyrle	0.0	0.0	0.0
Rudimentare	0.8	0.0	3.3
E përfunduar	98.2	99.7	93.4
Tjetër	0.2	0.0	1.1
Mungon/ND	0.8	0.3	2.3
Muret e jashtme			
Natyrle	0.1	0.0	0.2
Rudimentare	2.0	0.2	3.0
Të përfunduara	97.4	99.5	96.2
Tjetër	0.2	0.0	0.4
Mungon/ND	0.3	0.3	0.2
Dhoma të shfrytëzuara për fjetje			
1	14.7	16.7	13.4
2	36.5	41.8	32.7
3 apo më shumë	48.6	41.4	53.7
Mungon/ND	0.2	0.1	0.2
Totali	100.0	100.0	100.0
Numri i ekonomive familjare	4127	1711	2416
Mesatarja e personave për dhomë që përdoret për fjetje	2.21	2.15	2.25

Në Tabelën HH.7 ekonomitë familjare janë të shpërndara sipas pronësisë së aseteve nga ekonomitë familjare dhe nga anëtarët e ekonomive familjare individualisht. Pronësia e aseteve të ekonomisë familjare ndryshon shumë për vendbanimet urbane dhe rurale. Një përqindje e madhe e ekonomive familjare ka në pronësi një frigorifer (97 përqind) dhe shtrat (99 përqind), bojler (93 përqind), thithëse elektrike dhe lavatriqe (përkatesisht 94 përqind).

Më pak se tri të katërtat (72 përqind) të ekonomive familjare kanë qasje në internet, 62 përqind kanë në pronësi një kompjuter dhe 34 përqind kanë në pronësi një laptop. Një përqindje më e madhe e ekonomive familjare në vendbanimet rurale kanë në pronësi tokë bujqësore (78 përqind) dhe bagëti (55 përqind) se sa ekonomitë familjare nga vendbanimet urbane (38 përqind përkatësisht shtatë përqind). Telefonat celular janë artikulli më i shpeshtë që është në pronësi nga së paku një anëtar i ekonomisë familjare me 98 përqind, përderisa më shumë se gjysma (53 përqind) të ekonomive familjare ka së paku një anëtar të ekonomisë familjare që ka në pronësi telefon të mençur me prekje apo me taste. Një e gjashta (16 përqind) të ekonomive familjare nuk kanë llogari bankare dhe 16 përqind e ekonomive familjare nuk e kanë në pronësi banesën/shtëpinë në të cilën është duke jetuar.

Tabela HH.7: Asetet personale dhe të ekonomisë familjare

Përqindja e ekonomive familjare sipas pronësisë së aseteve të përzgjedhura të ekonomive familjare dhe personale dhe shpërndarja në përqindje sipas pronësisë së banesës/shtëpisë, sipas vendbanimit, Kosovë, 2013-2014

	Totali	Vendbanimi	
		Urban	Rural
Përqindja e ekonomive familjare që ka në pronësi			
Frigorifer	96.9	98.4	95.9
Shtrat	99.1	99.3	99.0
Tavolinë dhe karrige	84.4	88.1	81.8
Internet	72.2	80.1	66.5
Tharëse rrobash	7.3	10.6	5.0
Fshesë elektrike	94.4	97.2	92.4
Kondicioner ajri	7.3	12.9	3.3
Xhakuzi	1.6	2.2	1.2
Bojler	93.4	97.1	90.7
Laptop	33.5	43.3	26.5
Kompjuter desktop	62.4	67.4	58.9
Enë larëse	25.4	39.0	15.7
Lavatriqe	93.9	96.6	92.0
TV Plazma/LCD	41.1	51.1	34.0
Përqindja e ekonomive familjare që ka në pronësi			
Tokë bujqësore	61.5	37.9	78.2
Kafshë ferme/bagëti	35.2	7.0	55.2
Përqindja e ekonomive familjare ku së paku një anëtarë ka në pronësi			
Motoçikletë apo skuter	4.8	4.6	5.0
Karrocë e tërhequr nga kafshët	1.4	0.3	2.2
Veturë	66.9	64.6	68.5
Kamion	5.3	3.7	6.4
Traktor	20.3	4.2	31.7
Telefon celular	97.7	98.3	97.3
Telefon të mençur me prekje apo taste	52.7	60.3	47.4
Llogari bankare	83.8	88.0	80.8
Pronësia e banimit			
Në pronësi të anëtarit të ekonomisë familjare	92.2	88.4	94.9
Nuk është në pronësi	7.8	11.6	5.1
Me qira	2.7	5.8	0.4
Strehim i përkohshëm	1.7	2.0	1.4
Tjetër	3.4	3.7	3.2
Totali	100.0	100.0	100.0
Numri i ekonomive familjare	4127	1711	2416

Tabela HH.8 tregon shpërndarjen e popullatës së ekonomive familjare sipas kuintilëve të indeksit të pasurisë dhe indeksit të grupuar sipas vendbanimit, gjinisë dhe arsimimit të kryefamiljarit të ekonomisë familjare. Derisa ka pak dallim në indeksin e pasurisë sipas gjinisë së kryefamiljarit të ekonomisë familjare, ka shumë më shumë dallime mes vendbanimeve urbane dhe rurale. Proporcioni i popullatës së ekonomive familjare që jeton në kuintalin më të varfër të pasurisë është më i madh në vendbanimet rurale (27 përqind) sesa në vendbanimet urbane (nëntë përqind). Koncentrimi i popullatës së ekonomive familjare që jetojnë në kuintalin më të varfër të pasurisë është në ekonomitë familjare ku kryefamiljari nuk ka arsimim apo është vetëm me arsimim fillor. Në kuintalin më të varfër të pasurisë, përqindja e popullatës së ekonomive familjare kryefamiljari i të cilëve ishte me arsimim të mesëm të ulët është më i madh (32 përqind) se sa me arsim fillor (24 përqind). Dyzet përqind e popullatës së ekonomive familjare ku kryefamiljari i ekonomisë familjare kishte arsimim të lartë janë në kuintalin më të pasur të pasurisë. Është e rëndësishme të theksohet se informatat e prezantuara këtu sa i përket indeksit të pasurisë nuk janë ekuivalent të shpenzimeve.

Tabela HH.8: Kuintilët e pasurisë

Shpërndarja në përqindje e popullatës së ekonomive familjare sipas kuintalëve të indeksit të pasurisë dhe kuintalëve të grupuar të pasurisë sipas vendbanimit, gjinisë dhe arsimimit të kryefamiljarit të ekonomisë familjare, Kosovë, 2013-2014

	Kuintilët e indeksit të pasurisë					Totali	Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare
	Më të varfërit	Të dytët	Mesatar	Të katërtit	Më të pasurit		
Totali	20.0	20.0	20.0	20.0	20.0	100.0	22416
Gjinia e kryefamiljarit të ekonomisë familjare							
Mashkull	20.2	19.8	19.9	19.7	20.4	100.0	19796
Femër	18.4	21.9	20.7	22.4	16.7	100.0	2620
Vendbanimi							
Urban	8.5	12.3	14.7	24.0	40.5	100.0	8390
Rural	26.8	24.6	23.2	17.6	7.8	100.0	14026
Arsimimi i kryefamiljarit të ekonomisë familjare							
Nuk ka arsimim	32.2	24.8	19.1	13.8	10.1	100.0	1255
Fillor	23.6	23.3	20.0	19.9	13.1	100.0	2876
I mesëm i ulët	32.3	24.5	18.7	15.1	9.3	100.0	5470
I mesëm i lartë	17.0	20.1	22.1	21.0	19.8	100.0	8307
I lartë	5.0	10.9	17.6	26.1	40.4	100.0	4480
Mungon/ND	(0.0)	(0.0)	(63.0)	(0.0)	(37.0)	100.0	28
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare							
Shqiptar	19.5	20.2	20.4	20.1	19.8	100.0	20261
Serb	21.0	14.9	17.2	18.8	28.0	100.0	1126
Grupe tjera etnike	28.4	21.5	14.2	19.8	16.1	100.0	1029



IV. VDEKSHMËRIA E FËMIJËVE

Një nga objektivat madhore të Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM) është për të reduktuar vdekshmërinë e foshnjeve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare. Në mënyrë specifike, OZHM bën thirrje për reduktim të vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare për dy të tretat në mes viteve 1990 – 2015. Monitorimi i progresit kundrejt këtij qëllimi është një objektivë e rëndësishme por e vështirë.

Shkallët e vdekshmërisë të prezantuara në këtë kapitull janë kalkuluar nga informatat e mbledhura në historitë e lindjes së Pyetësorëve të Femrave. Të gjitha femrat e intervistuar janë pyetur nëse ato kanë pasur ndonjëherë lindje dhe nëse po, është kërkuar nga ato të raportojnë numrin e djemve dhe vajzave që jetojnë me to, numrin e atyre që jetojnë diku tjetër dhe numrin e atyre që kanë vdekur. Për më tepër, nga ato është kërkuar të ofrojnë histori të detajuar të lindjeve të gjalla të fëmijëve në mënyrë kronologjike (sipas radhës) duke filluar me lindjen e parë. Femrat janë pyetur nëse lindjet ishin të vetme apo të shumëfishta (psh. binjake etj.), gjinia e fëmijëve, data e lindjes (muaji dhe viti) dhe statusi i mbijetesës. Më tutje, për fëmijët ende të gjallë, ato janë pyetur për moshën aktuale të fëmijës, dhe për fëmijët e vdekur, mosha kur kanë vdekur. Shkalla e vdekshmërisë në fëmijëri është e shprehur sipas kategorive konvencionale dhe është e definuar si vijon:

- Vdekshmëria neonatale (NN): probabiliteti i vdekjes gjatë muajit të parë të jetës
- Vdekshmëria post-neonatale (PNN): dallimi në mes shkallëve të vdekshmërisë së foshnjeve dhe vdekshmërisë neonatale
- Vdekshmëria e foshnjeve (${}_1q_0$): probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe ditëlindjes së parë
- Vdekshmëria e fëmijëve (${}_4q_1$): Probabiliteti i vdekjes ndërmjet ditëlindjes së parë dhe të pestë
- Vdekshmëria nën moshën 5 vjeçare (${}_5q_0$): probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe ditëlindjes së pestë

Shkallët janë të shprehura si vdekje për 1,000 lindje të gjalla, përveç në rastet e vdekshmërisë së fëmijëve, që është e shprehur si vdekje për 1,000 fëmijë që kanë mbijetuar deri në moshën një vjeçare, dhe vdekshmëria post neonatale, që është dallimi mes shkallëve të vdekshmërisë së foshnjeve dhe vdekshmërisë neonatale.


Tabela CM.1: Shkalla e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme

Shkallët e vdekshmërisë neonatale, post neonatale, e foshnjeve, e fëmijëve, dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare për periudha 5 vjeçare para anketës, Kosovë, 2013-2014

	Shkalla e vdekshmërisë neonatale ¹	Shkalla e vdekshmërisë post neonatale ^{2,a}	Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve ³	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve ⁴	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare ⁵
Vite para anketës					
0-4	9	3	12	3	15
5-9	18	5	24	1	25
10-14	28	14	42	5	47
¹ Treguesi MICS 1.1 - Shkalla e vdekshmërisë neonatale ² Treguesi MICS 1.3 - Shkalla e vdekshmërisë post-neonatale ³ Treguesi MICS 1.2; Treguesi OZHM 4.2 - Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve ⁴ Treguesi MICS 1.4 - Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve ⁵ Treguesi MICS 1.5; Treguesi OZHM 4.1 - Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeçare ^a Shkallët e vdekshmërisë post-neonatale llogariten si dallimi ndërmjet shkallëve të vdekshmërisë neonatale dhe të foshnjeve.					

Tabela CM.1 prezanton shkallët e vdekshmërisë neonatale, post neonatale, të foshnjeve, të fëmijëve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare për tri periudhat e fundit pesë vjeçare para anketës. Figura CM.1 paraqet këto shkallë të vdekshmërisë me interval të besueshmërisë 95 përqind. Shkalla e vdekshmërisë neonatale për periudhën më të fundit 5 vjeçare (korrespondon përafërsisht për periudhat 2008-2014) është vlerësuar të jetë 9 në 1,000 lindje të gjalla, derisa shkalla e vdekshmërisë post neonatale është vlerësuar të jetë 3 në 1,000 lindje të gjalla.

Figura CM.1: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme, Kosovë, 2013-2014



Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve në pesë vite para anketës është 12 për 1,000 lindje të gjalla dhe vdekshmëria e fëmijëve nën moshën pesë vjeçare është 15 vdekje për 1,000 lindje të gjalla për të njëjtën periudhë, që tregon se 80 përqind e vdekjeve nën moshën pesë vjeçare janë vdekje të foshnjeve.

Tabela dhe figura po ashtu tregojnë një trend në rënie në nivelin e Kosovës gjatë 15 viteve të fundit, me vdekshmëri nën moshën 5 vjeçare që është 47 në 1,000, për periudhën 10-14 vjet para anketës, dhe 15 për 1,000 lindje të gjalla në periudhën e fundit 5 vjeçare. Trend i njëjtë është vëzhguar në të gjithë treguesit e tjerë.

Tabela CM.2: Shkalla e vdekshmërisë në fëmijëri të hershme sipas karakteristikave të përgjithshme

Shkallët e vdekshmërisë neonatale, post-neonatale, të foshnjeve, fëmijëve dhe fëmijëve nën 5 vjeç për periudhën pesë vjeçare para anketës, sipas karakteristikave të përgjithshme, Kosovë, 2013-2014

	Shkalla e vdekshmërisë neonatale ¹	Shkalla e vdekshmërisë post neonatale ^{2,a}	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve ³	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve ⁴	Shkalla e vdekshmërisë nën moshën 5 vjeçare ⁵
Totali	9	3	12	3	15
Vendbanimi					
Urban	7	3	9	1	11
Rural	11	3	13	4	18
Gjinia e fëmijës					
Mashkull	11	3	13	4	17
Femër	8	3	10	2	12

¹Treguesi MICS 1.1 –Shkalla e vdekshmërisë neonatale
²Treguesi MICS 1.3 –Shkalla e vdekshmërisë post neonatale
³Treguesi MICS 1.2; Treguesi i OZHM 4.2 –Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve
⁴Treguesi MICS 1.4 –Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve
⁵Treguesi MICS 1.5; Treguesi i OZHM 4.1 –Shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeçare
^a Shkallët e vdekshmërisë post neonatale llogariten si dallimi ndërmjet shkallës së vdekshmërisë së foshnjeve dhe vdekshmërisë neonatale

Tabela CM.2 ofron vlerësime për vdekshmërinë e fëmijëve sipas karakteristikave. Ka disa dallime ndërmjet probabiliteteve të vdekjes mes meshkujve dhe femrave, ku meshkujt kanë probabilitet më të lartë të shkallëve të vdekshmërisë neonatale, të foshnjeve dhe nën moshën 5 vjeçare. Figura CM.2 ofron prezantimin grafik të këtyre dallimeve të shkallëve të vdekshmërisë nën 5 vjeçare sipas vendbanimit dhe tregon dallimin ndërmjet probabiliteteve të vdekjes para moshës pesë vjeçare në vendbanimet urbane dhe rurale.



Figura CM.2: Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç sipas vendbanimit, Kosovë, 2013-2014

Figura CM.3 krahason gjetjet e shkallëve të vdekshmërisë nën 5 vjeç sipas MICS-it në Kosovë me ato të të dhënave administrative nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Gjetjet e MICS-it për Kosovë janë marrur nga Tabela CM.1. Vlerësimet e MICS-it tregojnë një rënie të vazhdueshme të vdekshmërisë gjatë 15 vjetëve të fundit. Vlerësimi më i fundit i vdekshmërisë së foshnjëve (12 për një mijë lindje të gjalla) nga MICS-i është i ngjashëm me vlerësimin nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të të dhënave administrative për të njëjtin vit (2011.6) dhe është 182 përqind më i lartë se sa vlerësimet nga Regjistrimi i Popullsisë së vitit 2011 për të njëjtin vit (2008). Kualifikime të mëtutjeshme të këtyre rënieve të dukshme, dallimeve si dhe përcaktuesve të tyre duhet të analizohen më detajisht dhe me analiza të veçanta.

Figura CM.3: Trendet e shkallëve të vdekshmërisë së foshnjëve, Kosovë, 2013-2014

Vërejtje: Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk ka të dhëna për vdekshmërinë për vitet 1998-2001



V. USHQYESHMËRIA

LINDJET NËN PESHË

Pesha në lindje është një tregues i mirë jo vetëm për shëndetin dhe gjendjen e të ushqyerit të nënës, por gjithashtu edhe të mundësive të të porsalindurit për të mbijetuar, për tu rritur, për shëndet afatgjatë dhe zhvillim psikologjik. Lindja me peshë të ulët (e definuar si më pak se 2,500 gram) mbart një sërë rreziqesh të mëdha për shëndetin e fëmijëve. Fëmijët e kequshqyer në bark mbartin rrezikun të vdesin qysh në ditët, muajt ose vitet e para të jetës së tyre. Por edhe ata që mbijetojnë mund të kenë funksion imunitar/mbrojtës të kufizuar dhe si rrjedhojë mbartin rrezikun për t'u prekur nga sëmundjet; ata kanë më shumë gjasa të mbesin të nënushqyer, me forcë të kufizuar të muskujve gjatë jetës së tyre, dhe kanë probabilitet më të lartë për të vuajtur diabetin dhe sëmundje të zemrës më vonë në jetën e tyre. Fëmijët e lindur nën peshë gjithashtu rrezikojnë të kenë nivel më të ulët të inteligjencës (IQ) dhe çrregullime të aftësive njohëse, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e tyre në shkollë dhe mundësitë për punësim si të rritur.

Në botën në zhvillim, lindja e foshnjës me peshë të ulët është si pasojë e shëndetit dhe të ushqyerit e dobët të nënës. Janë tre faktorët me ndikimin më të madh: gjendja e keqe e të ushqyerit të nënës para shtatzënisë, shtat (gjatësi) të shkurtër (si rezultat i të kequshqyerit ose infeksioneve gjatë fëmijërisë së saj) dhe keq ushqyeshmërisë gjatë shtatzënisë. Shtimi jo adekuat i peshës gjatë shtatzënisë është me rëndësi të veçantë për faktin se çon në gjasa më të mëdha për ngecje të rritjes së fetusit. Për më tepër, sëmundjet të tilla si diarrea dhe malaria, të cilat janë shumë të përhapura në vendet në zhvillim, mund të pengojnë në masë të konsiderueshme rritjen e fetusit nëse nëna infektohet gjatë shtatzënisë.

Në botën e industrializuar, tymosja e duhanit gjatë shtatzënisë është shkaku kryesor i lindjeve me peshë të ulët në lindje. Si në vendet në zhvillim ashtu edhe në ato të zhvilluara, femrat adoleshente që lindin kur trupi i tyre nuk ka përfunduar ende së rrituri, kanë rrezik më të lartë të lindin foshnja nën peshë.

Një nga sfidat kryesore në matjen e incidencës së lindjeve nën peshë, është se në vendet në zhvillim më shumë se gjysma e foshnjave nuk peshohen në lindje. Në të kaluarën shumica e vlerësimeve për lindjet nën peshë në vendet në zhvillim janë bazuar në të dhënat e mbledhura nga institucionet shëndetësore. Megjithatë, këto vlerësime janë të njëanshme për faktin se shumica e lindjeve në vendet në zhvillim nuk kryhen në institucionet shëndetësore, e njëkohësisht edhe ato që kryhen në këto institucione përfaqësojnë vetëm një mostër të përzgjedhur të të gjitha lindjeve. Fatmirësisht në rastin e Kosovës, pjesa më e madhe e lindjeve janë kryer në institucionet shëndetësore.

Për shkak se shumë foshnje nuk peshohen në lindje por edhe ato që peshohen përbëjnë një mostër të njëanshme të të gjitha lindjeve, peshat e raportuara në lindje zakonisht nuk mund të përdoren për të vlerësuar prevalencën e nën peshës në lindje për të gjithë fëmijët. Prandaj, përqindja e lindjeve nën 2500 gram është vlerësuar nga dy pyetje në pyetësorë: vlerësimi i nënës mbi madhësinë e fëmijës në lindje (p.sh. shumë i vogël, më i vogël se mesatarja, mesatar, më i madh se mesatarja, shumë i madh) si dhe pesha e fëmijës në lindje sipas kujtesës së nënës ose pesha e shënuar në kartelën shëndetësore nëse fëmija është peshuar në lindje¹⁵. Përsëri, për fat të mirë kjo nuk do të ndikojë në të njëjtën masë këtë studim për faktin se shumica e lindjeve janë bërë në institucione shëndetësore dhe janë peshuar në lindje.

¹⁵ Për një përshkrim të detajuar të metodologjisë, shih Boerma, J. T., Weinstein, K. I., Rutstein, S.O., and Sommerfelt, A. E., 1996. *Data on Birth Weight in Developing Countries: Can Surveys Help?* Bulletin of the World Health Organization, 74(2), 209-16

Tabela NU.1: Foshnjat e lindura nën peshë

Përqindja e fëmijëve të fundit të lindur të gjallë në dy vitet e fundit që janë vlerësuar të kenë peshuar nën 2,500 gram në lindje dhe përqindja e lindjeve të peshuara në lindje, Kosovë 2013-2014

	Shpërndarja në përqindje e lindjeve sipas vlerësimit të nënës për madhësi në lindje					Totali	Përqindja e lindjeve të gjalla:		Numri i fëmijëve të fundit të lindur të gjallë në dy vitet e fundit
	Shumë i vogël	Më i vogël se mesatar	Mesatar	Më i madh se mesatar	ND		Nën 2,500 gram ¹	Peshuar në lindje ²	
Totali	8.1	7.0	66.5	17.5	0.9	100.0	5.4	99.0	636
Mosha e nënës në lindje									
Më pak se 20 vjeçare	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	100.0	(*)	(*)	24
20-34 vjeçare	8.3	7.4	66.2	17.6	0.5	100.0	5.5	99.5	532
35-49 vjeçare	8.2	5.0	64.5	19.6	2.7	100.0	5.2	97.3	80
Renditja e lindjeve									
1	9.9	8.9	68.8	12.5	0.0	100.0	6.2	99.6	208
2-3	8.0	5.5	65.1	20.1	1.3	100.0	5.2	98.8	337
4+	4.7	8.7	66.1	19.2	1.3	100.0	4.5	98.2	92
Vendbanimi									
Urban	8.3	6.0	67.8	17.3	0.6	100.0	5.4	98.9	242
Rural	8.0	7.7	65.6	17.6	1.1	100.0	5.4	99.0	394
Arsimi i nënës									
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	100.0	(*)	(*)	10
Fillor	(11.3)	(0.0)	(62.5)	(26.2)	(0.0)	100.0	(5.6)	(100.0)	34
I mesëm i ulët	7.0	9.2	64.8	17.9	1.1	100.0	5.2	98.3	279
I mesëm i lartë	7.0	4.9	70.0	16.8	1.3	100.0	4.9	99.3	197
I lartë	10.8	8.0	65.3	15.9	0.0	100.0	6.3	100.0	116
Kuintilët e indeksit të pasurisë									
Më të varfërit	5.8	7.4	63.3	21.1	2.4	100.0	4.6	97.6	140
Të dytët	9.6	10.9	60.5	18.2	0.8	100.0	6.0	98.5	128
Mesatarët	6.9	4.1	75.2	13.8	0.0	100.0	5.0	100.0	129
Të katërtit	12.5	7.3	64.1	14.9	1.1	100.0	6.7	98.9	124
Më të pasurit	6.0	5.3	69.6	19.1	0.0	100.0	4.6	100.0	116
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare									
Shqiptar	7.6	7.3	67.5	16.8	0.8	100.0	5.3	98.9	579
Serb	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	100.0	(*)	(*)	19
Grupe tjera etnike	(17.8)	(6.0)	(45.8)	(30.4)	(0.0)	100.0	(7.7)	(98.6)	38
¹ Treguesi MICS 2.20 – Foshnjat e lindura nën peshë ² Treguesi MICS 2.21 – Foshnjat e peshuara në lindje () Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara (*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara									

Në përgjithësi, 99 përqind të lindjeve janë peshuar në lindje dhe përafërsisht pesë përqind e foshnjeve janë vlerësuar me peshë më të ulët se 2,500 gram në lindje (Tabela NU.1). Prevalenca e peshës së lindjeve nën peshë nuk ndryshon shumë sipas karakteristikave të përgjithshme.

GJENDJA E TË USHQYERIT

Gjendja e të ushqyerit të fëmijëve është pasqyrim i shëndetit të tyre në përgjithësi. Kur fëmijët kanë qasje në burime të ushqimit adekuat, janë më pak të ekspozuar ndaj sëmundjeve të përsëritura dhe kanë kujdes të mirë, ata arrijnë nivelin e tyre të mundshëm të rritjes dhe konsiderohen si të ushqyer mirë. Kequshqyerja është e lidhur me më shumë se gjysmën e të gjitha vdekjeve të fëmijëve në botë. Fëmijët e ushqyer keq kanë më shumë gjasa të vdesin nga sëmundje të zakonshme të fëmijërisë, madje edhe ata që arrijnë të mbijetojnë mund të vuajnë nga sëmundje të përsëritura dhe kanë rritje të kufizuar. Tri të katërtat e fëmijëve që vdesin prej shkaqeve që lidhen me kequshqyerjen kanë qenë vetëm lehtë ose mesatarisht të kequshqyer – duke mos treguar asnjë shenjë të jashtme/dukshme të dobësisë së tyre. Objektiva Zhvillimore e Mijëvjeçarit është të reduktojë në gjysmë numrin e njerëzve që vuajnë nga uria nga viti 1990 deri në 2015. Reduktimi i prevalencës së kequshqyerjes do të ndihmojë po ashtu në objektivin e zvogëlimit të vdekshmërisë së fëmijëve.

Në popullsinë e ushqyer mirë ka një shpërndarje që i referohet gjatësisë dhe peshës së fëmijëve nën 5 vjeç. Kequshqyerja e një popullsie mund të matet duke i krahasuar fëmijët e saj me ata të një popullsie që merret si referencë. Popullata e përdorur në këtë raport që merret si referencë është e bazuar në standardet¹⁶ e rritjes së OBSH-së. Secili nga tre treguesit e gjendjes së të ushqyerit pesha për moshën, gjatësia për moshën dhe pesha për gjatësinë, mund të shprehet në njësi standarde të devijimit (vlerat - z) nga mesatarja e popullsisë së referimit.

Pesha-për-moshën është një njësi matëse e të kequshqyerit akut dhe atij kronik. Fëmijët, pesha për moshën e të cilëve është më shumë se dy devijime standarde nën mesataren e popullatës referuese konsiderohen *mesatarisht apo rëndë/theksueshëm* nënpeshë përderisa ata për të cilët pesha për moshën është më shumë se tri devijime standarde nën mesatare klasifikohen si me theksueshëm nënpeshë.

Gjatësia-për-moshë është njësia matëse e rritjes lineare. Fëmijët gjatësia për moshën e të cilëve është më shumë se dy devijime standarde nën mesataren e popullatës referuese konsiderohen si të shkurtër për moshën e tyre dhe klasifikohen si mesatarisht apo me ngecje të rëndë në rritje. Te ata fëmijë ku gjatësia për moshën është më shumë se tri devijime standarde nën mesatare klasifikohen me ngecje të rëndë në rritje. Ngecja në rritje është pasqyrim i të kequshqyerit kronik si pasojë e pamundësisë për të marrë ushqim adekuat për një kohë të gjatë apo si pasojë e sëmundjeve të përsëritura apo kronike.

Pesha-për-gjatësi mund të përdoret për të vlerësuar peshën e vogël apo mbipeshën. Fëmijët, pesha-për-gjatësi e të cilëve është më shumë se dy devijime standarde nën mesataren e popullatës referuese klasifikohen me humbje mesatare/ të rëndë të peshës derisa ata që janë tri apo më shumë devijime standarde nën mesatare klasifikohen me humbje të theksuar të peshës. Pesha e vogël për gjatësinë është zakonisht pasojë e pamjaftueshmërisë së ushqyerjes gjatë kohëve të fundit. Treguesi i peshës së vogël për gjatësinë mund të shfaq ndryshime të rëndësishme sezonale që lidhet me ndryshimin e disponueshmërisë së ushqimit apo prevalencën e sëmundjeve.

Fëmijët, pesha-për-gjatësinë e të cilëve është më shumë se dy devijime standarde mbi mesataren e popullatës referuese klasifikohen si mesatarisht apo rëndë mbipeshë.

Në MICS, pesha dhe gjatësia e të gjithë fëmijëve nën moshën 5 vjeçare është matur duke përdorur pajisjet antropometrike të rekomanduara¹⁷ nga UNICEF-i. Gjetjet në këtë seksion janë të bazuara në rezultatet e këtyre matjeve.

Tabela NU.2 tregon përqindjet e fëmijëve të klasifikuar në secilën nga kategoritë e lartpërmendura, bazuar në masat antropometrike që janë marrur gjatë punës në terren. Për më tepër, tabela përfshinë rezultatet mesatare-z për të tre treguesit antropometrik.

¹⁶ http://www.who.int/childgrowth/standards/technical_report

¹⁷ Shih Udhëzimet e prokurimit të MICS-it për furnizim: http://www.childinfo.org/mics5_planning.html

Tabela NU.2: Gjendja e të ushqyerit të fëmijëve

Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare sipas gjendjes së të ushqyerit sipas tre treguesve antropometrik: pesha për moshën, gjatësia për moshën, dhe pesha për gjatësinë, Kosovë, 2013-2014

	Pesha për moshën			Numri i fëmijëve nën moshën 5 vjeçare	Gjatësia për moshën			Numri i fëmijëve nën moshën 5 vjeçare	Pesha për gjatësinë				Numri i fëmijëve nën moshën 5 vjeçare
	Nëneshë		Mesatarja e pikëve (SD)		Ngecje në rritje		Mesatarja e pikëve (SD)		Pesha e vogël për gjatësinë		Mbipeshë	Mesatarja e pikëve (SD)	
	Përqindja nën - 2 SD ¹	- 3 SD ²			Përqindja nën - 2 SD ³	- 3 SD ⁴			Përqindja nën - 2 SD ⁵	- 3 SD ⁶			
Totali	1.8	0.3	0.0	1561	4.3	0.6	-0.1	1513	1.4	0.3	4.3	0.2	1508
Gjinia													
Meshkuj	1.8	0.2	0.1	820	4.3	0.8	-0.1	796	1.6	0.1	4.2	0.1	793
Femra	1.7	0.3	0.0	741	4.2	0.3	-0.2	716	1.2	0.4	4.4	0.2	715
Vendbanimi													
Urban	1.5	0.2	0.2	554	2.4	0.6	0.1	535	1.6	0.6	6.2	0.2	531
Rural	1.9	0.3	0.0	1007	5.3	0.6	-0.2	977	1.3	0.1	3.3	0.1	977
Mosha													
0-5 muaj	4.6	0.6	-0.1	132	4.4	0.0	0.2	129	5.8	1.6	2.2	-0.4	129
6-11 muaj	2.6	0.6	-0.1	177	2.8	1.8	0.2	177	1.0	0.5	3.4	-0.1	177
12-17 muaj	0.7	0.7	0.2	142	3.5	0.0	0.1	139	2.0	0.0	5.6	0.2	138
18-23 muaj	0.6	0.0	0.1	157	2.6	0.6	-0.1	149	0.9	0.0	5.0	0.2	149
24-35 muaj	1.6	0.0	0.2	324	4.0	0.4	-0.2	310	1.1	0.0	4.7	0.3	308
36-47 muaj	1.8	0.4	0.0	298	7.6	0.4	-0.4	288	0.7	0.4	4.4	0.3	287
48-59 muaj	1.3	0.0	0.0	332	3.3	0.8	-0.3	321	0.7	0.0	4.3	0.2	320
Arsimimi i nënës ^a													
Nuk ka arsimim	(4.3)	(0.0)	(-0.7)	27	(27.8)	(8.6)	(-1.1)	25	(0.0)	(0.0)	(0.0)	(0.0)	26
Fillor	6.2	1.2	-0.3	95	13.5	3.0	-0.7	94	2.1	0.0	3.8	0.2	93
I mesëm i ulët	1.4	0.0	-0.1	717	3.7	0.0	-0.2	709	1.6	0.1	2.7	0.1	708
I mesëm i lartë	1.6	0.6	0.2	487	2.4	0.9	0.1	459	1.5	0.7	7.5	0.2	457
I lartë	1.2	0.0	0.2	235	3.1	0.0	0.2	225	0.3	0.0	3.5	0.2	224
Kuintilët e indeksit të pasurisë													
Më të varfërit	2.2	0.0	-0.2	384	8.9	1.0	-0.5	374	1.2	0.3	3.6	0.1	374
Të dytët	2.8	0.7	-0.1	310	4.3	1.4	-0.3	300	1.9	0.8	2.8	0.0	300
Mesatar	0.9	0.0	0.1	302	2.6	0.4	0.0	295	1.6	0.0	3.8	0.2	295
Të katërt	1.5	0.2	0.1	294	3.0	0.0	0.0	283	0.8	0.0	4.0	0.2	282
Më të pasurit	1.3	0.4	0.4	271	0.7	0.0	0.4	261	1.4	0.3	7.9	0.3	257
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare													
Shqiptar	1.8	0.3	0.0	1440	3.7	0.5	-0.1	1396	1.4	0.3	4.3	0.1	1392
Serb	(*)	(*)	(*)	34	(*)	(*)	(*)	33	(*)	(*)	(*)	(*)	33
Grupe tjera etnike	2.3	0.0	-0.2	87	10.1	2.2	-0.5	83	2.6	0.0	5.2	0.1	83
¹ Treguesi MICS 2.1a dhe Treguesi OZHM 1.8 – Prevalenca e nën peshës (mesatare dhe e rëndë)													
² Treguesi MICS 2.1b – Prevalenca e nën peshës (e rëndë)													
³ Treguesi MICS 2.2a – Prevalenca e ngecjes në rritje (mesatare dhe e rëndë)													
⁴ Treguesi MICS 2.2b – Prevalenca e ngecjes në rritje (e rëndë)													
⁵ Treguesi MICS 2.3a – Prevalenca e peshës së vogël për gjatësinë (mesatare dhe e rëndë)													
⁶ Treguesi MICS 2.3b - Prevalenca e peshës së vogël për gjatësinë (e rëndë)													
⁷ Treguesi MICS 2.4 – Prevalenca e mbipeshës													
^a Për shkak të numrit të vogël të rasteve të pa peshuara, nuk është paraqitur kategoria “Mungon/ND” për karakteristikën e përgjithshme “Arsimimi i nënës”													
() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara													
(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara													


Fëmijët ditëlindja e plotë (muaji dhe viti) e të cilëve nuk është siguruar dhe masat e të cilëve janë jashtë kufijve të besueshëm janë të përjashtuar nga Tabela NU.2. Për më shumë, fëmijët janë përjashtuar nga një apo më shumë tregues antropometrik nëse pesha dhe gjatësia e tyre nuk janë matur, cilado të ketë qenë. Për shembull, nëse një fëmijë është peshuar, por gjatësia e tij/saj nuk është matur, atëherë fëmija është përfshirë në kalkulimet e nën peshës, por nuk është përfshirë në kalkulimet e ngecjes në rritje dhe humbjes në peshë. Përqindjet e fëmijëve sipas moshës dhe arsytet e

përrjashtimit janë paraqitur në Tabelat me të dhëna cilësore DQ.12, DQ.13, dhe DQ.14 në Shtojcën D. Tabelat tregojnë se për shkak të datës së lindjes së pa kompletuar, matjeve të pabesueshme dhe/ose mungesës së peshës dhe/ose gjatësisë, pesë përqind e fëmijëve janë përrjashtuar nga kalkulimet e treguesit të peshës-për-moshën, tetë përqind nga treguesi i gjatësisë-për-moshën dhe nëntë përqind nga treguesi i peshës-për-gjatësinë. Një e katërta (26 përqind) e matjeve të gjatësisë sipas raportimit të shifrave janë me pikë decimale ose 0 ose 5 (Tabela DQ.15) përrderisa matjet e peshës tregojnë një shpërndarje më të barabartë.

Përafërsisht dy përqind e fëmijëve nën moshën pesë vjeçare në Kosovë janë mesatarisht ose rëndë nën peshë dhe pothuajse asnjë nuk janë klasifikuar me nënpeshë të rëndë (Tabela NU.2). Një në dymbëdhjetë fëmijë (katër përqind) janë mesatarisht ose rëndë me ngecje në rritje, apo shumë të shkurtë për moshën e tyre dhe një përqind janë mesatarisht apo rëndë me peshë të vogël për gjatësinë apo shumë të dobët për gjatësinë që kanë. Kjo përqindje e vogël tregon se nuk ka probleme të theksueshme me ngecjen në rritje dhe nën peshën në përgjithësi në Kosovë. Ngecja në rritje është e koncentruar në kuintilin më të varfër të pasurisë krahasuar me kuintilin më të pasur të pasurisë. Katër përqind e fëmijëve janë mbi peshë apo shumë të plotë për gjatësinë që kanë.

Ata fëmijë nëna e të cilëve ka arsimim të mesëm të lartë apo të lartë kanë më së paku të ngjarë të jenë në peshë apo me ngecje në rritje krahasuar me fëmijët e nënave pa arsimim apo me arsimim¹⁸ fillor. Dallimet janë minimale sa i përket nënpeshës, ngecjes në rritje, peshës së vogël për gjatësinë sipas gjinisë. Trendi sipas moshës tregon se ka një luhatje në përqindje të fëmijëve të moshës 15 muajsh dhe më të vjetër që janë me peshë të vogël për gjatësinë, nënpeshë, mbipeshë dhe me ngecje në rritje (Figura NU.1).

Figura NU.1: Fëmijët e moshës nën 5 vjeç me nën peshë, ngecje në rritje, peshë të vogël për gjatësinë dhe mbi peshë (mesatarisht apo rëndë), Kosovë 2013-2014



GJIDHËNJA DHE TË USHQYERIT E FOSH NJEVE DHE FËMIJËVE TË VEGJËL

Të ushqyerit adekuat të foshnjëve dhe fëmijëve të vegjël mund të rris gjasat e tyre për mbijetesë: mund të promovojë po ashtu edhe rritje dhe zhvillim optimal, posaçërisht në dritaren kritike nga lindja deri në moshën 2 vjeçare. Për vitet e para të jetës të ushqyerit me gji mbron fëmijët nga infeksioni, ofron burim ideal të lëndëve ushqyese dhe është i sigurt dhe ekonomik. Megjithatë, shumë nëna nuk e fillojnë të ushqyerit me gji mjaftueshëm herët, nuk i ushqejnë fëmijët e tyre vetëm (ekskluzivisht) me gji për 6 muajt e rekomanduar apo ndalojnë të ushqyerit me gji shumë herët. Shpesh ka presione për të kaluar në formulë qumështi, të cilat mund të ndikojnë në kufizim në rritje dhe kequshqyerje me lëndë mikro ushqyese e cila mund të jetë e pasigurt nëse kushtet higjienike, përfshirë ujin e pijshëm, nuk janë të pranishme. Studimet kanë treguar se përveç vazhdimet të të ushqyerit me gji, konsumimi i ushqimeve të duhura dhe adekuate të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta nga moshë 6 muajshe e tutje, çon në një shëndet më të mirë dhe rezultate më të mira në rritje, me mundësi për të reduktuar ngecjen në rritje për 2 vitet e para të jetës.¹⁹

¹⁸ Rezultatet për kategorinë "Nuk kanë arsimim" janë të bazuara në 25-49 raste të pa peshuara dhe si të tilla duhet të interpretohen me kujdes.

¹⁹ Bhutta Z. et al. (2013). *Evidence-based interventions for improvement of maternal and child nutrition: What can be done and at what cost?* The Lancet June 6, 2013.

UNICEF-i dhe OBSH-ja rekomandojnë që foshnjat duhet të ushqehen me gji brenda orës së parë të lindjes, të ushqehen vetëm me gji gjatë 6 muajve të parë të jetës, dhe të vazhdojnë të ushqehen me gji deri në moshën 2 vjet e më tutje.²⁰ Informatat për të ushqyerit e fëmijëve nën moshën 6 muajsh me gji janë dhënë në tabelën NU.3. Duke filluar nga mosha 6 muaj të ushqyerit me gji duhet të kombinohet me ushqime të sigurta, ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta të përshtatshme për moshën.²¹ Një përmbledhje e parimeve udhëzuese kyçe^{22,23}, për ushqim nga mosha 6-23 muajsh është ofruar në tabelën e mëposhtme, së bashku me matjet e përafërta për këto udhëzime të mbledhura në këtë anketë.

Parimet udhëzuese për të cilat ekzistojnë masat e përafërta dhe treguesit janë:

- (i) të ushqyerit e vazhdueshëm me gji;
- (ii) shpeshtësia e duhur e shujtave (por jo densiteti i energjisë); dhe
- (iii) përmbajtja e duhur e lëndëve ushqyese në ushqim.

Shpeshtësia e shujtave përdoret si ushqim indirekt për energjinë e konsumuar, e cila kërkon që fëmijët të marrin numrin minimal të shujtave/ushqime të shpejta mes-shujtave (dhe ushqimeve me qumësht për fëmijët që nuk ushqehen me gji) për moshën e tyre. Llojllojshmëria e ushqimit përdoret për të siguruar konsumin e përmbajtjes së lëndëve adekuat ushqyese në ushqim (duke mos përfshirë hekurin) të konsumuar. Për llojllojshmërinë e ushqimit janë krijuar shtatë grupe të ushqimit ku fëmija i cili ka konsumuar së paku katër nga këto grupe të ushqimit konsiderohet të ketë dietë kualitative. Në shumicën e popullatave, konsumimi i së paku katër nga këto grupe të ushqimit nënkupton se fëmija ka gjasa të mëdha për të konsumuar së paku një ushqim mishi, dhe së paku një nga frutat apo perimet, përveç ushqimit themelor (drithërave, ushqime nga rrënjët apo patate).²⁴

Këto tri dimensionet e të ushqyerit të fëmijëve janë të kombinuara në një vlerësim të fëmijëve që marrin ushqimin e duhur, duke përdorur treguesin “ushqyeshmëria minimale e pranueshme”. Për të pasur ushqyeshmëri minimale të pranueshme në ditën paraprake, fëmija do të duhej të ketë konsumuar:

- (i) numrin e duhur të shujtave/ushqime të shpejta mes-shujtave/ushqimeve me qumësht
- (ii) artikuj ushqimor nga së paku 4 grupe të ushqimit; dhe
- (iii) qumësht gjiri apo së paku dy ushqime me qumësht (për fëmijët që nuk ushqehen me gji).

Parimet udhëheqëse (mosha 6-23 muajsh)	Masat e përafërta	Tabela
Të ushqyerit e vazhdueshëm me gji sipas kërkesës për 2 vite e më shumë	Ushqyer me gji në 24 orët e fundit	NU.4
Shpeshtësia e duhur dhe densiteti energjetik i shujtave	Fëmijët e ushqyer me gji Varësisht nga mosha, dy ose tri shujta/ushqime të shpejta mes-shujtave të ofruara në 24 orët e fundit	NU.6
Përmbajtja e lëndëve të duhura ushqyese në ushqim	Fëmijët që nuk ushqehen me gji Katër shujta/ ushqime të shpejta mes-shujtave dhe <u>ose ushqime me qumësht</u> të ofruara në 24 orët e fundit	NU.6
Sasia e duhur e ushqimit	Katër grupet e ushqimit ²⁵ të ngrëna në 24 orët e fundit	NU.6
Konsistenca e duhur e ushqimit	Nuk ekziston tregues standard	na
Përdorimi i plotësuesve me vitamina dhe minerale apo produkteve të fortifikuara për foshnjën dhe nënën	Nuk ekziston tregues standard	na
Praktika e higjienës së mirë dhe trajtimi i duhur i ushqimit	Derisa nuk ishte e mundur të zhvillohen tregues për të matur në tërësi udhëzuesin e programit, një tregues standard matë një pjesë të parimit: Nuk duhet ushqyer me shishe me shishe/biberon	NU.9
Praktika e të ushqyerit të përgjegjshëm, duke aplikuar parimet e kujdesit psiko-social	Nuk ekziston tregues standard	na

²⁰ OBSH. 2003. Implementimi i Strategjisë Globale për të ushqyerit e Foshnjeve dhe Fëmijëve të vegjël. Raporti i takimit në Gjenevë, 3-5 Shkurt 2003.

²¹ OBSH. 2003. Strategjia Globale për të ushqyerit e Foshnjeve dhe Fëmijëve të Vegjël

²² PAHO. 2003. Principet udhëheqëse për ushqimin plotësues të fëmijëve të ushqyer me gji

²³ OBSH. 2005. Principet udhëheqëse për ushqimin e fëmijëve që nuk ushqehen me gji të moshës 6-24 muaj

²⁴ OBSH. 2008. Treguesit për vlerësimin e praktikave të të ushqyerit të foshnjeve dhe fëmijëve, Pjesa 1: Definicionet.

²⁵ Grupet e ushqimit të përdorura për vlerësimin e këtij treguesi janë: 1) drithëra, ushqime nga rrënjët si panxhari dhe patatet, 2) bimë bishtajore (si fasulja) dhe arrat, 3) produkte qumështi (qumësht, kos, djath), 4) ushqime mishi (mishi, peshk, mish pule dhe mushkri), 5) ve, 6) pemë dhe perime të pasura me vitaminën-A dhe 7) pemët dhe perime të tjera

Tabela NU.3: Të ushqyerit fillestar me gji

Përqindja e fëmijëve të fundit të lindur të gjallë në dy vitet e fundit të cilët janë ushqyer ndonjëherë me gji, të ushqyer me gji brenda orës së parë të lindjes, dhe brenda ditës së parë të lindjes, si dhe përqindja e atyre që kanë marr ndonjë ushqim tjetër para se të fillohet me qumësht të gjirit (prelactal), Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e atyre që janë ushqyer ndonjëherë me gji ¹	Përqindja e atyre që së pari janë ushqyer me qumësht gjiri:		Përqindja e atyre që janë ushqyer me ushqim tjetër para se të fillohet me qumësht gjiri	Numri i fëmijëve të fundit të lindur të gjallë në dy vitet e fundit
		Brenda orës së parë të lindjes ²	Brenda ditës së parë të lindjes		
Totali	96.7	45.4	85.5	25.2	636
Vendbanimi					
Urban	97.4	45.6	84.9	31.3	242
Rural	96.3	45.3	85.8	21.4	394
Muaj që nga lindja e fundit					
0-11 muaj	97.5	46.1	85.0	28.4	323
12-23 muaj	95.9	44.7	86.0	21.9	314
Asistenca në lindje					
Profesionist i trajnuar	97.4	45.6	86.0	25.4	630
Tjetër	(*)	(*)	(*)	(*)	1
Askush / Mungon	(*)	(*)	(*)	(*)	4
Vendi i lindjes					
Shtëpi	(*)	(*)	(*)	(*)	1
Institucion shëndetësor	97.4	45.6	86.0	25.3	630
Publik	97.3	44.7	86.0	24.1	608
Privat	(*)	(*)	(*)	(*)	22
Tjetër/ND/Mungon	(*)	(*)	(*)	(*)	6
Arsimimi i nënës					
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	(*)	10
Fillor	(92.3)	(41.0)	(83.4)	(17.6)	34
I mesëm i ulët	96.6	48.1	87.1	18.6	279
I mesëm i lartë	98.3	43.1	85.7	27.6	197
I lartë	96.6	43.4	82.8	41.2	116
Kuintilët e indeksit të pasurisë					
Më të varfërit	94.9	51.8	86.8	14.0	140
Të dytët	98.2	42.1	92.1	21.3	128
Mesatar	97.2	43.1	83.2	27.0	129
Të katërt	96.0	37.8	82.2	27.0	124
Më të pasurit	97.6	52.2	82.5	39.0	116
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare					
Shqiptar	96.6	46.3	87.4	24.3	579
Serb	(*)	(*)	(*)	(*)	19
Grupe tjera etnike	(96.5)	(50.5)	(77.6)	(20.6)	38
¹ Treguesi MICS 2.5 – Fëmijë të ushqyer me gji ndonjëherë ² Treguesi MICS 2.6 – Fillimi i hershëm i të ushqyerit me gji					
() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara (*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara					

Tabela NU.3 është e bazuar në raportimet e nënave për të porsalindurin e tyre të fundit të lindur të gjallë në dy vitet e fundit, se me çfarë është ushqyer i porsalinduri i tyre në ditët e para pas lindjes. Kjo tregon proporcionin e atyre që janë ushqyer ndonjëherë me qumësht gjiri, atyre që janë ushqyer me qumësht gjiri brenda orës së parë pas lindjes dhe ditës së parë të lindjes dhe atyre që kanë marrur ndonjë ushqim para se të fillohet me qumësht gjiri²⁶.

²⁶ Marrja e ndonjë ushqimi tjetër para se të fillohet me qumësht të gjirit (prelactal) i referohet ofrimit të çfarëdo lëngu apo ushqimi të porsalindurit përveç qumështit të gjirit gjatë periudhës kur rrjedhja e qumështit të gjirit është në proces të krijimit (vlerësuar të jetë 3 ditët e para të jetës).

Edhe pse është një hap shumë i rëndësishëm i menaxhimit të qumështit të gjirit dhe krijimit të lidhjes fizike dhe emocionale mes nënës dhe të porsalindurit, vetëm 45 përqind të foshnjeve janë ushqyer me gji brenda orës së parë pas lindjes, përderisa 86 përqind e të porsalindurve kanë filluar të ushqyerit me gji brenda ditës së parë të lindjes dhe 97 përqind janë ushqyer me gji ndonjëherë. Nuk ka dallime sipas karakteristikave të përgjithshme (Figura NU.2).

Të dhënat mbi treguesit e të ushqyerit të foshnjeve dhe fëmijëve të vegjël të raportuar nga tabelat NU.4 deri NU.8 janë të bazuara në raportimet e nënave mbi konsumimin e ushqimit gjatë ditës apo natës para intervistës. Të dhënat janë subjekt i një numri kufizimesh, disa të lidhura me aftësinë e respondentëve që të ofrojnë të dhëna të plota për ushqimet dhe lëngjet e marra nga fëmija, për shkak të gabimeve të lidhura me kujtesën, apo mungesa e njohurive në rastet kur fëmija është ushqyer nga individë të tjerë.

Në tabelën NU.4, gjendja e të ushqyerit me gji është prezantuar edhe për të ushqyerit vetëm me gji dhe për të ushqyerit me gji si ushqim kryesor; që u referohet foshnjeve më të vegjël se 6 muaj që ushqehen me gji, ku e para dallohet me të dytën sepse në të parën lejohen vetëm vitaminat, plotësimet me minerale dhe barëra, dhe e dyta lejon edhe ujë dhe lëngje të tjera përjashtuar qumështin. Tabela po ashtu paraqet të ushqyerit e vazhdueshëm me gji të fëmijëve të moshave 12-15 dhe 20-23 muaj.

Tabela NU.4: Të ushqyerit me gji^a

Përqindja e fëmijëve të gjallë sipas statusit të ushqyeshmërisë me gji për grup moshat e përzgjedhura, Kosovë, 2013-2014


	Fëmijët e moshës 0-5 muajsh			Fëmijët e moshës 12-15 muajsh		Fëmijët e moshës 20-23 muajsh	
	Përqindja e të ushqyerve vetëm me gji ¹	Përqindja e të ushqyerve me gji si ushqim kryesor ²	Numri i fëmijëve	Përqindja e të ushqyerve me gji (Vazhdimi i të ushqyerit me gji deri në 1 vit) ³	Numri i fëmijëve	Përqindja e të ushqyerve me gji (Vazhdimi i të ushqyerit me gji deri në 2 vjet) ⁴	Numri i fëmijëve
Totali	39.9	53.2	142	56.5	97	31.8	109
Gjinia							
Meshkuj	42.5	53.3	81	56.9	53	36.5	65
Femra	36.5	53.0	61	(56.1)	43	(25.0)	44
Vendbanimi							
Urban	50.3	59.0	52	(61.7)	35	(34.3)	42
Rural	33.9	49.8	90	53.6	61	30.3	67
Arsimimi i nënës^b							
I mesëm i ulët/Fillor/ Nuk ka arsimim	39.0	53.7	71	60.1	54	38.0	53
I mesëm i lartë/I lartë	40.9	52.7	72	52.1	43	25.9	56
Kuintilët e indeksit të pasurisë							
Më të varfërit	(34.0)	(51.2)	38	(*)	23	(*)	22
Të dytët	(*)	(*)	22	(69.9)	24	(*)	26
Mesatar	(43.4)	(59.1)	29	(*)	20	(*)	23
Të katërt	(37.2)	(37.2)	24	(*)	14	(*)	21
Më të pasurit	(48.8)	(64.5)	31	(*)	16	(*)	17

Tabela NU.4: Të ushqyerit me gji^a (vazhdim)

Indeksi i pasurisë ^c							
60 përqindëshi i më të varfërve	37.5	53.6	88	57.8	67	31.8	71
40 përqindëshi i më të pasurve	43.7	52.5	55	(53.6)	30	(31.9)	38
¹ Treguesi MICS 2.7 – Të ushqyerit vetëm me gji nën 6 muaj ² Treguesi MICS 2.8 – Të ushqyerit me gji si ushqimi kryesor nën 6 muaj ³ Treguesi MICS 2.9 – Vazhdimi i të ushqyerit me gji deri në 1 vit ⁴ Treguesi MICS 2.10 – Vazhdimi i të ushqyerit me gji deri në 2 vjet ^a Karakteristika e përgjithshme "Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare" nuk është paraqitur në tabelë për shkak të numrit të vogël të rasteve të pa peshuara për kategoritë e zbërthyer ^b Për shkak të numrave të vogël të emëruesve të dhënat për karakteristikën e përgjithshme "Arsimimi i nënës" janë grupuar në dy grupe ^c Për shkak të numrave të vogël të emëruesve të dhënat për karakteristikën e përgjithshme "Kuintilët e indeksit të pasurisë" të dhënat janë grupuar në dy grupe: 60 përqindëshi i më të varfërve (tre Kuintilët e poshtëm të pasurisë) dhe 40 përqindëshi i më të pasurve (dy Kuintilët e sipërm të pasurisë) () Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara (*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara							

Përafërsisht 40 përqind e fëmijëve të moshës më të vogël se gjashtë muaj janë të ushqyer vetëm me gji. Me 53 përqind të fëmijëve të ushqyer me qumësht gjiri si ushqim kryesor është evidente që lëngjet me bazë uji janë duke e zëvendësuar në një shkallë të madhe qumështin e gjirit. Nga mosha 12-15 muajsh, 57 përqind e fëmijëve ushqehen me gji dhe nga mosha 20-23 muajsh, 32 përqind e fëmijëve ushqehen me gji. Fëmijët më të vegjël se 6 muaj kanë më shumë të ngjarë të ushqehen (ekskluzivisht) vetëm me gji në vendbanimet urbane (50 përqind) krahasuar me ata të vendbanimeve rurale (34 përqind).

Figura NU.2 paraqet një model të detajuar të të ushqyerit me gji për fëmijët sipas moshës në muaj. Më shumë se gjysma e foshnjëve 2-3 muajsh (55 përqind) janë duke u ushqyer me lëngje dhe ushqime tjera përveq qumështit të gjirit, me qumësht tjetër/formulë që është me prevalencën më të lartë. Në moshën 4-5 muajsh, përqindja e fëmijëve që ushqehen vetëm me gji është nën 21 përqind. Vetëm rreth një e treta (31 përqind) e fëmijëve janë duke u ushqyer me qumësht gjiri në moshën 2 vjeçare.

Figura NU.2: Mënyrat e të ushqyerit të foshnjëve sipas moshës, Kosovë, 2013-2014

Shënim: Shifrat për moshën të shprehur në muaj 0-1, 4-5, 12-13 dhe 20-21 janë bazuar në 25-49 raste të pa peshuara

Tabela NU.5 tregon kohëzgjatjen mesatare të të ushqyerit me gji sipas karakteristikave të përgjithshme të përzgjedhura. Mes fëmijëve nën moshën 3 vjeçare, kohëzgjatja mesatare është 14.1 muaj për cilëndo formë të të ushqyerit me gji, 2.0 muaj për të ushqyerit vetëm me gji, dhe 2.8 muaj për të ushqyerit me gji si ushqim kryesor. Fëmijët meshkuj dhe femra duket të ushqehen me gji për kohëzgjatje të njëjtë dhe ka dallime të kufizuara në mes vendbanimeve urbane dhe rurale. Kohëzgjatja mesatare e të ushqyerit me gji është më e madhe në mesin e nënave me arsimim fillor, derisa kohëzgjatja e të ushqyerit vetëm me gji rritet me rritjen e nivelit të arsimit të nënës.

Tabela NU.5: Kohëzgjatja e ushqyeshmërisë me gji

Kohëzgjatja mesatare e cilësdo formë të ushqyeshmërisë me gji, të ushqyerit vetëm me gji dhe të ushqyerit me gji si ushqim kryesor në mesin e fëmijëve të moshës 0-35 muajsh, Kosovë, 2013-2014

	Kohëzgjatja mesatare (në muaj) e:			Numri i fëmijëve të moshës 0-35 muajsh
	Cilësdo formë e të ushqyerit me gji ¹	Të ushqyerit vetëm me gji	Të ushqyerit me gji si ushqim kryesor	
Mesatarja	14.1	2.0	2.8	974
Gjinia				
Meshkuj	14.5	2.2	2.8	522
Femra	13.7	1.8	2.8	452
Vendbanimi				
Urban	15.0	2.5	3.3	353
Rural	13.0	1.9	2.5	621
Arsimimi i nënës^a				
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	14
Fillor	17.4	1.9	2.2	55
I mesëm i ulët	15.8	2.0	2.9	437
I mesëm i lartë	12.3	2.0	2.4	305
I lartë	12.7	2.5	3.3	162
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	15.5	1.8	2.7	230
Të dytët	16.8	2.0	2.5	185
Mesatar	12.6	2.3	3.2	202
Të katërt	11.6	0.7	0.7	181
Më të pasurit	15.0	2.4	3.6	176
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare^b				
Shqiptar	14.5	2.1	2.9	894
Serb	(*)	-	-	28
Grupe tjera etnike	13.1	1.7	2.5	52
Mesatarja	15.2	2.5	3.4	974

¹ Treguesi MICS 2.11 – Kohëzgjatja e gjidhënies

^a Për shkak të numrit të vogël të rasteve të pa peshuara, nuk është paraqitur kategoria "Mungon/ND" për karakteristikën e përgjithshme "Arsimimi i nënës"

^b Për shkak të numrit të vogël të rasteve të pa peshuara, nuk është paraqitur kategoria "Mungon/ND" për karakteristikën e përgjithshme "Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare"

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

"-" Tregon 0 raste të pa peshuara në atë katror apo në numërues

Të ushqyerit me gji adekuat për moshën te fëmijët nën moshën 24 muaj është ofruar në Tabelën NU.6. Janë përdorur kriteret e ndryshme të të ushqyerit varësisht nga mosha e fëmijës. Për foshnjat e moshës 0-5 muajsh, të ushqyerit vetëm me gji konsiderohet si formë e përshtatshme e të ushqyerit për moshën, përderisa për fëmijët e moshës 6-23 muajsh, ushqyerje e përshtatshme për moshën konsiderohet nëse ata ushqehen me qumësht gjiri dhe ushqim të ngurtë, gjysmë të ngurtë dhe të butë. Si rezultat i këtyre mënyrave të të ushqyerit, vetëm 48 përqind e fëmijëve të moshës 6-23 muajsh janë duke u ushqyer me gji në mënyrë adekuate për moshën, dhe të ushqyerit adekuat me gji për moshën në mesin e të gjithë fëmijëve të moshës 0-23 muajsh është 46 përqind.

Tabela NU.6: Të ushqyerit e përshtatshëm për moshën^a

Përqindja e fëmijëve të moshës 0-23 muajsh të cilët janë ushqyer në mënyrë adekuate me qumësht gjiri në ditën paraprake, Kosovë, 2013-2014

	Fëmijët e moshës 0-5 muajsh		Fëmijët e moshës 6-23 muaj		Fëmijët e moshës 0-23 muajsh	
	Përqindja e të ushqyerve vetëm me gji ¹	Numri i fëmijëve	Përqindja e fëmijëve që aktualisht ushqehen me gji dhe me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta	Numri i fëmijëve	Përqindja e të ushqyerve adekuate me gji ²	Numri i fëmijëve
Totali	39.9	142	48.1	492	46.3	635
Gjinia						
Meshkuj	42.5	81	51.1	274	49.1	355
Femra	36.5	61	44.4	218	42.7	280
Vendbanimi						
Urban	50.3	52	49.2	185	49.5	238
Rural	33.9	90	47.4	307	44.4	397
Arsimimi i nënës						
Nuk ka arsimim	(*)	4	(*)	5	(*)	9
Fillor	(*)	9	(50.0)	31	(44.8)	40
I mesëm i ulët	38.1	58	53.0	217	49.8	275
I mesëm i lartë	(34.8)	43	42.9	156	41.2	198
I lartë	(49.7)	29	43.7	83	45.2	112
Kuintilët e indeksit të pasurisë						
Më të varfërit	(34.0)	38	53.9	104	48.6	141
Të dytët	(*)	22	48.5	100	46.3	122
Mesatar	(43.4)	29	44.4	104	44.2	133
Të katërt	(37.2)	24	46.2	101	44.5	125
Më të pasurit	(48.8)	31	47.4	83	47.8	114

¹ Treguesi MICS 2.7 – Të ushqyerit vetëm me gji nën moshën 6 muaj² Treguesi MICS 2.12 – Të ushqyerit me gji adekuate për moshën^a Karakteristikat e përgjithshme për "Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare" nuk është paraqitur në tabelë për shkak të numrit të vogël të rasteve të pa peshuara për kategoritë e zbërthyera

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Në përgjithësi, 90 përqind e foshnjeve të moshës 6-8 muajsh janë ushqyer me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta apo të buta gjatë ditës paraprake (Tabela NU.7); që është e ngjashme në mesin e foshnjeve të ushqyera aktualisht me gji (87 përqind).

Tabela NU.7: Fillimi i të ushqyerit me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta

Përqindja e foshnjeve të moshës 6-8 muajsh që janë ushqyer me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta apo të buta gjatë ditës paraprake, Kosovë, 2013-2014

	Aktualisht ushqehen me gji		Aktualisht nuk ushqehen me gji		Të gjithë	
	Përqindja e të ushqyerve me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta	Numri i fëmijëve të moshës 6-8 muajsh	Përqindja e të ushqyerve me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta	Numri i fëmijëve të moshës 6-8 muajsh	Përqindja e të ushqyerve me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta ¹	Numri i fëmijëve të moshës 6-8 muajsh
Totali	86.8	67	(100.0)	25	90.3	92
Gjinia						
Meshkuj	(95.4)	39	(*)	11	96.4	50
Femra	(74.7)	28	(*)	13	(82.9)	41
Vendbanimi						
Urban	(*)	19	(*)	9	(96.8)	28
Rural	(83.4)	48	(*)	16	87.5	64

¹ Treguesi MICS 2.13 – Fillimi me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Në përgjithësi, shumica e fëmijëve të moshës 6-23 muaj (90 përqind) janë ushqyer me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta në shpeshtësi minimale, siç paraqitet në Tabelën NU.8. Proporcioni i fëmijëve që ushqehen me llojlojshmërinë minimal të ushqimit apo ushqime nga së paku 4 grupet e ushqimeve ishte shumë më i ulët se sa shpeshtësia minimale e shujtave, që tregon nevojën për fokusim në përmirësimin e cilësisë së të ushqyerit dhe marrjes së lëndëve ushqyese mes këtij grupi të prekshëm. Një proporcion pak më i lartë i fëmijëve më të rritur (12-17 muajsh) (67 përqind) kanë përmbushur llojlojshmërinë minimale të ushqimit në krahasim me fëmijët më të vegjël (të moshës 6-8 muajsh) (29 përqind). Vlerësimi i përgjithshëm duke përdorur treguesin e ushqimit minimal të pranueshme ka treguar se më pak se gjysma e fëmijëve të moshës 6-23 muajsh (49 përqind) kanë përfituar nga ushqimi i mjaftueshëm edhe në llojlojshmëri edhe në shpeshtësi. Ushqyeshmëria minimale e pranuar e fëmijëve rritet me rritjen e nivelit të arsimimit të nënës. Fëmijët që jetojnë në vendbanimet rurale kanë më pak të ngjarë të përmbushin llojlojshmërinë minimale të ushqimit dhe ushqyeshmërinë minimale të pranueshme krahasuar me ata të vendbanimeve rurale. Llojlojshmërinë minimale e ushqimit të fëmijëve që nuk ushqehen aktualisht me gji është më e lartë se sa te ata që janë duke ushqyer aktualisht me gji.

Tabela NU.8: Praktikë e të ushqyerit të foshnjëve dhe fëmijëve të vegjël^a

Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muajsh të cilët janë ushqyer me lëngje të duhura dhe ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta apo të buta në shpeshtësinë minimale apo më shumë gjatë ditës, sipas statusit të të ushqyerit me gji, Kosovë, 2013-2014

	Aktualisht ushqehen me gji				Aktualisht nuk ushqehen me gji				Të gjithë			
	Përqindja e fëmijëve që kanë marrë:			Numri i fëmijëve të moshës 6-23 muajsh	Përqindja e fëmijëve që janë ushqyer me:			Numri i fëmijëve të moshës 6-23 muajsh	Përqindja e fëmijëve që janë ushqyer me:			Numri i fëmijëve të moshës 6-23 muajsh
	Llojlojshmërinë minimale të ushqyerit ^b	Shpeshtësinë minimale të shujtave ^c	Ushqyeshmërinë minimale të pranueshme ^d		Llojlojshmërinë minimale të ushqyerit ^b	Shpeshtësinë minimale të shujtave ^c	Ushqyeshmërinë minimale të pranueshme ^d		Llojlojshmërinë minimale të ushqyerit ^b	Shpeshtësinë minimale të shujtave ^c	Ushqyeshmërinë minimale të pranueshme ^d	
Totali	50.6	85.5	47.1	246	75.5	95.5	51.8	81.1	63.3	90.3	49.4	492
Gjinia												
Meshkuj	52.7	88.4	49.7	142	82.2	94.7	55.9	83.4	67.1	91.3	52.6	274
Femra	47.7	81.5	43.6	105	67.7	96.6	47.1	78.4	58.5	89.1	45.3	218
Mosha												
6-8 muaj	23.9	81.0	22.6	67	(*)	(*)	(*)	(*)	28.7	84.6	23.4	92
9-11 muaj	56.0	88.1	54.4	51	(56.4)	(95.5)	(41.7)	(90.2)	57.3	91.2	49.1	90
12-17 muaj	53.9	86.1	49.0	72	78.1	94.3	56.4	82.6	67.2	90.1	52.6	147
18-23 muaj	73.3	87.6	67.1	56	88.2	96.4	57.8	74.7	82.4	93.3	61.1	163
Vendbanimi												
Urban	68.8	91.1	65.6	92	80.9	96.5	57.5	89.6	74.8	93.7	61.6	185
Rural	39.7	82.2	36.0	154	72.1	95.0	48.3	75.8	56.3	88.3	41.9	307
Arsimimi i nënës^e												
I mesëm i ulët/Fillor/Nuk ka arsimim	41.3	80.8	37.9	142	68.3	93.5	41.9	76.5	53.3	86.1	39.6	253
I mesëm i lartë/I lartë	63.4	91.8	59.6	104	81.0	97.1	59.6	84.6	73.8	94.8	59.6	239
Kuintilët e indeksit të pasurisë												
Më të varfërit	39.9	78.8	36.9	60	(52.0)	(86.4)	(32.8)	(71.6)	45.6	81.9	35.2	104
Të dytët	40.4	84.7	38.7	52	(78.0)	(98.2)	(49.7)	(84.7)	57.7	91.0	43.9	100
Mesatar	(60.9)	(89.0)	(60.9)	48	(81.9)	(94.5)	(58.3)	(79.0)	72.9	91.9	59.6	104
Të katërt	(52.6)	(86.5)	(43.4)	47	(82.6)	(98.2)	(52.5)	(78.5)	68.4	92.5	48.2	101
Më të pasurit	(65.2)	(91.1)	(60.9)	39	(79.1)	(100.0)	(64.6)	(92.8)	73.6	95.5	62.7	83

^a Treguesi MICS 2.17a – Ushqyeshmëria minimale e pranueshme (tek fëmijët e ushqyer me gji)

^b Treguesi MICS 2.17b – Ushqyeshmëria minimale e pranueshme (tek fëmijët që nuk ushqehen me gji)

^c Treguesi MICS 2.14 – Shpeshtësia e të ushqyerit me qumësht për fëmijët që nuk ushqehen me gji

^d Treguesi MICS 2.16 – Llojlojshmëria minimal e ushqimit

^e Treguesi MICS 2.15 – Shpeshtësia minimale e shujtave

^a Karakteristikat e përgjithshme për "Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare" nuk është paraqitur në tabelë për shkak të numrit të vogël të rasteve të pa peshuara për kategoritë e zbrëthyer

^b Llojlojshmëria minimale e ushqimit është e definuar si marrja e ushqimeve nga së paku 4 nga 7 grupe të ushqimeve: 1) drithëra, ushqime nga rrënjët si panxhari dhe patatet, 2) bimë bishtajore (si fasulja) dhe arrat, 3) produkte qumështi (qumësht, kos, djath), 4) ushqime mishi (mishi, peshk, mish pule dhe mushkri), 5) ve, 6) pemë dhe perime të pasura me vitaminën-A dhe 7) pemë dhe perime të tjera

^c Shpeshtësia minimale e shujtave në mesin e fëmijëve që aktualisht ushqehen me gji definohet si fëmijët që ushqehen po ashtu me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta apo të buta 2 apo më shumë herë në ditë për fëmijët e moshës 6-8 muajsh dhe 3 apo më shumë herë në ditë për fëmijët e moshës 9-23 muajsh. Për fëmijët që nuk ushqehen me gji të moshës 6-23 muajsh definohet si marrja e ushqimeve të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të butë apo ushqime me qumësht së paku 4 herë në ditë.

^d Ushqyeshmëria minimale e pranueshme për fëmijët që ushqehen me gji të moshës 6-23 muajsh definohet si të ushqyerit me llojlojshmërinë minimale të ushqimit dhe me shpeshtësinë minimale të shujtave, përderisa për fëmijët që nuk ushqehen me gji kërkohen më tutje edhe 2 shujta me qumësht dhe që llojlojshmëria minimale e ushqimit arrihet pa llogaritur shujtat me qumësht.

^e Për shkak të numrave të vogël të emëruesve të dhënar për karakteristikën e përgjithshme "Arsimimi i nënës" janë grupuar në dy grupe

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Praktikat e vazhdueshme të të ushqyerit me shishe/biberon janë brengosëse për arsye të kontaminimit të mundshëm për shkak të ujit të pasigurt dhe mungesës së higjienës gjatë përgatitjes. Tabela NU.9 tregon se ushqimi me shishe/biberon është prevalent në Kosovë. Pothuajse dy të tretat (62 përqind) e fëmijëve të moshës 0-23 muajsh janë ushqyer me shishe/biberon me cucëll. Ka dallime të vogla sipas lokacionit të ekonomive familjare dhe nivelit të arsimimit të nënës.

Tabela NU.9: Të ushqyerit me shishe/biberon

Përqindja e fëmijëve të moshës 0-23 muaj që janë ushqyer me shishe/biberon me cucëll gjatë ditës paraprake, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-23 muaj të ushqyer me biberon me cucëll ¹	Numri i fëmijëve të moshës 0-23 muaj
Totali	61.6	635
Gjinia		
Meshkuj	64.5	355
Femra	58.0	280
Mosha		
0-5 muaj	38.9	142
6-11 muaj	70.0	181
12-23 muaj	67.2	311
Vendbanimi		
Urban	61.3	238
Rural	61.8	397
Arsimimi i nënës		
Nuk ka arsimim	(*)	9
Fillor	(60.5)	40
I mesëm i ulët	59.7	275
I mesëm i lartë	64.3	198
I lartë	67.0	112
Kuintilët e indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	55.2	141
Të dytët	59.4	122
Mesatar	63.2	133
Të katërt	71.8	125
Më të pasurit	58.9	114
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare		
Shqiptar	59.7	576
Serb	(*)	20
Grupe tjera etnike	(70.1)	39

¹ Treguesi MICS 2.18 – Të ushqyerit me shishe/biberon

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara



VI. SHËNDETI I FËMIJËVE

VAKSINIMI

Objektiva Zhvillimore e Mijëvjeçarit (OZHM) 4 është për të reduktuar vdekshmërinë e fëmijëve për dy të tretat në mes viteve 1990 – 2015. Imunizimi luan një rol kyç në këtë objektive. Për më tepër, Plani i Veprimt Global i Vaksinit (PVG) është miratuar nga 194 vende anëtare të Asamblesë Botërore për Shëndetësi në Maj 2012 për të arritur vizionin e Dekadës së Vaksinit përmes ofrimit të qasjes universale në imunizim. Imunizimi ka shpëtuar jetën e miliona fëmijëve në katër dekadat që nga fillimi i Programit të Zgjeruar të Imunizimit (PZI) në vitin 1974. Në mbarë botën ka akoma miliona fëmijë që nuk arrihen me imunizimin rutinor dhe si rezultat i sëmundjeve të parandalueshme me vaksinim, çdo vit ka më shumë se 2 milion vdekje.

Sipas Rutinës së Rekomanduar të Imunizimit për Fëmijë nga OBSH-ja²⁷ rekomandon që të gjithë fëmijët të vaksinohen kundër tuberkulozit, difterisë, kollës së keqe, tetanusit, polios, fruthit, hepatit B, haemophilus influenzae tipi b, pneumonia/meningjiti, rotavirus, dhe rubella.

Të gjitha dozat në serinë e parë rekomandohet të kompletohen para ditëlindjes së parë të fëmijës, edhe pse varësisht nga epidemiologjia e sëmundjes në vend, doza e parë e vaksinave kundër fruthit dhe rubellës mund të rekomandohet të merret në moshën 12 muajshe e më vonë. Numri dhe koha e rekomanduar e shumicës së dozave tjera poashtu ndryshon pak me epidemiologjitë lokale dhe mund të përfshijë doza përforcuese më vonë në fëmijëri.

Kalendari i vaksinimit i ndjekur nga Programi Kombëtar i Imunizimit të Kosovës ofron të gjitha vaksinat e përmendura më lartë (përveç pneumonias/meningjiti dhe rotavirus) me një dozë në lindje të vaksinës BCG dhe Hepatit B (brenda 24 orëve të lindjes), tri doza të vaksinës pentavalente që përmbajnë antigjenët e DTP-së, Hepatit B dhe Haemophilus influenzae tipi b, tri doza të vaksinës Polio, dhe një dozë të vaksinës MMR (Fruth, Parotit dhe Rubella) që përmbanë antigjenët e fruthit, shytave, dhe rubellës. Të gjitha vaksinat duhet të merren gjatë vitit të parë të jetës përveq fruthit i cili mirret në moshën 12 muajshe. Vaksina pentavalente DPT-HepB-Hib është përfshirë për herë të parë në kalendarin e imunizimit në Kosovë në qershor të vitit 2011 dhe ka filluar të implementohet në gjithë Kosovën nga Janari i vitit 2012. Vaksina pentavalente ka zëvendësuar plotësisht vaksinat individuale monovalente dhe poashtu është përfshirë edhe Haemophilus influenzae tipi b si vaksinë e re e cila nuk është dhënë më herët. Shënim, në tabelë antigjenët e përfshirë në vaksinën pentavalente janë prezantuar si antigjen individual. Duke pasur parasysh këtë kalendar të vaksinimit, vlerësimet për mbulueshmërinë e plotë me imunizim për MICS-in në Kosovë janë bazuar tek fëmijët e moshës 24-35 muajsh.

Informatat mbi mbulueshmërinë me vaksinim janë mbledhur për të gjithë fëmijët nën moshën tre vjeçare. Të gjitha nënave (apo kujdestarëve) u është kërkuar kartelat e vaksinimit. Nëse kartela e vaksinimit të fëmijës është treguar, atëherë intervistuesit kanë përshkruar informatat e vaksinimit nga kartelat e vaksinimit në pyetësorin e MICS. Nëse nuk ka pasur kartelë vaksinimi për fëmijën, intervistuesit kanë vazhduar të pyesin nënën të rikujtoj nëse fëmija ka marrur secilën vaksinë, dhe se sa doza ka marrë për Polion, DTP, Hepatitin B dhe Haemophilus influenzae tipi b. Informatat janë mbledhur po ashtu nga regjistrat e vaksinimit në institucionet shëndetësore për të gjithë fëmijët. Vlerësimet përfundimtare të mbulueshmërisë me vaksinim janë të bazuara në informatat e mbledhura nga regjistrat e vaksinimit nga institucionet shëndetësore, kartelave të vaksinimit dhe raportimit të nënës për vaksinimin e fëmijës. Radhitja e përzgjedhjes së të dhënave është së pari të dhënat për vaksinat individuale nga regjistrat e vaksinimit nga institucionet shëndetësore, pastaj kartela e imunizimit, dhe në fund bazuar në kujtesën/raportimin e nënës.

²⁷ <http://www.who.int/immunization/diseases/en>. Tabela 2 përfshinë rekomandimet për të gjithë fëmijët si dhe antigjenët e rekomanduar vetëm për fëmijët që jetojnë në regjione të caktuara të botës apo ata që jetojnë në grupe të popullatave me rrezik të lartë.

Tabela CH.1: Vaksinimi në vitin e parë të jetës

Përqindja e fëmijëve të moshës 12-23 muajsh dhe 24-35 muajsh të vaksinuar kundër sëmundjeve të parandalueshme të fëmijërisë në cilëndo kohë para anketës dhe deri në ditëlindjen e tyre të parë, Kosovë, 2013-2014

	Fëmijët e moshës 12-23 muajsh:				Fëmijët e moshës 24-35 muajsh:			
	Vaksinuar në çfarëdo kohe para anketës sipas:				Vaksinuar në çfarëdo kohe para anketës sipas:			
	Regjistrin nga institucioni shëndetësor apo kartelës së vaksinimi	Raportimit të nënë	Cilado	Vaksinuar deri në muajin e 12 të jetës ^a	Regjistrin nga institucioni shëndetësor apo kartelës së vaksinimit	Raportimi i nënës	Cilado	Vaksinuar deri në muajin e 12 të jetës (fruthi deri më 24 muaj) ^a
Antigjeni								
BCG ¹	95.5	3.1	98.7	98.7	95.2	3.1	98.3	98.3
Polio								
1	96.0	1.5	97.5	97.5	96.0	1.9	97.9	97.6
2	95.3	1.8	97.1	96.7	94.3	2.4	96.7	95.4
3 ²	92.8	0.8	93.6	91.0	93.6	2.0	95.6	91.4
DTP								
1	94.6	3.0	97.7	97.7	92.3	5.4	97.7	97.7
2	94.6	1.8	96.4	96.4	91.3	4.4	95.7	95.7
3 ³	94.0	0.8	94.7	94.7	91.1	3.4	94.5	94.5
HepB								
Në lindje	51.7	0.6	52.3	52.3	53.1	2.4	55.5	55.5
1 ^b	93.1	2.5	95.7	95.7	91.7	3.8	95.5	95.5
2	93.3	2.1	95.3	95.3	91.8	5.2	97.0	97.0
3 ⁴	92.9	1.1	94.0	94.0	90.6	4.2	94.7	94.7
Hib								
1	90.5	3.5	94.1	94.1	90.7	6.0	96.7	96.7
2	89.4	2.9	92.3	92.3	88.8	5.2	94.0	94.0
3 ⁵	88.0	1.1	89.1	89.1	88.2	3.3	91.6	91.6
Fruthi (MMR) ⁶	82.2	2.0	84.2	na	89.6	3.2	92.8	92.1
Plotësisht të vaksinuar ^{7, d}	na	na	na	na	83.4	1.1	84.5	78.5
Ska vaksinime	0.3	0.7	1.0	1.0	0.0	1.1	1.1	1.1
Numri i fëmijëve	311	311	311	311	339	339	339	339

¹ Treguesi i MICS-it 3.1 – Mbulueshmëria me imunizim kundër tuberkulozit

² Treguesi i MICS-it 3.2 – Mbulueshmëria me imunizim kundër polios

³ Treguesi i MICS-it 3.3 – Mbulueshmëria me imunizim kundër Difterisë, kollës së keqe dhe tetanusit (DTP)

⁴ Treguesi i MICS-it 3.5 – Mbulueshmëria me imunizim kundër Hepatitit B

⁵ Treguesi i MICS-it 3.6 – Mbulueshmëria me imunizim kundër Hemophilus influenzae tipi B (Hib)

⁶ Treguesi i MICS-it 3.4; Treguesi i OZHM-së 4.3 – Mbulueshmëria me imunizim kundër fruthit

⁷ Treguesi i MICS-it 3.8 – Mbulueshmëria e imunizimit të plotë

na: nuk aplikohet

^a Për treguesit e MICS-it 3.1, 3.2, 3.3, 3.5 dhe 3.6 referohu rezultateve të kësaj kolone në anën e majtë; për treguesit e MICS-it 3.4 dhe 3.8, referohu në kolonën në anën e djathtë

^b HepB1 përfshinë ose HepB në lindje nëse kjo ka qenë doza e parë që fëmija ka marrë, ose HepB1 nëse fëmija nuk e ka marrur dozën në lindje.

^c Fruthi ipet përmes vaksinës së kombinuar të fruthit, shytave dhe rubellës (MMR) në Kosovë.

^d Përfshinë BCG, DTP3, HepB3, dhe Fruthin (MMR) sipas kalendarit të vaksinimit në Kosovë

Përqindja e fëmijëve të moshës 12-23 muajsh dhe 24-35 muajsh që kanë marrur secilën nga vaksinat sipas burimit të informacionit (regjistri në institucionet shëndetësore apo kartela e vaksinimit, dhe kujtesa e nënës) është treguar në Tabelën CH.1 dhe Figurën CH.1. Emëruesit për tabelë janë të përbërë nga fëmijët e moshës 12-23 muajsh dhe 24-35 muajsh ashtu që vetëm fëmijët që kanë moshën e duhur për vaksinim janë njësuar. Në tri kolonat e para në secilin panel të tabelës, numëruesi përfshinë të gjithë fëmijët që janë vaksinuar në çfarëdo kohe para anketës bazuar në regjistrat e vaksinimit në institucionet shëndetësore apo kartelën e vaksinimit si dhe raportimit të nënës. Në kolonën e fundit të secilit panel, janë përfshirë vetëm ata fëmijë që janë vaksinuar para ditëlindjes së tyre të parë (për fruthin deri në ditëlindjen e tyre të dytë), siç rekomandohet. Për fëmijët pa regjistra vaksinimi në institucione shëndetësore/kartela vaksinimi, proporcioni i vaksinave të marra para ditëlindjes së parë është presupozuar të jetë i njëjtë si për fëmijët me regjistra vaksinimi në institucione shëndetësore/kartela.

Pothuajse të gjithë fëmijët (99 përqind) të moshës 12-23 muajsh kanë marrur vaksinën BCG deri në moshën 12 muajsh, dhe dozën e parë të DTP-së. Vaksinat e HepB dhe Hib-it janë dhënë tek 98, 96 dhe 94 përqind përkatësisht. Vini re se si do që të jetë doza e HepB në lindje e cila duhet dhënë brenda 24 orëve pas lindjes është dhënë vetëm tek 52 përqind të fëmijëve të moshës 12-23 muajsh. Përqindjet bien lehtë në 96, 95 dhe 92 përqind përkatësisht për dozën e dytë të DTP-së, HepB dhe Hib, dhe në 95, 94, dhe 89 përqind përkatësisht për dozën e tretë. Ngjashëm, 98 përqind e fëmijëve të moshës 12-23 muajsh kanë marrë Polio 1 deri në moshën 12 muajsh, dhe kjo bie në 91 përqind deri në dozën e tretë. Mbulueshmëria për dozën e parë të vaksinës së fruthit deri në moshën 24 muajsh në 92 përqind është më e ulët se sa për shumicën e vaksinave tjera për fëmijët e së njëjtës moshë. Si rezultat, përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh që kanë marrur të gjitha vaksinat e rekomanduara deri në ditëlindjen e parë (përveç vaksinës MMR që është deri në 24 muaj), është tepër e ulët në vetëm 79 përqind. Vlerat për mbulueshmërinë individuale për fëmijët e moshave 24-35 janë përgjithësisht të ngjashme me ato të moshës 12-23 muajsh, që sugjerojnë se mbulueshmëria me imunizim në mesatare ka mbetur stabile në Kosovë mes viteve 2012 dhe 2013.

Figura CH.1: Vaksinimi deri në moshën 12 muajsh (fruthit deri 24 muaj), Kosovë, 2013-2014




Tabela CH.2 prezanton vlerësimet e mbulueshmërisë së vaksinimit në mesin e fëmijëve të moshës 12-23 dhe 24-35 muajsh sipas karakteristikave të përgjithshme. Vlerat paraqesin fëmijët që kanë marrur vaksinat në çfarëdo kohe deri në datën e anketës dhe janë të bazuara në informatat e marra nga të dyja regjistrat e vaksinave në institucionet shëndetësore apo kartelës së vaksinave dhe raportimit të nënave (apo kujdestarëve). Kartelat e vaksinave janë parë nga intervistuesit për 97 përqind të fëmijëve të moshës 24-35 muajsh.

Tabela CH.2: Vaksinimet sipas karakteristikave të përgjithshme³

Përqindja e fëmijëve të moshës 12-23 muajsh që janë aktualisht të vaksinuar kundër sëmundjeve të parandalueshme të fëmijërisë, Kosovë, 2013-2014

Përqindja e fëmijëve të moshës 12-23 muajsh që kanë marrur:																					Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh							
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
										Përqindja e fëmijëve që u është parë regjistri i vaksinave në institucione shëndetësore të moshës 12-23 muajsh											Frutht(MMR) ^b		Të gjitha ^c		S'ka kartela e vaksinimit		Numri i fëmijëve të moshës 24-35 muajsh	
Siç është treguar në tabelë, për meshkujt e rinj, dallimet sa i përket karakteristikave të përgjithshme janë përgjithësisht të ngjashme me ato që janë vërejtur tek femrat e reja. 87 përqind e meshkujve të rinj që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare kanë përdorur internetin gjatë vitit të fundit krahasuar me përdorim universal në mesin e atyre që jetojnë në ekonomitë më të pasura familjare (100 përqind).

Tabela MT.2M: Përdorimi i kompjuterit dhe internetit (meshkujt)

Përqindja e meshkujve të rinj të moshës 15-24 vjeçare që kanë përdorur ndonjëherë kompjuter dhe internet, përqindja e atyre që kanë përdorur gjatë 12 muajve të fundit dhe përqindja e atyre që kanë përdorur së paku një herë në javë gjatë muajit të fundit, Kosovë, 2013-2014

Përqindja e meshkujve të moshës 15-24 vjeçare që kanë:							Numri i meshkujve të moshës 15-24 vjeçare
	Përdorur ndonjëherë kompjuter	Përdorur kompjuter gjatë 12 muajve të fundit ¹	Përdorur kompjuter së paku një herë në javë në muajin e fundit	Përdorur ndonjë herë internetin	Përdorur internetin gjatë 12 muajve të fundit ²	Përdorur internetin së paku një herë në javë gjatë muajit të fundit	
Totali	98.7	92.8	83.2	98.1	96.9	92.5	843
Mosha							
15-19	98.7	92.0	82.1	98.6	97.3	92.5	468
15-17	98.8	93.6	82.5	98.5	97.8	91.7	297
18-19	98.6	89.2	81.3	98.6	96.3	93.8	171
20-24	98.6	93.7	84.5	97.5	96.5	92.6	375
Vendbanimi							
Urban	98.8	90.8	81.6	98.9	97.9	96.1	281
Rural	98.6	93.7	83.9	97.7	96.4	90.8	561
Arsimimi							
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	2
Fillor	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	3
I mesëm i ulët	93.4	84.9	71.8	89.5	89.5	76.0	87
I mesëm i lartë	99.1	93.0	81.5	99.0	97.4	92.9	536
I lartë	100.0	96.0	92.4	100.0	99.5	99.1	214
Kuqintilët e indeksit të pasurisë							
Më të varfërit	95.3	85.5	65.2	91.8	87.1	72.1	153
Të dytët	99.5	94.5	86.8	99.4	99.4	96.3	198
Mesatarët	99.1	96.4	89.2	98.5	97.1	95.7	174
Të katërtit	99.1	94.2	86.0	100.0	100.0	97.3	164
Më të pasurit	100.0	92.2	86.4	100.0	100.0	99.4	153
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare							
Shqiptar	98.9	93.2	83.1	98.4	97.1	92.6	787
Serb	(96.4)	(87.7)	(84.1)	(96.7)	(96.7)	(96.7)	33
Grupe tjera etnike	(94.9)	(85.9)	(82.6)	(89.8)	(89.8)	(84.4)	22
¹ Treguesi i MICS-it 10.2 – Përdorimi i kompjuterit ^(M) ² Treguesi i MICS-it 10.3 – Shfrytëzimi i internetit ^(M)							
() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara (*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara							



XIV. MIRËQENIA SUBJEKTIVE

Perceptimet subjektive të individëve rreth të ardhurave të tyre, shëndetit, ambientit e jetesës e kështu më radhë, luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e tyre dhe mund të kenë ndikim në perceptimet e mirëqenies së tyre, pavarësisht kushteve objektive siç janë të ardhurat aktuale dhe gjendja e shëndetit fizik.⁷⁶ Në MICS, një sërë pyetjesh u janë bërë femrave dhe meshkujve të moshës 15-24 vjeçare për të kuptuar se sa ky grup i të rinjve janë të kënaqur në fusha të ndryshme të jetës së tyre siç është jeta e tyre familjare, miqësia, shkolla, puna e tanishme, shëndeti, ku jetojnë dhe se si trajtohen nga të tjerët, si duken, dhe të ardhurat e tyre të tanishme.

Kënaqshmëria me jetën është një njësi matëse e nivelit të mirëqenës sipas perceptimit individual. Të kuptuarit e kënaqshmërisë së femrave dhe meshkujve të rinj në fusha të ndryshme të jetës së tyre mund të ndihmojë për të fituar një pasqyrë të plotë të kënaqshmërisë së të rinjve me jetën. Duhet po ashtu të bëhet dallimi në mes të kënaqshmërisë me jetën dhe lumturisë. Lumturia është një emocion kalimtar që mund të preket nga shumë faktor, përfshirë faktorët ditorë siç janë moti, vdekja e dikujt në familje etj. Është e mundshme për një person të jetë i kënaqur me punën, të ardhurat, jetën familjare, miqtë dhe aspektet tjera të jetës, por prapë të jetë i palumtur apo e kundërta. Përveç pyetjeve të bëra për kënaqshmërinë me jetën, në këtë anketë janë bërë po ashtu pyetje rreth lumturisë dhe perceptimet e respondentëve për një jetë më të mirë.

Për t'iu ndihmuar respondentëve në përgjigjen e pyetjeve për lumturinë dhe kënaqshmërinë me jetën atyre u është shfaqur një kartë me fytyra të buzëqeshura (dhe jo buzëqeshura) që korrespondojnë me kategoritë e përgjigjeve (shih Pyetësorët në Shtojcën F) “shumë të kënaqur”, “paksa të kënaqur”, “as i kënaqur e as jo i kënaqur”, “paksa jo i kënaqur”, dhe “shumë të pakënaqur”. Për pyetjet rreth lumturisë e njëjta shkallë është përdorur duke filluar nga “shumë të lumtur” deri në “shumë të palumtur”, në të njëjtën mënyrë.

Tabelat SW.1 respektivisht SW.1M tregojnë proporcionin e femrave dhe meshkujve të rinj të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të kënaqur në fusha të përzgjedhura. Vini re që për tri fushat, kënaqshmëria me shkollën, vendin e punës dhe të ardhurat, emëruesit janë të kufizuar vetëm për ata që ndjekin shkollën, që punojnë dhe kanë të ardhura. Nga fushat e ndryshme, femrat e reja janë më së shumti të kënaqura me jetën e tyre familjare dhe shëndetin e tyre (përkatësisht 96 përqind), mënyrën se si duken (92 përqind) dhe miqtë e tyre (94 përqind). Gjetjet për meshkujt e rinj janë të ngjashme; ata janë më së shumti të kënaqur me jetën e tyre familjare dhe shëndetin e tyre (përkatësisht 97 përqind), mënyrën se si duken (96 përqind) dhe miqtë e tyre (94 përqind). Mes këtyre fushave, edhe femrat e reja edhe meshkujt e rinj janë më së paku të kënaqur me të ardhurat e tyre, me shtatë përqind të femrave të reja dhe gjashtë përqind të meshkujve të rinj që nuk kanë fare të ardhura. Derisa 90 përqind e femrave të moshës 15-19 vjeçare janë shumë apo deri diku të kënaqur me shkollën, vlera është më e ulët në mesin e atyre të moshës 20-24 vjeçare (78 përqind). 43 përqind e vajzave të moshës 15-19 vjeçare kanë një punë dhe 49 përqind të vajzave të moshës 20-24 vjeçare. Trendi i këtyre femrave që janë pak më të kënaqura është vëzhguar po ashtu për punën dhe të ardhurat e tyre (93 përkatësisht 84 përqind). 80 përqind e vajzave të moshës 15-19 vjeçare janë duke vijuar shkollën dhe 93 përqind të vajzave të moshës 20-24 vjeçare. Dallimet sa i përket shumicës së variablave të përgjithshme janë relativisht të vogla për femra.

⁷⁶ OECD. 2013. *OECD Guidelines on Measuring Subjective Well Being*. OECD. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264191655-en>

Tabela SW.1: Fushat e kënaqshmërisë me jetën (femrat)

Përqindja e femrave të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të kënaqura në fushat e përzgjedhura të kënaqshmërisë, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e femrave të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të kënaqura në fushat e caktuara:					Përqindja e femrave të moshës 15-24 vjeçare që				
	Jetën familjare	Raportet me miqtë	Shëndetin	Ambientin jetësor	Trajtimin nga të tjerët	Mënyrën sesi duken	Vijojnë shkollën	Kanë punë	Kanë të ardhura	Numri i femrave të moshës15-24 vjeçare të shumë apo paksa të kënaqura me shkollën
Totali	96.0	90.8	95.5	86.2	88.4	92.0	63.4	45.9	93.3	1829
Mosha										
15-19	96.4	91.8	96.5	87.1	89.3	91.3	80.2	42.6	94.4	945
15-17	96.6	92.4	96.9	86.9	89.6	90.6	88.4	40.9	94.0	563
18-19	96.1	90.8	95.8	87.4	88.9	92.5	68.1	45.2	95.0	382
20-24	95.6	89.8	94.3	85.3	87.3	92.7	45.4	49.3	92.2	884
Vendbanimet										
Urbani	95.5	91.1	97.0	85.2	88.6	91.9	73.2	44.1	95.4	661
Rural	96.3	90.7	94.6	86.8	88.2	92.0	57.8	46.8	92.2	1168
Statusi martesor										
Ndonjëherë e martuar / në bashkëjetesë	93.9	94.2	95.0	91.9	88.7	94.1	16.1	55.8	95.6	323
Asnjëherë e martuar / në bashkëjetesë	96.5	90.1	95.5	85.0	88.3	91.5	73.5	43.7	92.9	1506
Arsiminii										
Niveli i arsimin	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	3
Fillore	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	18
I mesëm i ulët	94.4	91.1	95.1	90.1	88.7	93.1	16.3	56.0	97.0	350
I mesëm i lartë	96.4	92.5	95.8	87.0	89.6	91.8	66.9	46.0	94.1	882
I lartë	96.7	88.5	95.1	82.4	87.3	91.6	88.8	39.4	89.9	576
Kuinitëet e indeksit të pasurisë										
Më të varfërit	93.1	87.3	93.0	82.1	82.7	89.2	44.6	47.0	93.2	340
Të dytët	97.0	92.4	95.1	89.3	89.3	94.0	55.8	51.6	93.7	400
Mesatarët	96.5	91.7	96.5	87.7	90.7	93.3	63.9	46.3	92.6	350
Të katërtit	94.7	89.3	96.4	85.6	88.8	91.6	70.4	42.3	95.4	393
Më të pasurit	98.7	93.3	96.2	86.0	89.9	91.5	82.2	41.7	91.7	346
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare										
Shqiptar	96.0	91.2	96.0	87.9	88.7	91.8	63.4	48.3	96.7	1672
Serb	97.2	86.8	88.6	58.8	87.4	96.5	83.9	4.7	29.6	91
Grupe tjera etnike	95.1	86.6	92.3	82.7	79.7	90.3	34.2	40.7	97.4	66

(1) Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara
(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara
“n” Tregon 0 raste të pa peshuara në atë katorr apo në numërtes

Në Tabelat SW.2 dhe SW.2M, janë treguar proporcionet e femrave dhe meshkujve të moshës 15-24 vjeçare me kënaqshmëri të përgjithshme me jetën. "Kënaqshmëria me jetën" definohet si ata/ato që janë shumë apo paksa të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi, dhe është e bazuar në një pyetje të vetme që është parashtruar pas pyetjeve për kënaqshmërinë me jetën në të gjitha fushat e lartë përmendura, me përjashtim të pyetjes për kënaqshmërinë me të ardhurat, e cila është parashtruar më vonë. 92 përqind të femrave të moshës 15-24 vjeçare janë të kënaqura me jetën e tyre në përgjithësi – shifrat variojnë nga 86 përqind të femrave që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare në 96 përqind në mesin e atyre që jetojnë në ekonomitë më të pasura familjare që tregon një ndërlidhje mes pasurisë dhe kënaqshmërisë me jetën. Proporcioni i femrave nuk variojnë në mënyrë signifikante sipas statusit martesor dhe nivelit të arsimimit. Nuk ka dallime të theksueshme për kënaqshmërinë e përgjithshme me jetën sipas karakteristikave të përgjithshme.

Si matje përmbledhëse, pikët mesatare të kënaqshmërisë me jetën janë llogaritur po ashtu dhe prezantuar në Tabelat SW.2 dhe SW.2M. Pikët janë llogaritur thjesht duke bërë mesataren e përgjigjeve në pyetjen për kënaqshmërinë me jetën në përgjithësi, duke i radhitur nga shumë të kënaqur (1) paksa shumë të pakënaqur (5) (shih pyetësorët në shtojcën F). Prandaj, sa më i vogël që është rezultati i mesatares, aq më të larta janë nivelet e kënaqshmërisë. Mesatarja e pikëve të kënaqshmërisë me jetën për femrat është 1.4 derisa për meshkujt është 1.3 dhe nuk ka dallime sipas karakteristikave të përgjithshme.

Tabelat po ashtu tregojnë se 90 përqind të femrave dhe 83 përqind të meshkujve të moshës 15-24 vjeçare janë shumë apo paksa të lumtur. 90 përqind të meshkujve të moshës 15-17 vjeçare janë shumë apo deri diku të lumtur derisa përqindja është pak më e ulët për meshkujt e moshës 18-19 vjeçare me 78 përqind. Në mesin e femrave të kësaj moshë nuk ka dallime të theksueshme në përqindje të atyre që janë shumë apo deri diku të lumtura.

Tabela SW.2: Kënaqshmëria e përgjithshme me jetën dhe lumturia (femrat)

Përqindja e femrave të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të kënaqura me jetën e tyre në përgjithësi, mesatarja e kënaqshmërisë së përgjithshme me jetën, dhe përqindja e femrave të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të lumtura, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e femrave me kënaqshmëri të përgjithshme me jetën ¹	Pikët/Rezultati i mesatares së kënaqshmërisë	Përqindja e femrave që janë shumë apo paksa të lumtura ²	Numri i femrave të moshës 15-24 vjeçare
Totali	91.8	1.4	90.0	1829
Mosha				
15-19	92.3	1.4	89.1	945
15-17	93.3	1.3	89.3	563
18-19	90.7	1.4	88.7	382
20-24	91.3	1.4	91.1	884
Vendbanimet				
Urban	92.7	1.4	90.6	661
Rural	91.3	1.4	89.7	1168
Statusi martesor				
Ndonjëherë e martuar / në bashkëjetesë	91.5	1.3	93.1	323
Asnjëherë e martuar / në bashkëjetesë	91.9	1.4	89.4	1506
Arsimimi				
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	3
Fillor	(*)	(*)	(*)	18
I mesëm i ulët	90.9	1.4	90.5	350
I mesëm i lartë	92.6	1.3	88.9	882
I lartë	91.2	1.4	91.2	576
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	85.9	1.5	83.6	340
Të dytët	92.5	1.4	92.4	400
Mesatarët	93.5	1.3	91.2	350
Të katërtit	91.2	1.4	87.9	393
Më të pasurit	95.9	1.3	94.9	346
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare				
Shqiptar	91.7	1.4	89.7	1672
Serb	94.3	1.5	97.2	91
Grupe tjera etnike	90.7	1.5	89.4	66

¹ Treguesi i MICS-it 11.1 – Kënaqshmëria me jetën

² Treguesi i MICS-it 11.2 - Lumturia

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Tabela SW.2M: Kënaqshmëria e përgjithshme me jetën dhe lumturia (meshkujt)

Përqindja e meshkujve të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi, mesatarja e kënaqshmërisë së përgjithshme, dhe përqindja e meshkujve të moshës 15-24 vjeçare që janë shumë apo paksa të lumtur, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e meshkujve me kënaqshmëri të përgjithshme me jetën ¹	Pikët/Rezultati i mesatares së kënaqshmërisë	Përqindja e meshkujve që janë shumë apo paksa të lumtur ²	Numri i meshkujve të moshës 15-24 vjeçare
Totali	93.0	1.3	83.4	843
Mosha				
15-19	94.5	1.3	85.6	468
15-17	95.6	1.2	90.0	297
18-19	92.6	1.3	78.0	171
20-24	91.2	1.4	80.7	375
Vendbanimi				
Urban	93.0	1.3	84.0	281
Rural	93.1	1.3	83.2	561
Statusi martesor				
Ndonjëherë i martuar / në bashkëjetesë	(87.7)	(1.5)	(74.3)	37
Asnjëherë i martuar / në bashkëjetesë	93.3	1.3	83.9	806
Arsimimi				
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	2
Fillor	(*)	(*)	(*)	3
I mesëm i ulët	90.8	1.4	80.2	87
I mesëm i lartë	93.1	1.3	84.0	536
I lartë	94.2	1.3	84.2	214
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	88.3	1.5	76.6	153
Të dytët	93.6	1.3	84.4	198
Mesatarët	95.5	1.2	86.6	174
Të katërtit	90.3	1.4	84.3	164
Më të pasurit	97.3	1.2	84.4	153
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare				
Shqiptar	93.6	1.3	83.2	787
Serb	(89.5)	(1.7)	(92.2)	33
Grupe tjera etnike	(76.7)	(1.9)	(79.1)	22

¹ Treguesi i MICS-it – Kënaqshmëria me jetën^(M)

² Treguesi i MICS-it 11.2 – Lumturia^(M)

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Përveç pyetjeve mbi kënaqshmërinë me jetën dhe lumturinë, respondentëve u janë parashtruar po ashtu dy pyetje te thjeshta nëse ata mendojnë se jeta e tyre është përmirësuar në vitin e fundit dhe nëse mendojnë se jeta e tyre do të përmirësohet në vitin në vijim. Informata e tilla mund të kontribuojnë në të kuptuarit e dëshpërimit që mund të ekzistojë në mesin e të rinjve si dhe pa shpresën dhe shpresave për të ardhmen. Kombinimet specifike të perceptimeve gjatë vitit të fundit dhe pritjet për vitin e ardhshëm mund të jenë informata të vlefshme për të kuptuar një ndjesi të përgjithshme të mirëqenies në mesin e të rinjve.

Në Tabelat SW.3 dhe SW3.M, janë dhënë perceptimet e femrave dhe meshkujve për një jetë më të mirë. Proporcioni i femrave të moshës 15-24 vjeçare që mendojnë se jeta e tyre është përmirësuar gjatë vitit të fundit dhe që presin se jeta e tyre do të përmirësohet pas një viti është 52 përqind. Treguesi korrespondues për meshkuj të moshave 15-24 vjeçare është më i ngjashëm me 57 përqind. Dallimet në perceptimet për një jetë më të mirë mund të vërehen sipas kuintilëve të pasurisë: 46 përqind të vajzave të reja dhe 48 përqind të djemve të rinj që jetojnë në popullatën më të varfër të ekonomisë familjare mendojnë se jeta e tyre është përmirësuar gjatë vitit të fundit dhe presin se ajo do të bëhet më mirë në vitin që vije, derisa proporcioni korrespondues për vajzat e reja dhe meshkujt që jetojnë në kuintilët më të pasura të popullatës së ekonomive familjare janë 55 përqind përkatësisht 62 përqind.

Tabela SW.3: Perceptimi për një jetë më të mirë (femrat)

Përqindja e femrave të moshës 15-24 vjeçare që mendojnë se jeta e tyre është përmirësuar gjatë vitit të fundit dhe që presin se jeta e tyre do të përmirësohet vitin që vjen, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e femrave që mendojnë se jeta e tyre:			Numri i femrave të moshës 15-24 vjeçare
	Është përmirësuar gjatë vitit të fundit	Do të përmirësohet vitin që vije	Të dyja ¹	
Totali	55.9	88.8	51.9	1829
Mosha				
15-19	57.4	87.4	52.7	945
15-17	57.5	85.5	51.8	563
18-19	57.2	90.1	53.9	382
20-24	54.4	90.4	51.1	884
Vendbanimet				
Urban	54.7	89.9	52.0	661
Rural	56.6	88.3	51.8	1168
Statusi martesor				
Ndonjëherë e martuar / në bashkëjetesë	55.8	89.9	51.2	323
Asnjëherë e martuar / në bashkëjetesë	56.0	88.6	52.0	1506
Arsimimi				
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	3
Fillor	(*)	(*)	(*)	18
I mesëm i ulët	55.5	89.6	52.7	350
I mesëm i lartë	55.7	87.8	50.4	882
I lartë	56.5	89.8	53.4	576
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	49.4	87.4	45.5	340
Të dytët	57.4	91.8	53.2	400
Mesatarët	57.6	89.5	53.3	350
Të katërtit	56.8	87.7	52.5	393
Më të pasurit	57.9	87.5	54.5	346
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare				
Shqiptar	56.9	89.3	52.9	1672
Serb	44.2	80.9	38.4	91
Grupe tjera etnike	47.6	87.8	45.3	66

¹ Treguesi i MICS-it 11.3 – Perceptimi për një jetë më të mirë

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Tabela SW.3M: Perceptimi për një jetë më të mirë (meshkujt)

Përqindja e meshkujve të moshës 15-24 vjeçare që mendojnë se jeta e tyre është përmirësuar gjatë vitit të fundit dhe që presin se jeta e tyre do të përmirësohet vitin që vjen, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e meshkujve që mendojnë se jeta e tyre			Numri i meshkujve të moshës 15-24 vjeçare
	Është përmirësuar gjatë vitit të fundit	Do të përmirësohet vitin që vije	Të dyja ¹	
Totali	59.7	89.0	56.7	843
Mosha				
15-19	64.6	88.4	61.2	468
15-17	63.5	88.0	60.1	297
18-19	66.6	89.2	63.1	171
20-24	53.5	89.6	51.1	375
Vendbanimi				
Urban	61.3	91.9	60.2	281
Rural	58.8	87.5	54.9	561
Statusi martesor				
Ndonjëherë i martuar / në bashkëjetesë	(60.0)	(86.9)	(60.0)	37
Asnjëherë i martuar / në bashkëjetesë	59.6	89.1	56.5	806
Arsimimi				
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	2
Fillor	(*)	(*)	(*)	3
I mesëm i ulët	58.1	91.9	55.3	87
I mesëm i lartë	59.2	88.4	55.9	536
I lartë	62.1	89.5	59.8	214
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	51.0	88.1	48.1	153
Të dytët	58.0	83.7	52.9	198
Mesatarët	61.1	89.7	59.9	174
Të katërtit	64.2	92.0	61.4	164
Më të pasurit	64.0	92.6	61.6	153
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare				
Shqiptar	62.1	89.7	59.1	787
Serb	(18.5)	(72.5)	(14.4)	33
Grupe tjera etnike	(32.7)	(89.5)	(32.7)	22
¹ Treguesi i MICS-it 11.3 – Perceptioni për jetë më të mirë ^[M]				
() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara				
(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara				

XV. KONSUMIMI I DUHANIT DHE ALKOOLIT

Produktet e duhanit janë produkte të bëra tërësisht apo pjesërisht nga gjethet e duhanit si material bazë, të cilat janë të bëra për t'u tymosur, thithur, përthypur apo nuhatur. Të gjitha përmbajnë substancë psikoaktive me varshmëri të lartë, që është nikotina. Konsumimi i duhanit është një nga faktorët me rrezik më të lartë për një numër sëmundjesh kronike përfshirë kancerin, sëmundjet e mushkërive dhe sëmundjet kardiovaskulare.⁷⁷

Konsumimi i alkoolit bart rrezik për pasoja të pa dëshirueshme shëndetësore dhe sociale të lidhura me karakteristikat e tij intoksikuese, toksike dhe të varshmërisë. Përveç sëmundjeve kronike që mund të zhvillohen tek ata/ato që përdorin sasi të mëdha të alkoolit përgjatë viteve, konsumimi i alkoolit është po ashtu i ndërlidhur me rrezikun e rritur të gjendjeve akute shëndetësore siç janë lëndimet, përfshirë ato nga aksidentet e trafikut.⁷⁸ Konsumimi i alkoolit shkakton dëme përtej shëndetit fizik dhe psikologjik tek konsumuesit. Ai dëmton mirëqenien dhe shëndetin e njerëzve përreth personit që konsumon. Një person i intoksikuar mund të dëmtojë të tjerët apo t'i vë ata në rrezik të aksidenteve të trafikut apo sjelljeve të dhunshme, apo të ndikojë negativisht te bashkëpunëtorët, të afërmit, miqtë dhe të huajt. Kështu, ndikimi i konsumimi të dëmshëm të alkoolit shkon thellë në rrënjët e shoqërisë.⁷⁹

MICS-i në Kosovë ka mbledhur informata mbi konsumimin e duhanit dhe alkoolit ndonjëherë dhe aktualisht si dhe intensitetin e përdorimit të tyre tek femrat dhe meshkujt e moshës 15-49 vjeçare. Ky seksion prezanton rezultatet kryesore.

KONSUMIMI I DUHANIT

Tabela TA.1 prezanton produktet e duhanit të konsumuara ndonjëherë dhe aktualisht nga femrat e moshës 15-49 vjeçare dhe tabela TA.1M prezanton informatat korresponduese për meshkujt e të njëjtës grup moshë.

Në Kosovë, konsumimi i produkteve të duhanit ndonjëherë dhe aktualisht është më i shpeshtë tek meshkujt sesa tek femrat. 78 përqind e meshkujve dhe 47 përqind e femrave kanë raportuar se kanë konsumuar ndonjëherë produkt të duhanit, ndërsa 34 përqind e meshkujve dhe 19 përqind e femrave kanë konsumuar duhan, apo kanë përdorur produkte të duhanit me apo pa tymosje në një apo më shumë ditë gjatë muajit të kaluar.

⁷⁷ OBSH, <http://www.who.int/topics/tobacco/en/>

⁷⁸ OBSH, http://www.who.int/topics/alcohol_drinking/en/

⁷⁹ WHO, <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs349/en/>

Tabela TA.1: Përdorimi i duhanit aktualisht dhe ndonjëherë (femrat)

Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeçare sipas mënyrës së përdorimit të duhanit, Kosovë, 2013-2014

	Nuk kanë konsumuar asnjëherë cigare apo produkte tjera të duhanit	Kanë konsumuar duhan ndonjëherë				Konsumuesit e produkteve të duhanit në çfarëdo kohe gjatë muajit të fundit				Numri i femrave të moshës 15-49 vjeçare
		Vetëm cigare	Cigare dhe produkte tjera të duhanit	Vetëm produkte tjera të duhanit	Çfarëdo produkti të duhanit	Vetëm cigare	Cigare dhe produkte tjera të duhanit	Vetëm produkte tjera të duhanit	Çfarëdo produkti të duhanit ¹	
Totali	52.8	45.9	1.1	0.0	47.0	19.2	0.1	0.0	19.3	5251
Mosha										
15-19	73.2	26.1	0.4	0.0	26.6	2.7	0.0	0.0	2.7	945
20-24	53.6	44.0	2.2	0.2	46.4	12.9	0.2	0.0	13.2	884
25-29	51.9	46.4	1.6	0.1	48.1	24.5	0.0	0.0	24.5	701
30-34	46.3	52.1	1.1	0.0	53.2	23.8	0.2	0.0	24.0	679
35-39	45.0	53.3	1.7	0.0	55.0	26.0	0.0	0.0	26.0	726
40-44	44.0	55.5	0.3	0.0	55.8	29.0	0.0	0.0	29.0	724
45-49	48.1	51.4	0.3	0.0	51.8	23.3	0.0	0.0	23.3	591
Vendbanimi										
Urban	45.1	52.5	2.0	0.1	54.6	24.4	0.0	0.0	24.4	2029
Rural	57.7	41.6	0.6	0.0	42.3	16.0	0.1	0.0	16.1	3222
Arsimimi										
Nuk ka arsimim	59.8	40.2	0.0	0.0	40.2	15.2	0.0	0.0	15.2	86
Fillor	54.4	45.6	0.0	0.0	45.6	22.5	0.0	0.0	22.5	204
I mesëm i ulët	56.4	43.0	0.5	0.0	43.5	18.4	0.1	0.0	18.4	1997
I mesëm i lartë	54.2	45.1	0.6	0.0	45.7	19.6	0.0	0.0	19.6	1801
I lartë	43.8	52.4	3.2	0.2	55.9	19.8	0.2	0.0	20.0	1163
Fëmijë nën 5 vjeç në ekonomi familjare										
Së paku një	54.9	44.2	0.8	0.0	45.0	18.2	0.1	0.0	18.3	1866
Asnjë	51.7	46.8	1.3	0.1	48.2	19.8	0.1	0.0	19.9	3385
Kuintilët e indeksit të pasurisë										
Më të varfërit	58.8	40.9	0.2	0.0	41.1	19.9	0.0	0.0	19.9	989
Të dytët	56.8	43.0	0.2	0.0	43.2	17.8	0.0	0.0	17.8	1056
Mesatarët	54.6	44.8	0.6	0.0	45.3	16.3	0.1	0.0	16.4	1031
Të katërtit	51.3	46.9	1.5	0.2	48.6	18.6	0.1	0.0	18.7	1090
Më të pasurit	43.4	53.2	3.0	0.1	56.2	23.4	0.1	0.0	23.6	1086
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare										
Shqiptar	53.2	45.6	1.0	0.1	46.6	18.3	0.1	0.0	18.4	4772
Serb	43.3	53.7	3.0	0.0	56.7	34.6	0.0	0.0	34.6	270
Grupe tjera etnike	55.8	42.7	1.6	0.0	44.2	19.9	0.0	0.0	19.9	209
¹ Treguesi i MICS-it 12.1 – Përdorimi i duhanit										

Tabela TA.1M: Përdorimi i duhanit aktualisht dhe ndonjëherë (meshkujt)

Përqindja e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare sipas mënyrës së përdorimit të duhanit, Kosovë, 2013-2014


	Nuk kanë konsumuar asnjëherë cigare apo produkte tjera të duhanit	Kanë konsumuar duhan ndonjëherë				Konsumuesit e produkteve të duhanit në çfarëdo kohe gjatë muajit të fundit				Numri i meshkujve të moshës 15-49 vjeçare
		Vetëm cigare	Cigare dhe produkte tjera të duhanit	Vetëm produkte tjera të duhanit	Çfarëdo produkti të duhanit	Vetëm cigare	Cigare dhe produkte tjera të duhanit	Vetëm produkte tjera të duhanit	Çfarëdo produkti të duhanit ¹	
Totali	21.9	67.3	10.0	0.7	78.0	32.9	1.0	0.3	34.3	2165
Mosha										
15-19	46.7	44.1	8.5	0.6	53.3	11.6	0.6	0.4	12.6	468
20-24	19.6	67.8	11.5	0.9	80.1	31.8	0.9	0.0	32.6	375
25-29	19.2	67.4	13.1	0.3	80.8	32.8	2.0	0.6	35.5	308
30-34	13.5	75.5	9.4	1.2	86.0	38.9	0.0	0.6	39.4	261
35-39	7.9	81.6	8.8	1.3	91.7	44.2	1.8	0.7	46.6	243
40-44	15.4	75.6	8.5	0.5	84.6	43.1	1.1	0.0	44.2	258
45-49	11.2	78.6	9.9	0.3	88.8	47.1	0.8	0.0	48.0	253
Vendbanimi										
Urban	19.8	62.1	16.7	1.2	80.1	37.7	1.4	0.5	39.6	783
Rural	23.1	70.2	6.1	0.4	76.8	30.2	0.8	0.2	31.2	1382
Arsimimi										
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	3
Fillor	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	15
I mesëm i ulët	19.7	74.0	6.0	0.3	80.3	42.3	0.8	0.3	43.4	332
I mesëm i lartë	24.0	67.0	8.1	0.6	75.8	32.5	0.9	0.2	33.6	1247
I lartë	18.7	63.4	16.7	1.2	81.3	27.2	1.5	0.7	29.4	567
Fëmijë nën 5 vjeç në ekonomi familjare										
Së paku një	18.4	69.8	11.0	0.6	81.4	34.5	1.7	0.4	36.6	723
Asnjë	23.6	66.0	9.4	0.7	76.2	32.2	0.7	0.3	33.1	1442
Kuintilët e indeksit të pasurisë										
Më të varfërit	20.8	73.8	5.4	0.0	79.2	40.7	0.4	0.2	41.3	436
Të dytët	23.8	69.3	5.6	1.1	76.0	33.2	1.2	0.2	34.7	454
Mesatarët	27.0	64.9	7.9	0.2	73.0	31.4	0.9	0.2	32.5	432
Të katërtit	18.3	70.2	10.6	0.6	81.5	29.5	0.8	0.3	30.6	405
Më të pasurit	19.2	58.4	20.5	1.6	80.5	29.7	1.6	0.7	32.1	438
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare										
Shqiptar	20.7	68.4	10.2	0.6	79.2	32.1	0.9	0.4	33.3	1963
Serb	44.6	45.6	6.9	2.9	55.4	38.0	1.9	0.0	39.9	112
Grupe tjera etnike	19.9	69.3	8.4	1.2	78.8	45.9	2.1	0.0	48.0	90

¹Treguesi i MICS-it 12.1 – Përdorimi i duhanit^(M)

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Konsumimi i duhanit nga femrat dhe meshkujt është pak a shumë i njëjtë në vendbanimet urbane dhe rurale. Mes përdoruesve aktual të duhanit meshkujt dhe femra, produkti më i shpeshtë i duhanit është cigarja. 19 përqind e femrave dhe 33 përqind e meshkujve kanë përdorur vetëm cigare gjatë muajit të fundit. Pothuajse një e pesta (18 përqind) e femrave dhe më shumë se një e treta e meshkujve (37 përqind) të moshës 15-49 vjeçare të cilët aktualisht tymosin duhan jetojnë në ekonomi familjare me së paku një fëmijë të moshës nën 5 vjeç. Megjithatë në përgjithësi nuk ka dallime sa i përket konsumimit të duhanit sipas femrave dhe meshkujve që jetojnë në ekonomi familjare me së paku një fëmijë të moshës nën 5 vjeç. Figura TA.1 tregon qartë trendin e ngjashëm të uljes në përgjithësi dhe ulje të madhe tek ata nën moshën 25 vjeçare edhe për meshkujt edhe për femrat, me vetëm një ndryshim në madhësinë e fenomenit ku femrat kanë shkallë më të ulët. Përderisa më shumë se gjysma (52 përqind) e femrave të moshës 45-49 vjeçare kanë përdorur ndonjëherë produkt duhani, vlera është më e madhe për të njëjtën grup moshë tek meshkujt (89 përqind). Nga grup-mosha 15-19 vjeçare vlerat për ata që kanë përdorur ndonjëherë produkte të duhanit bie në 27 dhe 53 përkatësisht. Ky reduktim i madh është vërejtur po ashtu edhe për femrat dhe meshkujt që kanë tymosur cigare apo kanë përdorur produkte duhani me ose pa tymosje në një apo më shumë ditë gjatë muajit të kaluar me vlerë që bien nga 48 përqind për meshkujt e moshës 45-49 vjeçare në 13 përqind për meshkujt e moshës 15-19 vjeçare, ndërsa për femrat ndryshimi ishte nga 23 në përkatësisht tre përqind. Edhe pse rritja e nivelit të arsimimit nuk ka ndonjë ndikim të theksuar në ata/ato që kanë tymosur ndonjëherë, duket të jetë e lidhur me nivelet më të ulëta të konsumimit aktual për meshkujt. Femrat që jetojnë në ekonomitë familjare ku kryefamiljari i përket grupit etnik serb (35 përqind) kanë më shumë të ngjarë të jenë përdorues aktual të duhanit se sa grupi etnik shqiptar (19 përqind).

Figura TA.1: Konsumuesit e duhanit aktual dhe ndonjëherë, Kosovë, 2013-2014



Tabelat TA.2 dhe TA.2M prezantojnë rezultatet për moshën e konsumimit për herë të parë të cigareve dhe shpeshtësinë e konsumimit për femrat dhe meshkujt përkatësisht. Rezultatet tregojnë se 29 përqind e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare kanë tymosur një cigare për herë të parë para moshës 15 vjeçare (Tabela TA.2M). Në mesin e femrave, përqindja korresponduese është pesë (Tabela TA.2). Tetë përqind e femrave të moshës 15-19 vjeçare, pesë përqind e femrave të moshës 20-24 vjeçare kanë tymosur cigare para moshës 15 vjeçare. Derisa për meshkujt nuk ka trend linear me vlerat që ndryshojnë nga 24 përqind (grup moshë 45-49 vjeçare) në 33 përqind (grup moshë 15-19 vjeçare) dhe ka një variabilitet edhe për meshkujt edhe për femrat për sa i përket indeksit të pasurisë dhe vendbanimit.

Siç është shfaqur në tabelën TA.2M, në mesin e meshkujve që aktualisht tymosin duhan, 63 përqind kanë tymosur më shumë se 20 cigare për 24 orë. Femrat që tymosin cigare nuk tymosin aq shumë: shifra korresponduese është 23 përqind. 51 përqind e femrave dhe 87 përqind e meshkujve që aktualisht tymosin duhan kanë tymosur 10 apo më shumë cigare në 24 orët e fundit.

Tabela TA.2: Mosha e konsumimit të cigares për herë të parë dhe shpeshtësia e konsumimit (femrat)

Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeçare që kanë tymosur një cigare të plotë para moshës 15 vjeçare dhe shpërndarja në përqindje e duhanpirësve aktual sipas numrit të cigareve të tymosura në 24 orët e fundit, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e femrave që kanë tymosur një cigare të plotë para moshës 15 vjeçare ¹	Numri i femrave të moshës 15-49 vjeçare	Numri i cigareve në 24 orët e fundit					Numri i femrave të moshës 15-49 vjeçare që aktualisht tymosin cigare
			Më pak se 5	5-9	10-19	20+	Totali	
Totali	4.9	5251	28.4	20.8	27.6	23.2	100.0	1016
Mosha								
15-19	8.4	945	(22.9)	(39.1)	(15.1)	(22.9)	100.0	25
20-24	4.6	884	33.4	22.1	21.9	22.7	100.0	118
25-29	3.5	701	31.0	20.5	33.8	14.7	100.0	173
30-34	3.8	679	30.2	22.5	27.9	19.4	100.0	163
35-39	5.5	726	29.3	19.1	28.2	23.3	100.0	190
40-44	4.2	724	24.0	21.3	29.8	24.9	100.0	210
45-49	2.7	591	25.2	16.1	22.4	36.4	100.0	138
Vendbanimi								
Urban	4.6	2029	25.2	21.7	29.9	23.2	100.0	497
Rural	5.1	3222	31.4	19.9	25.4	23.3	100.0	519
Arsimimi								
Nuk ka arsimim	2.3	86	(*)	(*)	(*)	(*)	100.0	13
Fillor	6.5	204	(42.2)	(20.2)	(16.0)	(21.6)	100.0	46
I mesëm i ulët	5.0	1997	30.3	23.6	24.4	21.6	100.0	369
I mesëm i lartë	5.6	1801	25.3	21.9	29.0	23.7	100.0	355
I lartë	3.6	1163	26.6	15.8	33.4	24.2	100.0	233
Fëmijë nën 5 vjeç në ekonomi familjare								
Së paku një	5.0	1866	30.6	22.7	27.5	19.2	100.0	342
Asnjë	4.8	3385	27.3	19.8	27.6	25.3	100.0	674
Kuintilët e indeksit të pasurisë								
Më të varfërit	6.0	989	36.7	19.2	24.7	19.5	100.0	196
Të dytët	4.1	1056	24.8	23.8	25.0	26.4	100.0	189
Mesatarët	5.2	1031	33.2	21.5	24.7	20.6	100.0	169
Të katërtit	4.8	1090	26.2	21.6	28.5	23.8	100.0	205
Më të pasurit	4.4	1086	23.3	18.6	32.9	25.2	100.0	257
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare								
Shqiptar	4.8	4772	30.8	21.6	25.7	21.9	100.0	881
Serb	4.2	270	11.8	11.4	43.6	33.2	100.0	94
Grupe tjera etnike	7.1	209	(15.1)	(24.4)	(31.4)	(29.1)	100.0	41

¹ Treguesi i MICS-it 12.2 – Tymosja e duhanit para moshës 15 vjeçare

() Shifrat që janë të bazuara në 25 – 49 raste të pa peshuara

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 25 raste të pa peshuara

Tabela TA.2M: Mosha e konsumimit të cigares për herë të parë dhe shpeshtësia e konsumimit (meshkujt)

Përqindja e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare që kanë tymosur një cigare të plotë para moshës 15 vjeçare dhe shpërndarja në përqindje e duhanpirësve aktual sipas numrit të cigareve të tymosura në 24 orët e fundit, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e meshkujve që kanë tymosur një cigare të plotë para moshës 15 vjeçare ¹	Numri i meshkujve të moshës 15-49 vjeçare	Numri i cigareve në 24 orët e fundit					Numri i meshkujve të moshës 15-49 vjeçare që aktualisht tymosin cigare
			Më pak se 5	5-9	10-19	20+	Totali	
Totali	29.1	2165	6.4	6.3	24.7	62.5	100.0	735
Mosha								
15-19	32.9	468	24.8	16.7	17.1	41.3	100.0	57
20-24	28.6	375	11.0	9.2	21.8	58.0	100.0	122
25-29	27.9	308	4.8	3.5	30.9	60.8	100.0	107
30-34	29.9	261	2.2	4.8	29.4	63.5	100.0	101
35-39	31.7	243	6.1	9.4	26.3	58.2	100.0	112
40-44	25.8	258	2.7	4.3	22.6	70.4	100.0	114
45-49	24.4	253	1.9	1.5	22.5	74.0	100.0	121
Vendbanimi								
Urban	32.3	783	6.7	5.2	26.7	61.4	100.0	306
Rural	27.3	1382	6.2	7.2	23.3	63.3	100.0	429
Arsimimi								
Nuk ka arsimim	(*)	3	(*)	(*)	(*)	(*)	100.0	2
Fillor	(*)	15	(*)	(*)	(*)	(*)	100.0	11
I mesëm i ulët	35.2	332	5.1	7.9	21.2	65.9	100.0	143
I mesëm i lartë	28.7	1247	5.8	6.1	25.8	62.3	100.0	416
I lartë	26.2	567	9.3	5.4	24.6	60.7	100.0	163
Fëmijë nën 5 vjeç në ekonomi familjare								
Së paku një	30.2	723	6.2	5.7	22.7	65.4	100.0	261
Asnjë	28.6	1442	6.5	6.7	25.9	60.9	100.0	474
Kuintilët e indeksit të pasurisë								
Më të varfërit	31.3	436	5.4	10.8	21.7	62.1	100.0	179
Të dytët	31.9	454	6.1	5.3	22.9	65.7	100.0	156
Mesatarët	24.7	432	8.2	2.8	24.6	64.4	100.0	140
Të katërtit	29.7	405	6.9	7.4	32.5	53.3	100.0	123
Më të pasurit	27.8	438	6.0	4.3	24.1	65.6	100.0	137
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare								
Shqiptar	30.5	1963	6.6	5.7	22.6	65.0	100.0	647
Serb	6.6	112	(1.7)	(9.5)	(58.0)	(30.8)	100.0	45
Grupe tjera etnike	26.2	90	8.0	12.1	22.3	57.6	100.0	43
¹ Treguesi i MICS-it 12.2 – Tymosja e duhanit para moshës 15 vjeçare ^[M]								
() Shifrat që janë të bazuara në 25-49 raste të pa peshuara								
(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 15 raste të pa peshuara								

KONSUMIMI I ALKOOLIT

Tabela TA.3 tregon konsumimin e alkoolit tek femrat. Pesë përqind e femrave të moshës 15-49 vjeçare ka konsumuar së paku një pije alkoolike në një apo më shumë ditë gjatë muajit të fundit. Një përqind e femrave të së njëjtës grup moshë për herë të parë kanë konsumuar alkool para moshës 15 vjeçare ndërsa 77 përqind të femrave nuk kanë konsumuar asnjëherë një pije alkoolike. Femrat e moshës 15-19 vjeçare kanë më shumë të ngjarë të kenë konsumuar së paku një pije alkoolike para moshës 15 vjeçare sesa femrat nga grup moshat më të vjetra.

Proportioni i meshkujve që konsumon alkool është konsiderueshëm më i lartë se sa te femrat (shih tabelën TA.3M). 35 përqind e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare kanë konsumuar së paku një pije alkoolike në një apo më shumë ditë gjatë muajit të fundit. Konsumimi i alkoolit para moshës 15 vjeçare është pak më i shpeshtë në mesin meshkujve (11 përqind) se sa femrave (një përqind). Sikurse për femrat e reja, proporcioni i meshkujve të rinjë që kanë konsumuar së paku një pije alkoolike para moshës 15 vjeçare është më i lartë në mesin e grup moshave më të reja. Konsumimi i alkoolit nga femrat dhe meshkujt ndryshon thelbësisht sipas kuintalëve të pasurisë dhe vendbanimit. Veçanërisht në mesin e femrave, përdorimi i alkoolit është më i shpeshtë në vendbanimet urbane dhe në mesin e femrave që jetojnë në ekonomitë më të pasura familjare. Meshkujt në grup moshën më të re (15-19 vjeçare) kanë më shumë të ngjarë se sa ata në grup moshën më të vjetër (45-49 vjeçare) të kenë konsumuar së paku një pije alkoolike para moshës 15 vjeçare.

Tabela TA.3: Konsumimi i alkoolit (femrat)

Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeçare që nuk kanë konsumuar asnjë pije alkoolike, përqindja e atyre që kanë konsumuar pije alkoolike para moshës 15 vjeçare, dhe përqindja e femrave që kanë konsumuar së paku një pije alkoolike në çfarëdo kohe gjatë muajit të fundit, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e femrave të cilat:			Numri i femrave të moshës 15-49 vjeçare
	Nuk kanë konsumuar asnjë pije alkool	Kanë konsumuar së paku një pije alkoolike para moshës 15 vjeçare ¹	Kanë konsumuar së paku një pije alkoolike në çfarëdo kohe gjatë muajit të fundit ²	
Totali	76.9	1.3	9.6	5251
Mosha				
15-19	79.5	4.3	7.6	945
20-24	69.0	0.9	12.4	884
25-29	70.2	0.9	11.3	701
30-34	79.1	0.4	9.8	679
35-39	79.5	0.4	9.3	726
40-44	80.5	0.4	8.9	724
45-49	82.3	0.4	8.0	591
Vendbanimi				
Urban	67.9	1.3	13.2	2029
Rural	82.5	1.2	7.4	3222
Arsimimi				
Nuk ka arsimim	95.2	0.0	0.0	86
Fillor	92.7	0.0	2.9	204
I mesëm i ulët	89.1	0.8	3.9	1997
I mesëm i lartë	76.1	2.1	9.8	1801
I lartë	52.8	1.0	21.2	1163
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	89.8	1.3	2.9	989
Të dytët	85.5	0.6	5.5	1056
Mesatarët	80.0	1.0	8.3	1031
Të katërtit	74.0	1.6	11.5	1090
Më të pasurit	56.7	1.7	19.2	1086
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare				
Shqiptar	62.1	89.7	59.1	787
Serb	(18.5)	(72.5)	(14.4)	33
Grupe tjera etnike	(32.7)	(89.5)	(32.7)	22

¹ Treguesi i MICS-it 12.4 – Konsumimi i alkoolit para moshës 15 vjeçare

² Treguesi i MICS-it 12.3 – Konsumimi i alkoolit

Tabela TA.3M: Konsumimi i alkoolit (meshkujt)

Përqindja e meshkujve të moshës 15-49 vjeçare që nuk kanë konsumuar asnjë pije alkoolike, përqindja e atyre që kanë konsumuar pije alkoolike para moshës 15 vjeçare, dhe përqindja e meshkujve që kanë konsumuar së paku një pije alkoolike në çfarëdo kohe gjatë muajit të fundit, Kosovë, 2013-2014

	Përqindja e meshkujve të cilët:			Numri i meshkujve të moshës 15-49 vjeçare
	Nuk kanë konsumuar asnjë pije alkool	Kanë konsumuar së paku një pije alkoolike para moshës 15 vjeçare ¹	Kanë konsumuar së paku një pije alkoolike në çfarëdo kohe gjatë muajit të fundit ²	
Totali	31.7	10.8	34.8	2165
Mosha				
15-19	48.9	23.2	22.0	468
20-24	32.2	7.6	31.0	375
25-29	27.0	8.8	36.9	308
30-34	26.8	5.5	40.2	261
35-39	27.9	8.1	39.7	243
40-44	23.0	7.6	44.7	258
45-49	22.7	6.1	41.5	253
Vendbanimi				
Urban	23.7	13.4	42.0	783
Rural	36.3	9.3	30.8	1382
Arsimimi				
Nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	3
Fillor	(*)	(*)	(*)	15
I mesëm i ulët	35.7	9.5	33.3	332
I mesëm i lartë	34.4	11.9	31.8	1247
I lartë	23.5	9.1	42.2	567
Kuintilët e indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	42.2	9.2	27.7	436
Të dytët	34.5	8.5	29.4	454
Mesatarët	34.9	10.6	32.3	432
Të katërtit	27.9	11.6	36.7	405
Më të pasurit	18.8	14.1	48.5	438
Grupi etnik i kryefamiljarit të ekonomisë familjare				
Shqiptar	33.0	9.7	32.1	1963
Serb	9.4	30.8	86.8	112
Grupe tjera etnike	31.9	9.5	28.9	90

¹ Treguesi i MICS-it 12.4 – Konsumimi i alkoolit para moshës 15 vjeçare^(M)

² Treguesi i MICS-it 12.3 – Konsumimi i alkoolit^(M)

(*) Shifrat që janë të bazuara në më pak se 15 raste të pa peshuara

SHTOJCAT

SHTOJCA A. Dizajni i mostrës

Karakteristikat kryesore të dizajnit të mostrës përshkruhen në këtë shtojcë. Karakteristikat e dizajnit të mostrës përfshijnë madhësinë e mostrës objektive, alokimin e mostrës, listimin dhe kornizën e mostrës, përzgjedhjen e popullatës, fazat e mostrimit, stratifikimin dhe kalkulimin e peshave të mostrës.

Objektivi primar i dizajnit të mostrës për MICS-in në Kosovë ishte për të prodhuar vlerësime statistike të besueshme për shumicën e treguesve në nivel të Kosovës dhe në nivelin urban dhe rural. Niveli urban dhe rural në secilin prej shtatë regjioneve (Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj) janë definuar si strata (grupe) të mostrës.

Për përzgjedhjen e mostrës së anketës është përdorur një qasje dy-dimensionale e mostrimit të stratifikuar të grupimit.

MADHËSIA DHE ALOKIMI I MOSTRËS

Madhësia e mostrës së MICS-it për Kosovë është kalkuluar të jetë rreth 4,800 ekonomi familjare. Për llogaritjen e madhësisë së mostrës, si treguesi kyç është përdorur përqindja e femrave aktualisht të martuara apo në bashkëjetesë që përdorin metodë moderne të kontracëcionit. Formula e mëposhtme është përdorur për të vlerësuar madhësinë e kërkuar të mostrës për këtë tregues:

$$n = \frac{4 \times r \times (1-r) \times deff \times 1.15}{(0.12r)^2 \times p \times \bar{n}}$$

ku:

- n është madhësia e kërkuar e mostrës, e shprehur si numri i ekonomive familjare, për treguesin kyç
- 4 është faktori për të arritur nivelin e besueshmërisë në 95 përqind
- r është shkalla predikuese apo vlerësuese për treguesin
- 1.15 është faktori i nevojshëm për të ngritur madhësinë e mostrës për 15 përqind për mos-pjesëmarrje
- $deff$ është efekti i dizajnit
- 0.12r është kufiri i gabimit që mund të tolerohet në 95 përqind nivel të besueshmërisë, e definuar si 12 përqind e r
- p është proporcioni i nën-popullatës në të cilin është i bazuar treguesi r
- $\bar{n}$ është numri mesatarë i personave për ekonomi familjare

Për llogaritje, r (shkalla e prevalencës së kontracëctivëve modern) është supozuar të jetë 15.6 përqind. Vlera e $deff$ (efekti të dizajnit) është marrë si 1.5 duke pasur parasysh se nuk ka pasur informata, p (proporcioni i të gjitha femrave ose femrave të martuara të moshës 15 deri në 49 vjet në popullatën e përgjithshme) është marrur si 26.8 përqind ndërsa numri mesatar i personave për ekonomi familjare është vlerësuar si 5.74 për ekonomi familjare nga korniza e mostrës.

Numri i ekonomive familjare që rezultojë nga ky ushtrim ishte 4.800 ekonomi familjare në total.

Numri i ekonomive familjare të përzgjedhura për një qark regjistruar në MICS-in për Kosovë është përcaktuar si 16 ekonomi familjare, bazuar në një numër konsideratash duke përfshi efektin e dizajnit, buxhetin e disponueshëm dhe kohën e nevojshme që një ekip të kompletoj qarkun regjistruar. Duke pjesëtuar numrin total të ekonomive familjare me numrin e ekonomive të mostruara për një qark regjistruar, është llogaritur se duhet të përzgjidhen 300 qarqe regjistruar në mostruara.

Tabela SD.1: Numri i QR të mostruara dhe ekonomitë familjare të propozuara, sipas regjioneve dhe stratave

	Totali			Urban		Rural	
	Alokimi Proporcional i QR	Alokimi i përshtatur i QR	Ekonomitë Familjare të mostruara	QR të mostruara	Ekonomitë Familjare të mostruara	QR të mostruara	Ekonomitë Familjare të mostruara
Totali	300	300	4,800	130	2,080	170	2,720
Regjionet							
Gjakovë	30	32	512	12	192	20	320
Gjiilan	32	32	512	13	208	19	304
Mitrovicë	43	42	672	19	304	23	368
Pejë	29	32	512	13	208	19	304
Prizren	51	50	800	19	304	31	496
Prishtinë	84	80	1,280	42	672	38	608
Ferizaj	30	32	512	12	192	20	320

KORNIZA E MOSTRËS DHE PËRZGJEDHJA E QARQEVE REGJISTRUESE

Për përzgjedhjen e qarqeve regjistruese është përdorur korniza e regjistrimit të popullsisë e vitit 2011. Qarqet regjistruese të regjistrimit të popullsisë janë përcaktuar si njësi të para të mostrës (QR) dhe janë përzgjedhur nga secila stratë e mostruar duke përdorur procedurat e mostrës sistematike të ppm (probabiliteti proporcional ndaj madhësisë) bazuar në numrin e ekonomive familjare në secilin qark regjistruar nga korniza e regjistrimit të popullsisë, ekonomive shtëpive dhe banesave të vitit 2011. Faza e parë e mostrimit është kompletuar duke zgjedhur numrin e kërkuar të qarqeve regjistruese në secilin nga shtatë regjionet, veç e veç për zonat urbane dhe rurale.

AKTIVITETET E LISTIMIT

Përderisa korniza e mostrës (nga Regjistrimi i popullsisë së vitit 2011) nuk ishte azhurnuar, një listim i ri i ekonomive familjare është realizuar në të gjitha qarqet regjistruese të mostrës para përzgjedhjes së ekonomive familjare. Për këtë qëllim, u formuan ekipet e listimit të cilët vizituan qarqet regjistruese dhe listuan të gjitha ekonomitë familjare në qarqet regjistruese. Ata ishin të pajisur me fotot ajrore (shiko foton e prezantuar më poshtë) të çdo qarku regjistruar të cilat ishin përdorur për të zhvilluar kornizën e mostrës të Regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. Në gusht të vitit 2013 është mbajtur një trajnim i veçantë 3 ditorë mbi listimin, përfshirë një pilotim në zonat urbane dhe rurale sipas procedurave Globale të rekomanduara të MICS-it. Një numër prej 26 regjistruesh u përfshinë në aktivitetet e listimit për të mbuluar 300 QRs gjatë gushtit dhe shtatorit 2013.

PËRZGJEDHJA E EKONOMIVE FAMILJARE

Listat e ekonomive familjare janë përgatitur nga ekipet e listimit në terren për secilin qark regjistruar. Ekonomitë familjare pastaj janë numëruar nga numri 1 deri në n (numri total i ekonomive familjare në secilin qark regjistruar) tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, ku është bërë përzgjedhja e 16 ekonomive familjare në secilin qark regjistruar duke përdorur procedurat për përzgjedhjen sistematike në mënyrë të rastësishme. Gjatë përzgjedhjes së QRe për MICS-in në Kosovë dhe MICS-in me Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë, tetë QRe të njëjta janë përzgjedhur për të dy anketat, prandaj një mostër e ndarë sistematike e 16 ekonomive familjare është përzgjedhur për secilën anketë nga këto QRe.

Anketa po ashtu ka përfshirë një pyetësorë individual për meshkuj i cili do duhej të administrohej në njërën gjysmë të mostrës së ekonomive familjare. Për të siguruar përzgjedhjen sistematike të rastit, numri çift/tek i shifrës së fundit të numrit të qarkut regjistruar është përdorur në kombinim me numrin çift/tek të shifrës së fundit të ekonomisë familjare për të përzgjedhur ekonomitë familjare specifike për intervistat me të gjithë meshkujt e kualifikuar, p.sh. nëse shifra e fundit e numrit të qarkut regjistruar ishte tek, atëherë të gjitha ekonomitë familjare me shifrën e fundit të ekonomisë familjare me numër tek janë përzgjedhur për administrimin e pyetësorit për meshkuj, etj.

KALKULIMI I PESHAVE TË MOSTRËS

Mostra e MICS-it për Kosovë nuk është e vet-peshuar. Para së gjithash, proporcione të ndryshme të mostrës janë përdorur në secilin regjion pasi që madhësia e regjioneve është e ndryshme. Për këtë arsye, janë kalkuluar peshat e mostrës të cilat janë përdorur në analizat pasuese të të dhënave të anketës.

Komponenti kryesor i peshës është reciprociteti i proporcionit të mostrës së shfrytëzuar në përzgjedhjen e numrit të ekonomive familjare në atë stratë të veçantë të mostrës (h) dhe QR (i):

$$W_{hi} = \frac{1}{f_{hi}}$$

Termi f_{hi} , proporcioni i mostrimit për i-th mostrën e QR-së në stratën h-th, është produkt i probabilitet të përzgjedhjes në secilën fazë të secilit stratum të mostrës:

$$f_{hi} = p_{1hi} \times p_{2hi}$$

ku p_{2hi} është probabiliteti i përzgjedhjes së njësisë së mostrës në fazën s për i-th e mostrës së QR-e në h-th stratën e mostrës. Bazuar në dizajnin e mostrës, këto probabilitete janë kalkuluar si vijon:

$$p_{1hi} = \frac{n_h \times M_{hi}}{M_h}$$

n_h = numri i QR-e të të përzgjedhura në stratën h

M_{hi} = numri i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, për mostrën i të QRs në stratën h

M_h = numri total i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, për stratën h

$$p_{2hi} = \frac{16}{M_{hi}}$$

M'_{hi} = numri i ekonomive familjare të listuara në mostrën e QRe të i-th.

Përderisa numri i ekonomive familjare në secilin qark regjistruar (QR) nga korniza e Regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 të përdorur për fazën e parë të përzgjedhjes dhe numri i azhurnuar i ekonomive familjare nga qarqet regjistruese të përfshira në listim janë përgjithësisht të ndryshme, janë kalkuluar probabilitetet individuale të përgjithshme të përzgjedhjes për ekonomitë familjare në secilin qark regjistruar të mostrës (grupim).

Komponenti i fundit i kalkulimit të peshave të mostrës merr parasysh nivelin e mos-pjesëmarrjes së ndonjë ekonomie familjare dhe intervistave individuale. Përshtatja për mos-pjesëmarrjen e ekonomisë familjare në secilën stratë është e barabartë me:

$$\frac{1}{RR_h}$$

ku RR_h është shkalla e përgjigjes për mostrën e ekonomive familjare në stratën h, e definuar si proporcioni i numrit të ekonomive familjare të intervistuar në stratën h nga numri i ekonomive familjare të përzgjedhura që janë gjetur si të banuara gjatë punës në terren në stratën h.

Ngjashëm, përshtatja për mos-pjesëmarrje (mos-përgjigje) në nivelin individual (femra, meshkuj dhe fëmijë nën 5 vjeç) për secilën stratë është e barabartë me:

$$\frac{1}{RR_h}$$

ku RR_h është shkalla e pjesëmarrjes në pyetësorët individual në stratën h, i definuar si proporcioni i individëve të kualifikuar (femra, meshkuj dhe fëmijë nën moshën 5 vjeçare) në mostrën e ekonomive familjare në stratën h të cilët janë intervistuar me sukses.

Pas kompletimit të punës në terren, shkalla e pjesëmarrjes është kalkuluar për secilën stratë të mostrës. Këto janë përdorur për të përshtatur peshat e mostrës së kalkuluar për secilin qark regjistruar. Shkallët e pjesëmarrjes për MICS-in në Kosovë janë paraqitur në Tabelën HH.1 të këtij raporti.

